100 VJET PAVARESI

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (75). KORRIK 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

OPINION
I am from Kalaja e Dodës!
Nga: **EDISON YPI** - FAQE 5

PORTRET
Dom Nikoll Kaçorri, arkitekti i pavarësisë
Nga: **NIKOLL KOLA** - FAQE 11

EDUKIM
Roli i dijetarëve islamë për mësimin shqip...
Nga: **AHMET ÇAUSHI** - FAQE 15

PROFIL
Hasan Ballanca, atdhetari dhe publicisti
Nga: **XHELAL ROÇI** - FAQE 16

Dibra përtej një fotografie

Pas një fotografie të bukur qëndron dora, kujdesi, mundi e djersa e banorëve që jetojnë në Dibër. Jeta që fshihet pas një fotografie është e vështirë. Është e vuajtur. Shpesh e uritur. Me plot sakrifica. Por me ëndrra dhe shpresë!

REPORTAZH - Faqe 6-7



100 Vjet Pavarësi

Komuna e Arrasit dhe Shoqata e Historianëve të Dibrës kujtojnë kryengritjen e madhe të armatosur të popullit dibran kundër hordhive serbe të vitit 1920

Përkujtohet 92 vjetori i Qeverisë së Arrasit

***Nga:* SHAQIR SKARRA**

Arrita herët në Arras. Udhëtimi në mëngjes është më i lehtë në këto ditë të nxehta korriku e ndaj u nisa shpejt nga Tirana. Sa herë që udhëtoj drejt vendlindjes gjithmonë më kaplon një ndjenjë e fuqishme malli, bëhem nostalgjik për ato vite të bukura që kam kaluar. Më kujtohet me mall e dashuri çdo gjë e mirë dhe e bukur që kam përjetuar. Nostalgjik për një vijë uji apo një brazdë are të sapo prashitur me misër, për një burim me ujë akull të ftohtë apo plantacionet e shumta me drurë frutorë, për një rrugë fshati të pastër e shtruar me kalldrëm apo për mejat e gardhet e fshatarëve, për dardhat ende të papjekura që merrnim gjithë kryeneçësi nga kopshtet e të tjerëve apo dhe lojën e bukur me rrasa guri, për shkollën e fshatit ku era dhe vitet e kaluara kanë bërë të mundur që muri me plisa të jetë i gërryer shumë apo për ato kujtime që mblidhen sot pas kaq vitesh sikur të jenë mbajtur me kujdes në fletë të zverdhura blloku . E kjo ndjenjë malli dhe nostalgji për vendlindjen të gjithë i ka pushtuar nga pak. Makina ecën me vështirësi nëpër rrugën e pa shtruar por nuk më pengon asgjë të hedh vështrimin që nga xhami i hapur i makinës. Shikoj me çudi se asnjë copë tokë nuk ka mbetur pa punuar. Diku misër e diku jonxhë, diku plantacione me mollë e kumbull e diku kopshte të mbushura plot për plot me perimet e stinës.

(Lexoni në faqen 9)



cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (75). 1 - 31 Korrik 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Hysen Likdisha, Ali Hoxha, Shefki Aliti, Shpëtim Pollozhani, Bedri Tahiri, Ermira Babamusta se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Ahmet ÇAUSHI
Beqir SINA
Bernard ZOTAJ
Dhimitët SHTËMBARI
Edison YPI
Hasan LLESHI
Hysen LIKDISHA
Ilmi DERVISHI
Islam ÇENGA
Jorgo BULO
Mevlud BUCI
Moisi MURRA
Musa KRAJA
Ndue DEDAJ
Nikoll KOLA
Rexhep TORTE
Shukri HAJDARI
Xhelal MARKU
Xhelal ROÇI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Parku Kombëtar i Lurës në flakë



DIBËR – Pesë vatra zjarri janë ende aktive në rrethet e qarkut të Dibrës, ndërkohë që vatra më e fuqishme është ajo e Lurës, ku po digjen masive të mëdha me pisha. Banorë të Lurës thonë se janë djegur të paktën 300 hektarë me pyje në Pregj Lurë, ndërkohë që burime pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër bëjnë me dije se janë djegur deri tani 40 hektarë me pishë të bardhë dhe robull. "Në 24 orët e fundit janë shtuar disa vatra të tjera, të cilat janë aktive. Situata më problematike është në komunën Lurë, ku janë tri vatra të fuqishme zjarri. Në fshatin Pregj Lurë, edhe pse është punuar nga ora katër e mëngjesit të djeshëm nga një togë ushtarësh, ende zjarri është aktiv, duke djegur mbi 40 ha pyje halorë", thanë zyrtarë të DSHP Dibër. Masivi Pregjë Lurë-Prroi i Lanit-Bakullenë është rrafshuar, ndërsa dje pasdite zjarri ka nisur "udhëtimin" Zgjorgjë-Rec-Titar, duke djegur dhjetëra hektarë të tjerë me pyje të lartë të komunës Lurë. Forcat e ushtrisë nuk kanë mundur të disiplinojnë vatrat e zjarrit në Lurë, pasi atyre u mungojnë mjetet e nevojshme për një gjë të tillë. Ndërkaq, terreni është mjaft i thyer. Një tjetër vatër gjendet prej tri ditësh brenda Parkut Kombëtar të Lurës, te Liqeni i zi, ku është djegur një sipërfaqe e konsiderueshme me pisha, ah dhe bredh. Në Vanas vazhdon të jetë aktive një tjetër vatër zjarri duke djegur rreth 9 ha pyje të llojeve të ndryshme. Në komunën Sllovë të Dibrës janë djegur rreth 7 hektarë dhe fatmirësisht me ndërhyrjen e banorëve të zonës dhe Drejtorisë së Pyjeve vatra e zjarrit është dobësuar ndjeshëm. Në fshatin Kacni të komunës Selishtë janë përshkuar nga flakët rreth 2 hektarë me kullota, ndërsa në Bulqizë problematike është një vatër zjarri në Martanesh, e cila vazhdon të jetë mjaft aktive. Sipërfaqja e djegur është mbi 20 hektarë pyje pishe. Në ndihmë të drejtorive të shërbimit pyjor janë vënë banorë të zonave edhe dy toga ushtarësh të Kompanisë së Mbështetjes Rajonale në Burrel. Kjo drejtori u ka kërkuar ndihmë njësive vendore, por deri tani ato nuk u janë përgjigjur kërkesës së tyre. Ndërkaq, komisariatet e policisë të këtyre rretheve kanë nisur hetimet për të përcaktuar shkaqet e vërteta të zjarreve.

(Panorama, 23 korrik 2012)

SHFAQEN MASKAT NË BURREL, POLICIA SHOQËRON 37 PERSONA

Grabitësit me maskau shfaqen në fillim të muajit në aksin Milot – Burrel. Banorët e zonave rreth qytetit të Burrelit panë se si njerëz të maskuar dhe të armatosur kanë ndaluar dhe grabitur personat që udhëtonin me automjete në rrugën nacionale Burrel-Milot. Grabitja më e fundit është regjistruar në mbrëmjen e 8 korrikut rreth orës 24:00. Sipas policisë lokale, janë grabitur gjatë natës disa furgonë dhe makina të vogla që po udhëtonin në këtë aks rrugor, në vendin ku nis rruga për në fshatin Bushkash. Po sipas burimeve nga Policia e Matit, mësohet se persona me maska dhe të armatosur kanë grabitur gjatë natës vonë të së dielës tre-katër automjete të vogla dhe një furgon. Mësohet se personat që kanë rënë pre e kësaj grabitjeje kanë qenë nga zona të ndryshme të Qarkut Dibër, ku bëjnë pjesë rrethet Mat, Bulqizë dhe Dibër, por edhe një familje nga Fieri. Maskat u kanë marrë udhëtarëve varëse, celularë dhe lekë, si dhe i kanë terrorizuar ata nën kërcënimin e armëve. Ndërkohë, policia e njoftuar për këtë ngjarje, mësohet se ka ushtruar kontroll pothuajse në të gjitha shtëpitë e fshatit Bushkash, duke shoqëruar për në polici jo pak, por 37 persona si të dyshuar që mund të kenë dijeni dhe janë të përfshirë si autorë në këtë ngjarje.

Policia e Burrelit theksojnë se në lidhje me këtë ngjarje ata po patrullojnë vazhdimisht rrugën nacionale, por shfaqjen e këtij rasti të maskave grabitëse të udhëtarëve në rrugë, në mbrëmjen vonë të së dielës, e cilësojnë si sporadike, megjithëse autorët ende nuk janë arrestuar, duke shtuar "frikën" e qytetarëve për të udhëtuar sërish. ***(H.L.)***

PARALIZOHET KËSHILLI KOMUNAL, 265 FAMILJE PA ASISTENCË NË LURË

Të paktën që nga muaji maj i këtij viti, këshilli i komunës Lurë në rrethin e Dibrës, nuk funksionon. Shkak është bërë çarja e këtij këshilli, ku katër këshilltarë të djathtë i bashkojnë votat me tre këshilltarë të majtë. Ky bashkim prej shtatë votash, që përbën shumicën absolute të këtij këshilli prej 13 anëtarësh, me datë 11 maj 2012 merr vendimin për shkarkimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të këshillit, përkatësisht Faik Mena dhe Fadil Çupi, duke i zëvendësuar me zotërinjtë Hasan Hoti dhe Fatjon Kaci. Kryetari i sapozgjedhur dërgon në Prefekturën Dibër kopje të këtyre vendimeve të marra sipas tij konform ligjit, por Prefekti nuk e ka konfirmuar kete vendim. Ndërkohë, kjo ka shkaktuar dalja jashtë funksionit e këshillit komunal të Lurës dhe si rezultat 265 familje në nevojë të kësaj komune, që nga muaji shkurt 2012 nuk kanë marrë asistencën. Kështu rreth 1000 banorë të familjeve të varfëra të Lurës kanë mbetur pa kafshatën e gojës për muaj të tërë. Përkundër kësaj strukturat shtetërore që mund dhe duhet të japin rrugëzgjidhje për problematikën e krijuar në këshillin e komunës Lurë, ende vijojnë të zvarrisin problemin duke e politizuar plotësisht atë. Ndërkohë i sapozgjedhuri në krye të këtij këshilli që ende nuk është njohur nga Prefektura e Dibrës, Hasan Hoti, thotë për se ai dhe këshilltarët që përbëjnë shumicën, kanë përgatitur dokumentacionin e plotë shkresor për denoncim penal në organet e drejtësisë, si dhe do njoftojnë me shkrim të gjitha instancat shtetërore dhe ata që merren me krimin ekonomik, duke paraqitur për ta fakte të pakundërshtueshme të shkeljes së ligjit për funksionimin e qeverisjes vendore, në Komunën e Lurës.***(H.L.)***

Keni nje histori per te treguar?

Nje ngjarje per te kujtuar?

Nje liber per te promovuar?

Nuk keni nevoje per MIK, as PARA per te paguar...

vetem shkruani ne emailin <rrugaearberit@gmail.com>

Rruga e Arbërit



AMBASADORIA GJERMANE VIZITON BULQIZËN

Ambasadorja gjermane Carola Müller-Holtkemper ka vizituar sot minierën e Bulqizës dhe ka parë nga afër kushtet në të cilat punojnë minatorët.

Ajo është shprehur e gatshme për mbështetje ndaj minatorëve duke thënë se shumë kompani gjermane dëshirojnë të punojnë në minierat e Bulqizës duke përmirësuar kushtet e punës.

"Mjaft kompani private Gjermane kanë shprehur dëshirën për të punuar si në minierën e Bulqizës ashtu edhe në shumë fusha minerali në të gjithë Shqipërinë, kjo ishte dhe vizita ime që duhej të bëja në Bulqizë për t'u dhënë një këshillë dhe kompanive Gjermane për të parë nga afër kushtet e punës së minatorëve",- tha ambasadorja.

Më nga afër me situatën ambasadoren e ka njohur edhe kreu i sindikatës së minatorëve Kujtim Alliu, duke thënë se problem vijon të mbetet mungesa e investimeve të parashikuara në marrëveshjen me kompaninë ACR. Ai i ka kërkuar diplomates gjermane të ndërhyje tek ministria e Ekonomisë me qëllim nxitjen e investimeve.

E shoqëruar nga deputeti Qemal Minxhozi, ajo ka zhvilluar një takim edhe me kryetarin e bashkisë, Roland Keta. *(Korresp. RrA.)*

KATËR PYETJE LIDHUR ME ACR DHE BULQIZËN

Deputeti socialist Saimir Tahiri i ka kërkuar informacion për gjobën prej 1.639.163 Euro të vendosur nga METE

Nënkryetari i grupit kuvendor, të Partisë Soacialiste, Saimir Tahiri i ka dërguar një letër ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Edmond Haxhinasto, ku kërkohet informacion nëse gjoba e vendosur tre vjet më parë për kompaninë ACR është paguar. Bëhet fjalë për një gjobë me vlerë prej 1.639.163 Euro.

"Sot 3 vjet më parë (dt. 09.07.2009), Ministri Ruli nënshkroi një marrëveshje me Kompaninë ACR me objekt rishpërndarjen kohore të shlyerjes së gjobës së ACR prej 1.639.163 Euro (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre Euro). Në dt. 08.07.2009, ACR kërkoi nga Ministri Ruli shtyrjen e shlyerjes së gjobës, gjë që u formalizua në marrëveshjen e nënshkruar vetëm një ditë më pas ndërmjet Ministrit Ruli dhe kompanisë ACR. Ju kujtoj këtu se ACR u gjobit nga METE për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve për investime të parashikuara në Marrëveshjen Koncesionare të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 8590, dt. 23.03.2000 dhe Ligjin Nr. 8791, dt. 10.05.2001.

Edhe pse kjo marrëveshje nuk u miratua kurrë në Parlament duke vënë në dyshim serioz ligjshmërinë e veprimeve të Ministrit Ruli, sot pas ekzaktësisht 3 vjetësh nga nënshkrimi i saj, kërkoj informacion lidhur me efektin ligjor dhe zbatimin e saj nga Kompania ACR dhe METE në lidhje me shlyerjen e gjobës së ACR ndaj shtetit", thuhet në letrën e deputetit Tahiri. "Pasuria minerare vazhdon të shfrytëzohet pa asnjë kriter, paligjshmëria dhe bandat mafioze kanë pushtuar Bulqizën dhe zonat minerare, të gjitha këto nën hundën e shtetit e të strukturave shtetërore, të cilat me dhe për Bulqizën, me e pakta bëjnë sehir, për të mos thënë që janë të implikuara thellësisht në veprimtari kriminale", shkruan Tahiri.

Më tej në letër kërkohet përgjigje konkrete për katër çështje që kanë lidhje me gjobën e ACR-së. "Kërkoj informacion të detajuar e të plotë për çështjet e poshtëshënuara:

1. Sot pas 3 vjetësh nga Marrëveshja Ruli – ACR, a është likuiduar tërësisht vlera e gjobës së vendosur nga METE ndaj ACR në masën prej 1.639.163 Euro (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre Euro)?

2. Në qoftë se jo, cilat janë arsyet që kanë penguar ACR të paguajë detyrimet ndaj shtetit?

3. A janë përmbushur detyrimet për investime në ngarkim të ACR në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara nga marrëveshja koncesionare, mospërmbushja e të cilave pasoi me gjobitjen e ACR në masën e sipërpërmendur?

4. Sa është totali investimeve të realizuara nga koncesionari deri më sot, në zbatim të marrëveshjes koncesionare të Bulqizës?", shkruan Tahiri.

(Shqip, 9 korrik)



Pikëllimi i Bulqizës

Nga: **NDUE DEDAJ**

- E dëgjuat lajmin e fundit nga rajoni verilindor i kromit? "Shënohet viktima e radhës në minierën e Bulqizës. Mesditën e 2 korrikut, një minator ka humbur jetën teksa punonte brenda një galerie, që administrohet nga një subjekt privat.

Burimet e policisë lokale deklaruan se minatori Dilaver Koçi, 53 vjeç, banor i fshatit Vajkal, ka humbur jetën aksidentalisht në galerinë numër 4, teksa punonte për zhbllokimin e një furneli. Ai është zënë nga një masiv dheu, çka i ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme." Por vetëm një muaj më parë atje vdiq një 24-vjeçar, që gjithashtu e zuri poshtë dheu në një bunker të shpërthyer me eksploziv, teksa po kërkonte copa hekuri për t'i shitur. Tashmë të gjithë e dinë se vdekjet në këtë minierë nuk kanë të reshtur, numri i tyre nga viti në vit vetëm sa është shtuar. Po kush u ndal t'ia numëronte vdekjet Bulqizës? Minierës më të madhe të vendit, që, prej afro 70 vjetësh, më shumë na ka marrë se na ka dhënë. Bulqiza, monumenti i rrëzuar i kapitalizmit tonë "specifik", minerali i së cilës në vend që t'i bënte ata banorë të hanin me lugë të florinjtë, po ua shkurton jetën ditaditës. Cili shtetar u nis t'ia ndalonte gjëmat asaj, dhe pse nuk ka drejtues të lartë që nuk ka shkuar atje për të vënë kurora mbi ngushëllimin e minierës? Lexuesi drithërohet sa herë përmendet ky emër, pasi Bulqiza ka qenë pjesë e nekrologjisë së përmuajshme. Me ditënetët e saj mortore të njëpasnjëshme. Ato nuk i ndali as greva tremujore e minatorëve, përfshi dhe atë të urisë një mijë metra thellë,pa ndonjë rezultat, as britma e një oficeri të lartë policie për ta shpëtuar Bulqizën nga korrupsioni e krimi, as mediat që e kanë trajtuar me shqetësim problematikën komplekse të minierës. Pas shuarjes njerëzore të radhës mbi kreshtat e Duriçit plot medalje historike, por jo të sotmet, sërish bie heshtja. Njerëzve të thjeshtë u mbetet vetëm të shkruajnë epitafet e shembjeve të përgjakura.

> Kambanat për Bulqizën do të vazhdojnë të bien, deri sa t'ia ndalojmë asaj vdekjet e mijëvjeçarit të tretë, pikëllimin e saj të madh.

Bulqiza është sot "ishulli" nëntokësor i vdekjes, i paprekshëm nga askush. Dëshmia më tronditëse e rrënimit të asaj çka trashëguam nga e djeshmja. Por nga pak Bulqizë kemi ngado që vemi. Dhe aty ku na mbyten fëmijët në rezervuarët e ujit gjatë verës dhe nuk e ruajmë dot jetën e tyre. Ndër lajmet mbizotëruese të stinës janë ato të nekrofilisë: aksidentet në rrugë, miniera, krimet në familje, për hakmarrje, etj., deri te plehrat e gjithpushteshme, bërlloku që na ka zënë frymën e që nuk e heqim dot vetëm me ato qeset e zeza të plastmasit që mbajmë në duar gjatë parakalimeve sensibilizuese në bulevard. Si qytetar ti kërkon një zgjidhje tjetër, dhe pse nuk beson dhe aq. Thua për një çast sikur të mblidhej Parlamenti për nja tre muaj radhazi në Bulqizë, të bëheshin atje ligjet për koncesionet, sipërmarrjet në miniera, të dëgjoheshin nga afër zërat e varfërisë e të mbijetesës. Ndoshta kështu Republika jonë Parlamentare do të bëhej më e ndjeshme dhe më e përgjegjshme ndaj fatit shpesh aksidental të popullit të vet kudo ku ai rron. Ndaj Otrantos e Gërdecit. Gjegjanit e Himarës. Për ata që humbasin jetën nëpër fatkeqësi ka vetëm një emër, viktima. Edhe pse rëndom thuhet "për shkak të një gabimi njerëzor", të vjen të thuash, jo! Pikë së pari, ato ndodhin prej keqmenaxhimit të rrugëve, nëntokës, detit, punishteve të demontimit të municioneve etj. Ka pasur padyshim politikanë idealistë liberatorë, atdhedashës, po si për habi dhe pas njëqind vjetësh prapë mendja na vete fill e te Luigj Gurakuqi! Doemos që ka dhe sot të tillë, por çështja është që ata tashmë të mos jenë një e dy individë qelibar, por krejt klasa politike të jetë asisoj, e ndershme, idealiste e vizionare. Atëherë do të kishim një tjetër qasje ndaj vendit dhe njerëzve, burimeve të tij natyrore, kulturore e shpirtërore. Se nuk është vetëm Bulqiza që apelon fort. Nëse do që ta prekësh dhe më tej se një minierë a një qytezë punëtorësh rrënimin e visarit ekonomik, turistik e ekologjik, shih Lurën e zhbime me të shtatë liqenjtë e saj dhe mbarë pylltarinë shqiptare, Sarandën me bregdetin e "bunkerizuar" nga betoni etj. Rrënimin social në zonat jo urbane nuk e ndalon asnjë parti e vetme, asnjë qeveri, por të gjithë së bashku, pavarësisht titujve, gradave, posteve, të qenit në pozitë apo opozitë. Atë e ndalon ndërgjegjësimi ynë kombëtar dhe veprimi qytetar i përditshëm.

Është e vështirë të besosh se në Bulqizë gjithçka ndodh për shkak të "një gabimi njerëzor" sot e "një gabimi njerëzor" nesër, që nganjëherë tingëllon si një tallje dhe me vetë vdekjen. Por mundet që ca gjëra nuk funksionojnë siç duhet, ngaqë shteti është uzurpuar jo pak nga pushteti. Nga interesa të caktuara jo vetëm sipërmarrësish ekonomikë. Nuk i dilet përzot pronës publike, pasuritë e mëdha kombëtare, si mineralet shpesh lihen në duar firmash fantazma që nuk investojnë për prodhimin, por vetëm e zhvatin atë. Po dhe sa asete të tjera gjithandej republikës, që ose janë lënë të degradojnë, ose keqshfrytëzohen, si tokat, pyjet, lumenjtë, bimët industriale, kafshët e egra etj. Sheh gjithandej ndërtesa të reja që lartohen deri në qiell, gjë që natyrisht të gëzon, teksa në sytë e të gjithëve prej njëzet vjetësh "kalben" dhjetëra godina shtetërore, jo pak moderne të ndërtuara buzë viteve '90, pesë e gjashtë katëshe, spitale, hotele, seli administrative, reparte ushtarake të lëna shkret, që nuk ishin ca ngrehina të rëndomta si hangarët e kooperativave bujqësore. Ato po kthehen në gërmadha, kurse shteti i paguan qira privatit për zyra administrate(!) Duket se askush nuk do t'ia dijë seriozisht për trashëgiminë ndërtimore, minerare, agrare etj., edhe kur ajo mund të rivitalizohet në shërbim të komunitetit. Përkundrazi, objekte të tilla janë kthyer në objekt grabitjesh të hekurishteve për skrap, duke qenë herë-herë dhe burim aksidentesh.

Do të ishte e dëshiruar që secili të gjente fjalët e mira, të numëronte arritjet, që i kanë hije festës jubilare të 100-vjetorit të Pavarësisë dhe jo të ndalej te mungesat apo dështimet, mirëpo është duke ardhur vjeshta e jemi për të tretin vit para provimit të Europës që nuk dimë do ta marrim apo jo. Uron që kjo të ndodhë sa më parë, që koha europiane të punojë dhe për ne, por më parë duke punuar vetë ne për atë, që në rastin e Bulqizës do të thotë të ketë drejtësi dhe jo mëshirë, sjellje të përgjegjshme e qeveritarëve me pronat publike, kurse sipërmarrësit që vijnë nga shtetet europiane të shtrëngohen që të sillen edhe këtu si kodo në botën e qytetëruar. Bulqiza është një ngjarje shokuese dhe për shkakun e tyre. Në asnjë shtet të Europës nuk do t'ua lejonte kush këtë gjendje merr e mos jep në minierat që shfrytëzohen prej tyre. As në Afrikë. Garante kudo janë qeveritë. Prandaj kambanat për Bulqizën do të vazhdojnë të bien, deri sa t'ia ndalojmë asaj vdekjet e mijëvjeçarit të tretë, pikëllimin e saj të madh.

(Marrë nga Gazeta "Shqip", 5 korrik 2012)

Motrat Keshi, nga zinxhirët në izolim



Në këto ditë të nxehta korriku, pas tre viteve, rikthehemi në fshatin Bllatë e Poshtme, të komunës Maqellarë, në rrethin e Dibrës, për t'iu rikthyer kështu historisë tronditëse të bërë publike nga mediat, ku dy motrat me probleme mendore, Thëllëza e Fidane Keshi, mbaheshin të lidhura me zinxhirë.

Zhurma mediatike e para tre viteve edhe pse i liroi motrat fatkeqe nga zinxhirët, që i mbanin të lidhura prej 20 vitesh, për t'i dërguar për një mjekim të specializuar në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës, përsëri nuk mundësoi që ata të shohin dritën e diellit. Kështu, aktualisht motrat Thëllanza dhe Fidane Keshi, përkatësisht 50 dhe 41 vjeçe, nga të lidhura me zinxhirë, vijojnë të mbahen të izoluara në shtëpi. Gjendja e tyre shëndetësore është rënduar së tepërmi. Në të vetmen dhomë të shtëpisë tip kasolleje, ku ata banojnë të mbyllura brenda me dry, syri nuk të ndesh në asgjë, veçse tre ndenjëse me drurë lisi, që shërbejnë si krevate për të fjetur, dy të motrave dhe njëri i babait të tyre 73 vjeçar, i vetmi që duhet të kujdeset për ta. Sipër drurëve të këtyre "krevatëve" ishte hedhur pak barë dhe vetëm nga një batanie, me të cilën ata mbuloheshin gjatë gjumit. Ndërkohë në këtë të vetme dhomë, motrat e sëmura duhet të kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre ditor, të flenë, ushqehen si dhe të kryejnë nevojat personale. Dukej qartë se gjendja shëndetësore e motrave të sëmura, ishte rënduar së tepërmi. Kjo pasi edhe pse verë, ku vapa e korrikut djeg, motrat qëndronin në "krevate" të mbuluara me batanie dhe me sobë ndezur. Ndërkohë ata pothuajse kanë humbur çdo lloj reagimi ndaj personave të tjerë.

> "Duam ndihma ekonomike që tu krijojmë kushte më të mira jetese për ta. I kemi mbyllur në dhomë, pasi nuk na lejon shteti që t'i lidhim, ndërkohë që nuk mund t'i lëmë të lira pasi ata largohen nga shtëpia. Edhe mjeku i zonës dhe infermierja vijnë dhe i vizitojnë, si dhe u japin ilaçe dhe u bëjnë injeksione"

Vëllai i tyre, që jeton me familjen e tij po në këtë fshat, kërkon ndihmë nga shteti për të përmirësuar sado pak gjendjen skandaloze të jetesës së motrave të tij. "Duam ndihma ekonomike që tu krijojmë kushte më të mira jetese për ta. I kemi mbyllur në dhomë, pasi nuk na lejon shteti që t'i lidhim, ndërkohë që nuk mund t'i lëmë të lira pasi ata largohen nga shtëpia. Edhe mjeku i zonës dhe infermierja vijnë dhe i vizitojnë, si dhe u japin ilaçe dhe u bëjnë injeksione", - thotë vëllai i tyre.

"- Më duhet edhe të punoj, pasi jam krejt i vetëm dhe me një pension invaliditeti prej 8 mijë lekësh, nuk mund t'i plotësoj nevojat familjare, ku një problem më vete mbetet edhe plotësimi i kushteve për higjienën personale të tyre. Mirë sa të jem unë, po pasi të vdes, si do të vejë halli? Kush do kujdeset për ta? Edhe toka nuk do të më "tresë", - thotë krejt dhimbje Hajredin Keshi. " - Më duhet që t'i mbyll brenda në shtëpi vajzat, jo vetëm se ata largohen, por dhe bëhen të dhunshme në momente të caktuara". - thotë babai i motrave të sëmura, i cili që nga viti 1999, kur i ka vdekur bashkëshortja, është i vetmi person që kujdeset për vajzat. (***L.H.)***

Nurie Zhuku, nga Klosi, shet tranguj në rrugën Bulqizë- Burrel "Lekët për vajzën invalide"

Sakrificat e një nëne për vajzën invalide

Nga: **HYSEN LIKDISHA**



Në këto ditë të nxehta vere, syrit të udhëtarëve që lëvizin në aksin rrugor nacional Bulqizë-Burrel, u ka bërë përshtypje një grua e moshuar, që çdo ditë del në rrugë, në përpjekje për të shitur tranguj. Nurie Zhuku, 89 vjeç, nga fshati Fshat i bashkisë Klos, çdo ditë del në rrugën nacionale, ku, para dy lokaleve, në të hyrë të Klosit drejt Burrelit, hap thesin që e mbart në shpinë, duke nxjerrë prej aty trangujt që kërkon t'ua shesë jo vetëm personave që drekojnë në lokale, por edhe kalimtarëve që udhëtojnë në këtë aks rrugor. Për çdo makinë që kalon në rrugë, plaka ngre dorën, në të cilën mban dy tranguj. Pothuajse gjatë gjithë ditës, nga ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 19.00, dora e plakës qëndron e ngritur lart, duke mbetur kështu një imazh dhembjeje në memorien e çdo kalimtari, që rastis të udhëtojë në këtë rrugë.

89-vjeçarja Nurie Zhuku, e veshur me të zeza dhe me një rizë të bardhë akull në kokë dhe opinga llastiku të grisura, ashtu siç dhe është e pastër dhe e fisme, të ngjall respekt dhe njëherësh dhembshuri, pasi mosha e saj nuk mund ta përballojë një sakrificë të tillë. Madje situata për të ndërlikohet akoma më tepër gjatë këtyre ditëve të Muajit të Ramazanit, pasi ajo edhe agjëron, ku për 12 orë i duhet të qëndrojë në rrugë në këtë vapë të padurueshme, pa ngrënë dhe pa ujë. "Zori moj nënë më nxjerr për çdo ditë në rrugë. Më duhet të punoj, pasi duhet të kujdesem edhe për vajzën 50 vjeçare, që e kam të sëmurë invalide. Ka 20 vjet që jetoj e vetme me vajzën, të cilën, pasi u sëmur, ma la edhe burri. Vajzën e kisha të martuar në një fshat të komunës Lis. Duke mbajtur ngarkesa të rënda në shpinë, dëmtoi një nerv që i dha goditje në kokë, duke e lënë invalide përjetë. Në të tilla kushte, burri i saj tre fëmijët i mbajti në shtëpi, ndërsa vajzën e sëmurë e solli tek unë", thotë me lot ndër sy Nuria, ndërsa më pas vazhdon: "Djemtë kanë jetën e tyre me familjet e tyre.

Ndërsa prej 20 vitesh u detyrova të rri me vajzën dhe m'u desh të bëj gjithçka për të jetuar. Marr vetëm 48 mijë lekë të vjetër në muaj, të cilat nuk më mjaftojnë as për ilaçet e mia dhe jo më të vajzës së sëmurë. Për këtë vura në dijeni edhe Kryeministrin Berisha, përmes një letre, që të më kompensonte blerjen e barnave për vajzën. Kjo bëri që vlera e recetës mujore të barnave për vajzën të ulet me 70 për qind. Por edhe pse janë ulur, më duhet të paguaj 36 mijë lekë të vjetër. E ku t'i marri nëna lekët, përveçse duke dalë në rrugë që të shes prodhime të kopshtit tim?". Largohemi duke u ndarë nga plaka e mirë dhe e urtë, që edhe pse në moshë shumë të thyer, halli për mbijetesë e ka detyruar të dalë çdo ditë në rrugë për të shitur prodhime të kopshtit të saj, në këmbim të pak lekëve që ajo mund të fitojë. Së brendshmi ndiejmë jo vetëm keqardhje, por edhe revoltë, kur ndeshim në praktika të përfitimit të KEMP-it nga persona që i kafshojnë qentë dhe nuk përfiton vajza invalide, e mbetur e tillë nga ngarkesat e rënda të mbartura në shpinë, ku fati i keq e ndau nga tre fëmijët e saj, për ta lënë të vetme me nënën 89-vjeçare, pa asnjë lloj përkrahje e ndihme!

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

vështrime



I am from Kalaja e Dodës!



Nga:
EDISON YPI

-I am from Kalaja e Dodës.

-Të pyeta Shqip. Pse m'u përgjigje Anglisht?

-Është e vetmja pyetje, së cilës, të gjithë ne këtu i përgjigjemi vetëm Anglisht. Më bëj pyetje të tjera të përgjigjem Shqip.

Hodha për të njëmijtën herë sytë rrotull i mahnitur nga pamja frymëndalëse e asaj lagjeje. Pak vite më parë ay vend ishte një bosh. Sot qindra shtëpitë e reja, dhjetëra vila gjigante, kopshte të gjelbërta, basene të kaltërta, rrugë të asfaltuara, dy shkolla, vorreza.

-Çfarë di ti për vendin e origjinës, Kalanë e Dodës?

-Kalaja e Dodës, prej nga kam ardhur unë dhe shumica e atyre që popullojnë këtë lagje, është një vend i vogël 80 kilometra katrorë në verilindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë, 35 kilometra larg Kukësit, dhe po aq larg Peshkopisë. Ndodhet rrëzë Malit të Korabit në lartësinë nga 1000 e ca deri në 3000 e ca metra mbi nivelin e detit. Kalaja e Dodës, që unë nuk e di as ku është ajo Kala e as cili ka qenë ai Dodë, është një parajsë natyrore me njerëz energjikë, historikisht punëtorë dhe dramatikisht të varfër. Me ajër të pastër, dimër të ashpër gjysmën e vitit mbuluar nga dëbora, ujëra rrjedhës, pyje dhe kullota, të gjitha të bukura si nëpër ëndrra. Babai im bashkë me të tjerë, para se të vinin të ndërtonin këto vilat këtu, kanë tërhequr njëri-tjetrin në Angli. Prej gjithsej 3500 banorë që ka pasur Kalaja e Dodës, tani atje kanë mbetur fare pak.

-Pse në Angli?

-Në Angli sepse ne të Kalasë së Dodës që e kemi shumë të zhvilluar nuhatjen, kemi kuptuar që Anglia është vend që paguan shumë ata që punojnë shumë. Anglezët dhe ne të Kalasë së Dodës jemi si dy njerëz, prej të cilëve, i pari ka paret dhe i duhet puna, i dyti ka punën dhe i duhen paret. Kjo vila ime që po sheh këtu, besoj se e dëshmon çfarë po të them.

-Faleminderit për këto shpjegime kaq të sakta. Por a s'më thua, çfarë di për Anglinë ti from Kalaja e Dodës?

-Anglia është Mbretëri, ka Mbretëreshë, është vend i pasur. Por ajo që mua më mrekullon më së shumti, është se Anglia nuk ka Kushtetutë të shkruar. Që domethënë se anglezët e bëjnë sot Drejtësinë si e kemi bërë ne para disa shekujsh, me Kanun, të cilin shqiptarët analfabetë e dinin përmendësh. Mungesën e Gjakmarrjes dhe të ngujimit në Anglinë e sotme, s'di se si ta shpjegoj.

-Më mahnite me këto njohuri kaq të holla dhe të thella o i Kalasë së Dodës. Ti me shkollë të mesme di për Anglinë më tepër se 100 eksperta me diploma kristalore dinë për Shqipërinë. Po ti tjetri nga je?

-I am from Zall Dardha. Në këtë lagje prrallore, në këtë Little England, ne *from Zall Dardha* jemi më pak se këta që janë *from Kalaja e Dodës*. Por edhe në kemi ndërtuar vila. Ja, ajo atje me tre kate me pamje nga liqeni është e imja. Dy vëllezërit e mi më të rritur se unë që punojnë në Londër më kanë thënë se një vilë të tillë anglezi edhe mund ta ndërtojë, por, ose me djersën e pesë brezave, ose kurrë. Little England, e shtrirë Lindje-Perëndim, është pak më tepër se 3 kilometra e gjatë dhe nja 2 kilometra e gjerë. Që i bije nja 12 herë më e vogël se Kalaja e Dodës. Por mos harro se Kalaja e Dodës ka aq shumë brigje, brinja, gërxhe dhe thepa, sa po ta hekurosësh bëhet më e madhe se Europa, fakt ky, me të cilin, ne *from* Kalaja e Dodës, me të drejtë krenohemi. Dembelat dhe parazitat pështpërisin se ne dibranët sjellim nga kurbeti vetëm pare dhe asgjë tjetër. Unë *from* Zall Dardha që lexoj libra dhe gazeta, shoh televizor, dhe vozis në Internet, i kundërshtoj me neveri gënjeshtrat që përhapin ata. Dibrani sjell nga Anglia gjithçka që Anglia ka.

-Faleminderit. A mund t'i plotësosh ti tjetri këto që tha ky *from* Zall Dardha lidhur me atë se çfarë sjell Dibra nga Anglia? Së pari prezantohu, thuaj nga je.

-I am from Maqellara. Unë që kam një xhajë në Mançester dhe një baxhanak në Liverpul i di mirë këto gjëra. Dibra, me në krye ata *from Kalaja e Dodës*, si e tha me aq takt parafolësi, sjellin nga Anglia jo vetëm Sterlinën, por edhe vlera; Seriozitetin, edukatën, dashurinë për punën, rregullin, respektin, disiplinën, shkurt qytetërimin. Xhaja i Mançesterit më ka thënë se anglezët nuk janë zevzekër si në shqiptarët, por njerëz të qetë. Ne shqiptarët shtyhemi në radhë. Anglezët, që ndoshta edhe ata ziejnë përbrenda kur presin nëpër radha, në pamjen e jashtme duken të përmbajtur. Ne shqiptarët s'na zë gjumi i natës pa futur hundët tek punët e tjetrit. Anglezi sheh hallin e vet. Kam ditur edhe gjëra të tjera për Anglinë. Se unë i kam lexuar të gjitha librat e Shekspirit n'trillik. Por tani që u bëra 43 vjeç dhe jam martuar e kam dy fëmijë, pra tani që më iku mosha dhe nuk lexoj më se u plaka, i kam harruar të gjitha.

-Ti tjetri, ti që rri si mënjanë, a di ti për Anglinë ndonjë gjë më tepër se ky maqellarsi që e nisi bukur por e bitisi si mos më keq me harrimin e vetes dhe të Shekspirit në lulen e moshës? Së pari thuaj nga je, pastaj vazhdo.

-I am from Çereneci. Anglia është kujdestarja, shërbëtorja, nëna, gjyshja e qytetërimit. Anglia është ajo që e rrotullon në majë të gishtit të mesit të dorës së djathtë të gjithë politikën e botës. Kaq di unë për Anglinë. Thuaj bereqaves edhe kaq. Se edhe këto me të thëna i kam. Se vet nuk kam qenë kurrë në Angli dhe s'kam asnjë të afërt atje. Shtëpinë e kam ndërtuar me krahët e mia, domethënë me lekë, jo me Sterlina. Nuk më vjen turp që di kaq pak për Anglinë. Po deshe të dish më tepër pyet këtë tjetrin që është nga një tjetër fshat i Dibrës. Fol ore ti.

-Faleminderit që ma dhe fjalën ti *from Cereneci*. *I am from Muhrri.* Në Angli unë kam dy djem daje. Anglia është ishull. Ka qenë Perandori. Edhe tani është Perandori por me një emër tjetër që i ngjan emrit të një krahine të Kuksit, Krumauellth, apo diçka e tillë. Djemtë e dajës më kanë thënë se Perandoria e Anglisë ka qenë aq e madhe sa dielli nuk perëndonte kurrë. Kalaja e Dodës e Shqipërisë ka disa ngjashmëri me Kalanë e Dosës së Anglisë, që është Skocia. Këto dy Kala Dode, edhe pse aq të largëta, kanë ngjashmërira antropometrike dhe fjalë të përbashkëta. Këto gjëra nuk janë plotësisht të vërtetuara. Por ku ka zë s'është pa gjë.

-Po ti me quka në turi, di ti ndonjë gjë për Anglinë? Kujdes, thuaj së pari nga je, pastaj ato që di.

-I am from Ostreni. Kam një djalë xhaje në Londër. Ai më ka thënë se të gjitha shpikjet e botës i ka bërë anglezi. Më ka thënë edhe plot gjëra të tjera për shkathtësitë e atyre *from Kalaja e Dodës* për të sjellë nga Anglia makina me timon nga e djathta. Por sidomos për talentin e lindur që kanë për të hapur rrugë të reja. Një proverb turk thotë; "Kur nisesh për të vajtur diku, pyet së pari a ka qenë atje ndonjë dibran. Po të thanë "Po" nisu edhe ti". Se dibrani është rrugëhapës, pionier. Jo pionier i kurvit. Pionier i shtigjeve të reja të mbijetesës. Gjë që e provon më së miri edhe fakti se ata *from Kalaja e Dodës* janë mërgimtarët e parë shqiptarë qysh në kohën e diktaturës. Në atë kohë ata shkonin në pyjet e Tepelenës ku mblidhnin Shqopë për llulla dhe sende të tjera artizanale të drunjta. Përveç *"I am from Ostreni"* që ma ka mësuar xhaja kur erdhi parvjet për të parën herë pas 12 vjetësh, di edhe një fjalë tjetër anglisht, që është fjala *"OK"*.

-Ti që gjithë kohën qesh duke dëgjuar miqtë e tu, prezantohu së pari, pastaj na thuaj edhe ti çfarë di për anglezët dhe Anglinë.

-I am from Zerqani. Unë di Anglisht më tepër se këta. Unë di edhe *"Yes"*, *"No"*, dhe *"I love You"*. Unë do t'ju them një gjë që ma ka shpjeguar gjatë e gjerë në telefon një djalë halle që e kam në Birmingham. Është diçka që nuk mund të kuptohet nga kushdo por vetëm nga njerëz me ndjeshmëri të veçantë. Dibra dhe Kalaja e Dodës janë kufi. Në kohën e kurvit, nga Tirana dhe qytetet e tjera një numër shqiptarësh i afroheshin kufirit me lloj-lloj mënyrash për t'u arratisur. Të gjithë kapeshin. E di pse? Sepse i spiunonim ne. Baballarët tanë dua të them. Se ne atëherë as që kishim lindur. Ky është një turp dhe një mëkat tepër i madh për ne dibranët. Mëkat që na duhet ta shlyejmë sa më shpejt duke iu lutur 10 herë në ditë me lot në sy Allahut. Shihe mirë këtë perlë urbane. Këtë lagje ëndrrash. Këtë dëshmi të gjallë të aristokratizmit që po zëvendëson rrugaçërinë. Këtë provë se shlyerja e mëkatit ka nisur. Ah, se për pak harrova; Kjo *Little England* këtu është edhe një rast i çuditshëm kolonizimi, si të thuash, i vetvetes, pra tepër i koklavitur, që i kapërcen aftësitë e mia për ta shqyrtuar. Besoj se të lashë të kënaqur me këto shpjegime.

-Po, por ky veshllapushi këtu sikur po kërkon të shtojë diçka. Nga je o llapush?

-I am from Dibra. Në fakt *I am from Kalaja e Dodës*, por të thashë *I am from Dibra* sepse unë nuk bëj dallime me fshatra. Në Angli unë kam dy kunetër, dy burra motrash, për të cilët, nëse më lejoni, dua të bëj një saktësim lidhur me diçka që prej kohësh më gërryen përbrenda.

-Po. Të lejojmë ta bësh saktësimin që të lirohesh nga gërryerja e brendshme që është rreziku më i tmerrshëm që u kanoset kurbetlinjve në përgjithësi, juve *from Kalaja e Dodës* në veçanti.

-Këtu në këtë lagje luksoze me emrin e bukur *Little England*, qarkullojnë fjalë të liga. Ata që me kurbetin kanë probleme thonë se ne *from Kalaja e Dodës* kemi nga dy gra. Si pas tyre, ne, sapo vemi në Angli, për të bërë sa më shpejt letrat, martohemi atje me një angleze të cilën e gjejmë menjëherë sepse dihet që për anglezet ne *from Kalaja e Dodës* jemi mzata të preferuar. Pasi grumbullojmë ca pare dhe bëjmë një apo dy fëmijë me anglezen atje, vijmë ndërtojmë vilë këtu, dhe martohemi edhe një herë tjetër këtu, me një shqiptare, mundësisht dibrane. Pastaj ikim përsëri në Angli. Ku vazhdojmë të qetë jetën tjetër me gruan tjetër, anglezen. Këto shpifje të ndyra me dy gra dhe dy jetë për ne from Kalaja e Dodës unë i hedh poshtë me neverinë më të madhe. Sepse unë këtu në *Little England* kam dy motra të martuara me dy burra from Kalaja e Dodës që punojnë në Angli, njëri në Londër tjetri në Birmingham, njëra me dy, tjetra me tre fëmijë, të cilat këtu, edhe pa burrat e tyre, e kalojnë jetën për bukuri. A isha i qartë?

-Ishe goxha i qartë. Por kjo që the për dy jetët me grua këtu dhe burrë atje, duke qenë e paverifikueshme, mund të jetë edhe subjektive, pra gënjeshtër. A ke ndonjë gjë objektive për të thënë për Anglinë?

-Po. Është një episod mahnitës që ma ka treguar një nga kunetërit. Kunati im punon dhjetë orë në ditë. Pronari i tij punon çdo ditë jo më pak se dymbëdhjetë orë. Një ditë, ngaqë ashtu qe' një problem, kunati ndejti në punë njëlloj me pronarin. Kur do iknin, kunati vuri re se pronari nuk u vesh thjesht si vishet gjithkush që pas pune kthehet në shtëpi. Kunati u habit dhe e pyeti Xhonin, se kështu e quanin pronarin;

-O Xhon, pse nuk je veshur thjesht përderisa do ikësh në shtëpi?!

-Sepse, iu përgjigj Xhoni, nuk do iki në shtëpi, do iki në shkollë.

-Në shkollë?! Ti je mbi 50 vjeç! Ende shkon në shkollë ti?!

-Unë do vete në shkollë sa të jem gjallë.

-Pse?

-Sepse dua të vdes i ditur.

Këtu mbaroi kjo bisedë e improvizuar me ata të rinj dibranë tigra dhe luana që mezi i mblodha.

Vajta, dhe do vete, edhe herë të tjera në këtë lagje të magjishme. Pa folur për Fierin i cili është pothuaj i tëri një *Little Italy*, si dhe plot vende të tjera më të vogla nga Shkodra në Vlorë që janë gjithashtu të tilla, ka sot në Shqipëri edhe disa *Little Grecce*, madje edhe disa *Little China*, dhe të tjera.

Por asnjëra prej tyre nuk është aq mahnitëse, aq rrezëllitëse, aq e qetë, aq e pastër, aq e rregullt, aq elegante, aq diskrete, aq aristokratike, sa Little England ndërtuar me djersën dhe gjakun e atyre from Kalaja e Dodës.

Ku ndodhet *Little England?!*

Fare afër. Te dera. Mos e zgjat. Nisu. Tani. Kalo Lumin e Tiranës mbi urën e Babrroit. Ngjitu mbi kodër. Aty e ke. Më interesante se çdo muze' historie me bëma mbretërish dhe perandorësh. Më magjepsëse se çdo ekspozitë me piktura dhe gravura ku secila kushton miliona. Më sugjestive se çdo Aulë universitare ku një profesor me mjekër pritet të flasë për zanafillën e Universit. Kur ta shohësh mos harro të bësh krahasimin. Jo me dje e pardje. *Me many tears ago.*

Rruga e Arbërit nr. 75

reportazh



Shumbat. Mullar bari mes arave me grurë







Fruta të stinës:
Pjeshkë, dardhë dhe mollë

Dibra përtej një fotografie

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Fund qershori. Moti është me diell dhe rruga nga Kalaja e Dodës për Peshkopi, megjithëse kthesa-kthesa, është e këndshme. Ajri është i freskët. Gjelbërimi ka mbuluar kodrat dhe fushat anës Drinit dhe të bën të mendosh, për një moment, se jeta në këto anë është e bukur...

NË SHUMBAT

Por kjo ndjesi fillon e ikën pak nga pak, kur takon njerëzit që punojnë arave. Ndalesa e parë është në Shumbat, ish një ndërmarrje bujqësore, e njohur në të kaluarën për prodhimin e kultivarëve të ndryshëm të kumbullës, e më pak të arrës dhe mollëve.

Por tani pemët frutore janë prerë. Në vend të tyre tokat janë mbjellë me jonxhë, misër e grurë. Gruri këtë vit duket i mbarë, por misri jo dhe aq.

Rexhepi Fana është njëri nga banorët e Shumbatit, në pritje të ujit për vaditjen e misrit. Mbjellja e parë nuk doli, kështu që u detyrua të rimbillte. Vetëm dy ditë që ka dalë nga spitali dhe mjekët e kanë këshilluar të rrijë në shtëpi, të mos lëvizë e të mos stresohet, por ai nuk mundet...

Shumbati nuk vuan shumë për ujë. Liqeni, i vendosur mbi fshat, anës rrugës, i plotëson nevojat për vaditje. Të paktën këtë muaj të nxehtë. Por një orë ujë kushton 300 lekë, kështu që ai përpiqet të mos e harxhojë kot. Saimiri, vetëm 14 vjeç, është në arën me misër, ndërsa vajza 12 vjeçe bën vazhdimisht ecejaket lart e poshtë në rrjedhën e ujit, të mos ndërpritet diku. Ndërsa Rexhepi i kontrollon të dy në vapën e madhe dhe ngre herë pas here zërin për t'u kujtuar fëmijëve se është aty dhe i ka nën vëzhgim.

"- Po i vadisim, por nuk e dimë se çdo korrim! Misri nuk doli sivjet. Kam mbjellë 3 dynym dy herë. Shikoje misrin në arë, lartësia ndryshon".

Rexhepi ka mbjellë 4 dynym grurë. Në dukje dukej se do kishte të korra të mbara, por mori vetëm 13 kv grurë në total. Sa për bukën e vitit. Shpreson që edhe misri të prodhojë, të paktën për bagëtinë. Por, po t'i vësh në balancë, nuk del llogaria.

"- Duke llogaritur shpenzimet për mbjelljen, plehërimin, vaditjen, korrjen dalim aty-aty, por na vjen marre me e lënë tokën djerrë".

"- Është e vështirë jeta në fshat. Toka duhet punuar por nuk jep rezultat. Na mungon tregu, na mungon rruga, nuk janë kushtet. 500 lekë kushton një kg farë misri, por një kg misër kushton vetëm 40 lekë. Dora e shtetit nuk ndjehet këtu. Qeveria nuk i di problemet e fshatit, as nuk ka mendjen t'i mësojë ato.

"- Po pemët - i them Rexhepit, - a ju sjellin ndopak të ardhura?" Ai nuk flet, vetëm tund kokën mohueshëm.

KODRAT E THATA

Pas Shumbatit dua të kaloj në vendlindjen time. E marr Saimirin me vete dhe ai merr po ashtu dy shokë të tij. Do të shkojmë të lahemi në Drin. Rruga nuk ka hije. Dikur rruga kalonte mes frutikulturës, por tani kalojmë fushën e Shumbatit mes për mes arave, për të rënë në Topuze, një fshat me rreth 10 shtëpi mes Fushë Alies dhe Zall Dardhës. Në Topuze, buzë lumit, lahen vetëm fëmijë. Kur të shohin me një aparat fotografik, të vegjlit bëjnë garë kush të hidhet në lumë më mirë. Ndërsa prindërit e tyre janë në ara duke vaditur.

Në kodrat që ngrihen mbi Drin, nuk ka më asnjë shkurre. Drurët janë prerë dhe fieri i ka mbuluar ish tarracat e ndërtuara në vitet '80. Kullotat janë mbuluar nga barishtet e egra dhe bari ka filluar të zverdhet.

Fotot e shkrepura rrugës kanë të gjitha një ngjyrë. Haki Kola, një ekspert i mjedisit, çuditet nga këto foto. "Duket vërtet e frikshme. Më kishte gënjyer mendja se nuk kemi më të tilla. Kështu ishin hapësirat rreth fshatrave sapo hyri viti 1990 e më pas dikush u doli zot e hap pas hapi u transformuan e u veshën. U dashka ruajtur për muze, se si bëhet toka kur humbet vizioni për të ardhmen...."

NË FUSHËN PA BEREQET

Në Fushë Alie nuk ka vizion për të ardhmen. Aty ku njerëzit nuk dinë se ç'bëjnë sot, nuk mund të kenë vizione për të nesërmen.

Nazifi Alia është një banor i Fushë Alies. Ai ka punuar shumë kohë në Greqi, në punë të ndryshme, por me intuitë, mbolli para ca vitesh rreth 6 dynym tokë me frutikulturë. Mollë, rrush, pjeshkë, dardhë dhe qershi. Asnjë vit nuk ka pasur prodhim të kënaqshëm. Rrushin që mbolli herën e parë, rreth 1.5 dynym, e shkuli, pasi varieteti që kishte nuk bënte për klimën. Por as ai që ka mbjellë tani, nuk ka pasur rezultat. Këtë vit mendon ta rishkulë dhe në vend të rrushit të mbjellë pjeshkë dhe dardha.

Mollët prodhuan vitin e kaluar rreth 35 kv. Rreth 15 kv ia shiti me 20 lekë / kg një tregtari nga Fushë Kruja, por 25 kv të tjera iu prishën. Nuk nxori as shpenzimet. Sivjet ai shpreson shumë te pjeshkët. Ka mbjellë pjeshkë mbi 1 dynym dhe shpreson të prodhojë rreth 10 kv. Natën fle me to, i ruan. "Nuk më dhimbsen se i vjedhin, por m'i prishin", - thotë ai. Shpreson ti shesë me 80 ose 90 lekë / kg. "- Nuk kam ndonjë kontratë fikse, por ngaqë është stinë dasmash dhe nuk ka fruta të tjera në këtë stinë, mendoj se do t'i heq".

Në Fushë Alie, ashtu siç duket edhe në foto, duket se nuk ka tokë të pambjellë. Ashtu si edhe në Shumbat, gruri duket mirë, por misri po thahet për ujë. Ujë vjen nga përroi i Blliçes, por banorët e presin kohë e pa kohë dhe në fshatin Rrethas uji është i përmallshëm.

Nazifin e merr në telefon Nexhipi. Ka shtatë ditë që ka prashitur misrin, por uji s'po i vjen. S'di ku ta kërkojë, kështu që ka bërë një ofertë me një numër AMC dhe merr kë të mendojë se mund t'i japë një zgjidhje. Në komunë u kanë thënë se duhet të ngrenë një komision për ujin. Dikush mendon se këtë duhet ta zgjidhë komuna. Komuna, nga ana e saj, mendon se fshati duhet të nxjerrë një përfaqësues që të marrë përgjegjësinë mbi ujin. Sidoqoftë, uji që duhet t'u vinte natën, nuk vjen.







Në foto: Fusha e Shumbatit. Nje vajzë duke u freskuar në Dri. Kodrat mbi Drin

aktualitet


Fushë Alie

Duhet ndërtuar një treg rajonal për prodhimet bujqësore; duhet rritur kapaciteti përpunues i frutave, rritja e kapaciteteve frigoriferike me të paktën 10 herë, nga 500 ton që është sot; ndryshimi i strukturës së fermës: nga prodhuese e drithërave në prodhuese e frutave, bimëve mjekësore dhe blegtorisë së imët. Ne mund dhe duhet të kemi 1000 ha të mbjella me bimë mjekësore, që kanë një treg të sigurt dhe të ardhura të mira, si dhe rreth 1 milion të imta, kur sot kemi 180 mijë.

PROBLEMET E BUJQËSISË

Dali Horeshka, një specialist i bujqësisë, sot punon si koordinator i SNV/PROMALIT në Dibër. Ai thotë se sot në Dibër të ardhurat janë mesatarisht jo më shumë se 150 000 lekë të ardhura neto për 1 hektarë, kur ky raport duhej të ishte 750 000 - 1 000 000 lekë për hektarë.

Horeshka thotë se një nga problemet kyçe të bujqësisë në Dibër është çështja e ujit për vaditje. Për të pasur një prodhim sasior e cilësor, - thotë ai, duhet jo vetëm sigurimi i ujit për vaditje, por edhe tentimi i shtrirjes së vaditjes me pika. Gjithashtu, ai rendit edhe një listë problemesh që kanë nevojë për zgjidhje emergjente për një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë.

Duhet ndërtuar një treg rajonal për prodhimet bujqësore; duhet rritur kapaciteti përpunues i frutave, rritja e kapaciteteve frigoriferike me të paktën 10 herë, nga 500 ton që është sot; ndryshimi i strukturës së fermës: nga prodhuese e drithërave në prodhuese e frutave, bimëve mjekësore dhe blegtorisë së imët. Ne mund dhe duhet të kemi 1000 ha të mbjella me bimë mjekësore, që kanë një treg të sigurt dhe të ardhura të mira, si dhe rreth 1 milion të imta, kur sot kemi 180 mijë.

Horeshka këshillon edhe mundësinë e ndërtimit të shoqërive bujqësore, që do të ndihmonin shumë në rritjen e prodhimit dhe të ardhurave për banorë.

DRINI: UJË DHE DINAMIT

Lugina e Drinit duket bukur nga larg. Por nga afër, nuk të jep ndonjë kënaqësi. Është e diel, datë 1 korrik, dhe pranë Urës së Muhurrit do të organizohet "Festa e Drinit". Ura e Muhurrit, e ndërtuar që në "kohën e Italisë", mbahet e kalueshme nga disa dërrasa, ndërsa këmbët i kanë dalë nga gërryerjet. Në të dy anët e urës është gërryer nga ekskavatorët që nxjerrin zhavorr dhe ura është në rrezik. Kjo urë është e rëndësishme për Qarkun dhe prishja e saj do të ndante në dysh Dibrën. Dhjetëra fshatra në komunat e Muhurrit, Arrasit, Lurës e Dardhës, do të ishin të izoluara.

Anës urës toka është e zhveshur. Dielli i korrikut është përvëlues, por kjo nuk i pengon qindra banorë, kryesisht nga qyteti, të bëjnë plazh të dielën. Pak më poshtë, afër fshatit Rreth Kale, disa lisa të gjatë bëjnë hije dhe është vend i mirë për turizëm ditor. Një lokal i vogël, që ngjan me një kolibe, ofron për pushuesit karrige, tavolina dhe pije të ftohta. Është qetësi dhe mund të shijosh flladin e lehtë buzë lumit, por plasjet e dinamitit në pellgun e Drinit ta prishin qetësinë. Fëmijët e mi çuditen dhe tremben. Ku është policia? Emini është një banor i Muhurrit. Ai thotë se "dikur, në këtë lum peshku kapej me dorë. Ishte një periudhë që njerëzit iu kthyen grepit për peshkim, më shumë si sport. Tani nuk ka më peshk, por gjuetia e dinamitit është kthyer në një sport të ri".

Vrasja e peshkut me këtë mënyrë është e ndaluar, por asnjë polic nuk ndodhej aty, megjithëse plasjet nuk pushuan gjatë gjithë drekës. Megjithatë, qindra të njerëz, kryesisht fëmijë e të rinj, festonin "Festën e Drinit", 100 m më lart.

PESHKOPIA, "A E NJEF ME E PA?"

Qyteti i Peshkopisë është i bukur natën. Sidomos në këtë periudhë. Kafenetë e mbushura plot, ku kundërmon gjatë ditës erë kafeje dhe alkooli, janë të mbyllura. Gjithashtu edhe njerëzit që "vrasin" ditën lart e poshtë nën hijen e blireve, kanë ikur.

Katër vite më parë këtij qyteti iu dhurua nga Zaim Korsi dhe Sadik Spahia një shtatore e bukur e Skënderbeut. Ajo u kthye në një kënaqësi për turistët dhe emigrantët. Ndërsa të pasionuarit e historisë, të dehur pas betejave legjendare me Skënderbeut, u ngjallën me shkrimet e tyre për heroin. Shtatorja tani ka humbur shkëlqimin e vet. Një foto pranë shtatores do të të nxjerrë në sfond edhe një kioskë-kafene. Skënderbeu është rrethuar me karrige dhe historianët amatorë lokalë kanë mundësi ta ngrenë një shëndet me fund ... me Gjergjin. Kjo tablo karakteristike bëhet sarkastike nga tabela që reklamon një shfaqje të Estradës Profesioniste të Peshkopisë. "A e njef me e pa!". Unë nuk e pashë dhe nuk e njoha, por ata që e kishin parë, më thanë se mirë bëra. Një e qeshur e ngritur mbi të folurën dialektore, pa ritëm e pa bukuri dhe aktorë që të imponoheshin më zërin e lartë dhe talljet pa kuptim. "Shkuam për të dëgjuar Lundrim Paçukun dhe ia vlejti, por aktorët e humorit u tallën me spektatorin".

Qyteti natën është i paqtë, por dritat e reklamave të bankave dhe dyqaneve në dy anët e bulevardit, të kujtojnë se e nesërmja do të jetë si gjithmonë: pa shpresë!

PRANË LLIXHAVE

Llixhat, 2 km në veri të Peshkopisë, është i vetmi vend që gjallëron në këtë periudhë viti. Nga prilli deri në qershor shtëpitë dhe hotelet anës saj popullohen nga banorë të ardhur nga gjithë vendi. Donika, një banore e kësaj lagjeje, thotë se ata që vijnë këtu janë njerëz të vuajtur. Hallexhinj. Kursejnë qindarkat për të ardhur 10 ditë në llixha dhe po ashtu kursejnë edhe në hoteleri dhe gatim. Në hotel për 10 ditë kushton 120-140 Euro, përfshirë ushqimin, ndërsa në shtëpitë private çmimi është më i lirë. Ajo sot do të merret me pastrimin e dhomave, pasi nesër mund t'i vijnë njerëz për hotel. Ndoshta edhe nuk vijnë, varet nga fati. "Dalin e i presin që poshtë, në qytet, por unë nuk kam njeri këtu, nxjerr djalin te dera e llixhave dhe nuk mbetemi pa ndonjë të shtruar".

Lena dhe Refija janë dy gra nga Përmeti që jetojnë në Tiranë. Ato janë me fat, se kanë një punë që paguhen mirë. Ato punojnë si sanitare shtëpish në kryeqytet, por klientët e tyre janë të kamur: politikanë, biznesmenë. Ato vijnë të marrin te Donika perime të freskëta, qepë, speca, domate, kastravecë, pasi e kishin ndihmuar të prashiste patatet!

"- Ushqimet janë shumë të mira, - thotë njëra, - por këto bëjnë një jetë të keqe. Unë vërtet pastroj shtëpitë e botës në Tiranë, por paguhem mirë", ndërsa këtu jetesa është e vështirë, pavarësisht shijes së mirë të perimeve".

Ka prej atyre pushuesve që nuk i bëjnë llixhat brenda mjediseve të kompleksit, por lahen në një gropë me ujë, jashtë murit rrethues. "Nuk kanë para, ndaj e bëjnë këtë, - thotë Donika. Kështu që këta turistë "hallexhinj", të sëmurë e të dërrmuar, nuk kanë mundësi të marrin jo vetëm shërbim kurativ cilësor, por as edhe një kontroll të thjeshtë mjekësor.

ËNDRRA ME TURISTË

Banorët e përroit të llixhave kanë zbritur nga fshatrat e Zagradit, Bellovës, Cerjanit e Rabdishtit. Rabdishti, një fshat 5 km në veri të llixhave, duhet 1 orë për të shkuar në këmbë. Rruga është e prishur, por ashtu edhe për në fshatrat e tjerë. Por, fshati është vendosur në mes të një kanioni, duke i dhënë një pamje mahnitëse dhe tërheqëse për turistët.

Në fshat janë shumë të përhapura legjendat urbane. Sa aktuale aq dhe mitologjike.

Rruga është shumë e dëshiruar nga banorët. Një rrugë e mirë do ta kthente fshatin në një qendër të zhvilluar dhe në një lagje të qytetit. Një banor i fshatit na tregoi se një ish-ministër, lindur në këtë fshat, kishte siguruar

(Vijon në faqen 8)


Plazh pranë Urës sëe Muhurrit.



Shtatorja e Skënderbeut

Rruga e Arbërit nr. 75

vendlindja

Harta topografike e rajonit Lajthize
(Marre nga harta ne shkalle 1:25 000)



LAJTHIZA

Nga: **NIKOLL KOLA**

Fshati Lajthizë shtrihet në kufirin midis tre rretheve: Kukës, Dibër dhe Mirditë. Ky fshat përbëhet nga dy lagje: Lajthizë dhe Drobaj. (Qendra e fshatit është në Drobaj). Shtrihet në kuotat në gjerësinë gjeografike 20o dhe 14', dhe gjatësinë gjeografike në 41o 53'.

Ka një sipërfaqe rreth 20 km2 me 956 ha sipërfaqe tokësore, nga të cilat 32 ha tokë arë e pemëtari, 794 ha pyje, livadhe e kullota dhe 130 ha tokë inproduktive. Nga toka bujqësore vetëm 3.2 ha është e vaditshme, ndërsa pjesa tjetër e tokës është mbi ujë.

Lajthiza është në kuotën mesatare mbi nivelin e detit 1180 m, ka një temperaturë mesatare vjetore në 7,7oC.

Rreth viteve 1875 Lajthiza u krijua si fshat më vete me prejardhje të popullsisë nga Oroshi. Fillimisht banorët veronin bagëtitë pastaj me kalimin e kohës u vendosën me banim të përhershëm ku ndërtuan edhe banesa të përhershme.

Deri në vitin 1990 fshati Lajthizë përbëhej nga 74 familje me 418 banorë. Në vitin 2000 Lajthiza kishte 227 banorë me 65 familje dhe në vitin 2010 mbetën vetëm 23 banorë me 6 familje.

Lajthiza lidhet me rrugë automobilistike nëpërmjet Mirditës (Rruga e Kombit). Lajthiza nga krijimi i saj e deri në vitin 1946 është administruar nga rrethi i Mirditës, me qendër lokale Shën Pal dhe Reps të Mirditës. Në vitin 1947 deri në vitin 1978 Lajthiza është administruar nga rrethi i Dibrës përkatësisht në lokalitetet Arrmallë dhe Lurë, kurse tani ky fshat administrohet nga rrethi i Mirditës (komuna Orosh me qendër Repsi).

Lajthiza që në vitin 1946 ka pasur shkollë fillore dhe më vonë shkollë 8-vjeçare. Janë shumë djem e vajza që mësimet e para i kanë marrë në këto shkolla e pastaj në Universitetin e Tiranës dhe universitete të tjera shqiptare dhe sot këta djem dhe këto vajza janë titulluar mësues, profesorë, inxhinierë, juristë, avokatë, mjekë dhe disa specialitete të tjera.

Lajthizakët i lindi Zoti në këtë trevë të bukur. Ata u rritën bujarë, mikpritës, njerëz të besës dhe trima për mbrojtjen e vatanit të tyre dhe trojeve shqiptare e më tej. Ky popull kultivoi patriotizmin dhe luftuan kundër pushtuesit turk dhe ushtrive serbe sa herë që ata mësyen pushtimin ndaj krahinës.

Për rrjedhim nga fshati Lajthizë dhanë jetën kundër pushtuesve disa nga burrat më në zë të kësaj treve, ranë dëshmorë të atdheut për të mos vdekur kurrë, bënë histori dhe mbetën të përjetësuar në historinë e shqiptarizmit.

Fshati Lajthizë është një vend shumë piktoresk me prirje zhvillim të blegtorisë e bletarisë, turizëm malor veror me shumë bimë medicinale e mjekësore me dobi shëndetësore.

Në Lajthizë janë bërë shumë punime gjeologjike për zbulimin e mineralit të kromit dhe hekur-nikelit ku janë bërë zbulime të konsiderueshme sasiore dhe cilësore të këtyre mineraleve të dobishme.

Kompani dhe persona juridikë janë pajisur me leje zbulimi dhe shfrytëzimi nga autoriteti shtetëror kompetent e vazhdojnë punime intensive. E ardhmja është në favor të Lajthizës dhe lajthizakëve, për të gjitha drejtimet që kompozuam në këtë enciklopedi të shkurtër.

Kufijtë etno-kulturorë të fshatit Lajthizë janë të vendosur nga Kapidani i Mirditës dhe Pleqësitë e krahinave ndërmjet Arrnit, Lurës, Fanit që në vitin 1830 për shkak të konfliktit ndërmjet popullsisë së Lurës dhe të Oroshit, kufij të cilët përfshihen në mënyrë analitike dhe të saktë në hartën topografike të rajonit Lajthizë (Orosh – Mirditë). (Marrë nga harta me shkallë 1:25.000).

Në vitin 1910 për shkak të konfliktit ndërmjet barinjve të Oroshit, Fanit dhe Lajthizës nën drejtimin e Kapedanit të Mirditës, pleqve të Oroshit, Fanit dhe Lajthizës u bë ndarja e kufirit (Bjeshkës së Lajthizës) si fshat me kullotat e tij më vete në Perëndim të fshatit që përfshin Shpella e Korbit, Hurdhat e Marlurës, Gjurma e Shenjtit (Fushë Lugje), Shkalla e Fanit dhe kufiri vazhdon sipas hartës rajonale.

Kufiri ndarës i Lajthizës me Vlashaj – Lurë për shkak të konflikteve ndërmjet barinjve në vitin 1957 është rivendosur nga autoritetet e pushtetit vendor të të dy rretheve Dibër e Mirditë dhe është lënë në kufijtë e vjetër sipas hartës etno-kulturore, Prroi i Lajthizës, Koldoçaj, Gjurra e Bucit, Hurdha e Tushës, Guri i Kuq dhe ndjek hartën gjurmëlënëse të kuotuara që takon përsëri tek Shpella e Korbit dhe Gjurma e Shenjtit (Fushë Lugje) e në vazhdim Shkalla e Fanit, Maja e Ballnajve, Kamkeqe e zbret tek Kodra e Shullanit (Koskonell), ndjek përroin e takon tek mulliri i Dodajve, këtu bashkohet me përroin e Zepës dhe formon përroin e Lajthizës, i cili ndjek shtratin e tij dhe bashkohet me përroin e Drobajve, që vjen nga kufiri veriperëndimor i Drobajve, sipas hartës topografike dhe të dy përrenjtë së bashku derdhen në lumin Malla, që zbret nga Lura.

Dibra përtej një fotografie

(Vijon nga faqja 7)

një fond për rrugën, por në proceset e tenderimit humbën paratë dhe nuk u bë. Po ashtu, një fondacion holandez që vepron në Peshkopi, vite më parë kishte premtuar ndërtimin e rrugës, por me kushtin e ndërtimit të disa shtëpive malore mbi fshat. Banorët rrugën e donin, por kishin kundërshtuar: "Na vijnë të huajt dhe na prishin racën!". Çudi! Lopët holandeze na e rregullonin racën e bagëtive dikur, por njerëzit na e prishkan...!

Dikush, një grua, një vit më parë, kishte parë një kuçedër! Një banor i fshatit nuk e kishte parë vetë, por ai tregonte me plot besim se gruaje kishte takuar në rrugë. Por folë nuk kishin. Dikur kuçedrat pengonin burimin ujit, sot s'të lënë të bësh rrugën!


Fshati Rabdisht

SNV DHE DIBRA

SNV është një organizatë ndërkombëtare me qendër në Holandë. Ajo ka shtrirje në mbi 36 vende të varfra botës. Prej vitit 1996 vepron edhe në Dibër.

Organizata beson se askush nuk duhet të duhet të jetojë në varfëri dhe që të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësinë për të ndjekur zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Kështu beson edhe ekipi shqiptar i SNV.

Organizata shpërndan ekspertizën e saj në fushën e bujqësisë, ujit dhe higjienës si dhe ndihmon autoritetet lokale në përgatitjen e strategjive të zhvillimit. Pushteti lokal, krye-sisht, komunat kanë përfituar nga asistenca e kësaj organizate.

Dali Horeshka punon prej vitesh me SNV. Tani është koordinator i SNV/Promalit në Dibër. Ai thotë se organizata ku ai punon, deri më tani ka ndihmuar në ndërtimin e modelit të bimëve mjekësore, kryesisht sherebelës në Çidhën e Reç. Gjithashtu, i është dhënë një mbështetje e fuqishme zhvillimit të pemëtarisë dhe ndërtimit të një frigoriferi me standarde moderne.

Sipas tij, po punohet që brenda këtij viti të testohet efektiviteti i spërkatjes në pemëtari me pompa motorike, si dhe fuqizimi i biznesit të përpunimit të qumështit me një frigorifer ftohës dhe kaldajë. Gjithashtu, SNV/Promali Dibër po mendon krijimin dhe forcimin e një Grupi të Veprimit Lokal, i cili, sipas kritereve të BE-së, të jetë i aftë të mbështesë zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet fondeve të BE-së.

Horeshka është një ekonomist bujqesie me përvojë. Ai thotë se karakteristikë e prodhimit bujqësor këtë vit ka qenë rritja e prodhimit të qershisë, por ka pasur një rënie te prodhimi i mollës, dardhës dhe kumbullës, si rezultat i prekjes nga sëmundjet. Ai shtron urgjente pajisjen e Drejtorisë së Bujqësisë me laborator e specialistë të analizës së tokave, sëmundjeve e dëmtuesve, duke bërë të mundur parandalimin dhe luftimin efikas të sëmundjeve në bujqësi.

Gjithashtu, vihet re një rritje e numrit të fermave me të imta dhe të trasha me rreth 100 të tilla në rajon, me më shumë se 100 krerë secila. Kjo ka çuar në rritjen e qendrave sezonale të përpunimit të qumështit me 5 të tilla.

Një zhvillim i ri në bujqësinë e rrethit është kultivimi i bimëve mjekësore si sherebelë, tërfil i kuq dhe shpatore (zambak) me rreth 26 hektarë. Sherebelën e kanë mbjellë 21 fermerë, 18 në Çidhën e 3 në Reç. Fermerët në dorën e parë kanë marrë rreth 70 kg/dynym dhe mendojnë se sezonin e këtij viti e mbyllin me 1.5 kv/dynymi. Kjo do të thotë se në vitet e tjera ata do të marrin jo më pak se 5kv/dynymi. Fermerët janë mjaft të kënaqur dhe po mendojnë të gjejnë mënyra për ta shtuar sipërfaqen. Ne mund e duhet të kemi 1000 ha të mbjella me bimë mjekësore që kanë një treg të sigurt dhe të ardhura të mira.

Ndërsa përsa i përket grurit dhe misrit, Horeshka thotë se ka rënë prodhimi për hektarë, si rezultat i thatësirës dhe mospërdorimit të ujitjes.

FACEBOOK DHE DIBRA

Fotot nga Dibra zbukurojnë faqet personale në FB dhe internet. Shumë faqe online promovojnë Dibrën dhe bukuritë e saj. Dhjetëra foto tregojnë magjinë e natyrës: malet, fushat, bjeshkët, lumenjtë, ujëvarat, tokat e mbjella, fshatrat e gjelbëruara. I shikon dhe krenohesh. Ndjen nostalgji dhe mall. Japim Like me plot dëshire e shkruajmë komentet më të bukura.

Por të gjithë harrojmë se pas një fotografie te bukur qëndron dora, kujdesi, mundi e djersa e banorëve që jetojnë në Dibër. Jeta që fshihet pas një fotografie është e vështirë. Është e vuajtur. Shpesh e uritur. Me plot sakrifica. Por me ëndrra dhe shpresë!

100 Vjet Pavarësi

Përkujtohet 92 vjetori i Qeverisë së Arrasit

Komuna e Arrasit dhe Shoqata e Historianëve të Dibrës kujtojnë kryengritjen e madhe të armatosur të popullit dibranë kundër hordhive serbe të vitit 1920

Reportazh nga **SHAQIR SKARRA**





Në foto: Moment nga zbulimi i pllakës përkujtimore që shënon vendin ku u themelua Qeveria e Arrasit

Arrita herët në Arras. Udhëtimi në mëngjes është më i lehtë në këto ditë të nxehta korriku e ndaj u nisa shpejt nga Tirana. Sa herë që udhëtoj drejt vendlindjes gjithmonë më kaplon një ndjenjë e fuqishme malli, bëhem nostalgjik për ato vite të bukura që kam kaluar. Më kujtohet me mall e dashuri çdo gjë e mirë dhe e bukur që kam përjetuar. Nostalgjik për një vijë uji apo një brazdë are të sapo prashitur me misër, për një burim me ujë akull të ftohtë apo plantacionet e shumta me drurë frutorë, për një rrugë fshati të pastër e shtruar me kalldrëm apo për mejat e gardhet e fshatarëve, për dardhat ende të papjekura që merrnim gjithë kryeneçësi nga kopshtet e të tjerëve apo dhe lojën e bukur me rrasa guri, për shkollën e fshatit ku era dhe vitet e kaluara kanë bërë të mundur që muri me plisa të jetë i gërryer shumë apo për ato kujtime që mblidhen sot pas kaq vitesh sikur të jenë mbajtur me kujdes në fletë të zverdhura blloku . E kjo ndjenjë malli dhe nostalgji për vendlindjen të gjithë i ka pushtuar nga pak. Makina ecën me vështirësi nëpër rrugën e pa shtruar por nuk më pengon asgjë të hedh vështrimin që nga xhami i hapur i makinës. Shikoj me çudi se asnjë copë tokë nuk ka mbetur pa punuar. Diku misër e diku jonxhë, diku plantacione me mollë e kumbull e diku kopshte të mbushura plot për plot me perimet e stinës. Sa bukur! Një pamje vërtet mahnitëse syri të kap në të dyja anët e Drinit të Zi. Dibranët nuk e kanë humbur përvojën e fermerit. I janë kthyer tamam si vite ma parë kësaj përvoje të bukur. Ajo që na bëri përshtypje më shumë ishte se e gjithë lugina e Drinit të Zi, që nga ura e Muhurrit e deri tek ura e Zalldardhës, sivjet ishte "pushtuar" nga turistë vendas dhe të huaj, të cilët edhe kishim marrë shtëpi me qira, por shumica kishte ngritur dhe çadra buzë Drinit.

Kishte filluar një ringjallje në këtë luginë të bukur. Ishin pikërisht turistët që po i jepnin jetë. Vetëm pak punë duhet, pak investime dhe turizmi në këto zona do jetë mjaft fitimprurës dhe i dobishëm. I vetmi shqetësim si për komunat, për banorët e këtyre zonave dhe vetë turistët mbetet infrastruktura pasi rruga automobilistike nga Muhurri për në Zalldardhë e që bashkon dhe shumë fshatra të tjerë të luginës së Drinit të Zi, është po ajo e quajtur si "Rruga e Dritës' e ndërtuar qysh në vitin 1946. E sot këtë rrugë e paskan braktisur edhe punonjësit e ndërmarrjes së mirëmbajtjes që kudo përgjatë kësaj traseje tej të amortizuar sytë nuk na zunë qoftë dhe një punëtor të vetëm me lopatë në dorë. Megjithatë në rrugë kishte mjaft lëvizje. Ishte ditë e enjte e si ditë dasmash domosdo autokolona me makina të stolisura me lule të shumta lëviznin lirshëm. Nuk donin të ia dinin fare për gropat e shumta në rrugë por boritë e makinave , tingujt e daulleve , këngë të ndryshme popullore kishin mbushur teje e tej këtë trase rruge të amortizuar plotësisht. Stinë dasmash ky muaj, por Arrasi përveç se dasmave të shumta kishte dhe një dasmë më të madhe, kishte një dasmë që i kishte kaluar kufijtë e fshatit. Festonte 92 vjetorin e qeverisë së Arrasit. Festonte kryengritjen e madhe të armatosur të popullit dibranë kundër hordhive serbe të vitit 1920.

ARRASI NË FESTË

Sapo ngjitemi në Çuke të Arrasit pamë se këtu festa kishte nisur ditë më parë. Njerëz të shumtë ishin mbledhur dhe vetëm prisnin orën 11, orë kjo ku do të fillonte aktiviteti që komuna Arras në bashkëpunim me shoqatën e historianëve të Dibrës si dhe shoqatën kulturore "Çidhna e Kastriotët" do kujtonin 92 vjetorin e qeverisë së Arrasit. Kishin zbritur nga Çidhna e Muhurri, Sinja e Lura, Reçi e Dardha, Uje e M'uja e Kastrioti. Të gjithë bashkë ashtu si 92 vjet ma parë. Shtëpia e Lushës kishte hapur dyert për të pritur mysafirët e rrallë. Mungonin vetëm ato figura të mëdha patriotike që me mendjen e gjakun e tyre bënë të mundur që jo vetëm Arrasin por gjithë Dibrën dhe më gjerë ta futnin në histori.

Mungonte Elez Isufi e Sufë Xhelili, Ramiz Daci e Ramiz Dibra, Dine Hoxha e Riza Lusha. Këto e të tjerë si këto mungonin, por ne brezat e më vonshëm për këtë ishim mbledhur. Me i kujtuar ato trima që nuk kursyen as gjakun dhe jetën e tyre për lirinë e pavarsinë e vendit. Po, fshati Arras njihet herët në historinë kombëtare, njihet që në kohën e trimit dibranë Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Këtu pëllëmbë e tokë është një histori më vete. Ja ura e Lushës poshtë nesh që bashkon brigjet e Drinit të Zi. Ishte Demir Lusha ai që paret që mori tek veziri i Shkodrës apo Ali Pashë Tepelena këtu nën këmbët e kësaj ure i futi dhe jo në trasta që mbante me vete. I futi këtu për ti qëndruar të gjitha kohërave emri i tij. Sa e sa njerëz kalojnë ende sot mbi këtë urë e të gjithë urojnë fisnikun Demir Lusha, i cili bëri që dhe vetë veziri i Shkodrës të ngrihej në këmbë e ta respektonte siç respektoheshin figurat e njohura në qarqe diplomatike e administrative.

"Vezir i Naltë ty tu shtoftë ndera!
Për vete s'due besa një grosh!
Jam derë sojlie, e ma don sëra
Ta ruaj nderin me xhepat bosh.
Po ti në don emri të mbetet
Vepër që s'shuhet në histori;
Na ndih me pare, Ta ngremë një urë,
ku mbidhet, tkurret "Lumi i Zi"!
Asht lumë i prapë, mbytet njerzia;
Dimër e verë N'të duhet dalë!
Unë të jap fjalën, Deri sa t'bahet,
Me paren tande, Ti rrij në kambë!"

PËLLËMBË E HISTORI

Të parin që takuam ishte intelektuali i Çidhnës Mustafa Tola, i cili jo vetëm si njeri i dhënë shumë pas historisë, por dhe si një intelektual i kompletuar nis e na tregon më shumë jo vetëm rreth kësaj ngjarje historike që në në fakt edhe nuk dinim shumë por dhe në përgjithësi për gjithë Çidhnën me betejat dhe luftrat e bëra në vite

-Ja këtu pikërisht në këtë shtëpi që sot është njëkatëshe por në ato vite ishte një kullë e madhe tre katëshe, u mblodh qeveria e Arrasit. Dhe kjo qeveri u mblodh fill pas kongresit të Lushnjës ku qeveria e Sulejman Delvinës vendosi një zëri që të ngrinte dhe prefekturën e Drinit. U zgjodh Arrasi se serbi ishte ulur këmbëkryq në Dri, se ishte pikë strategjike për të goditur, se kulla e Lushës ishte sofër bujare dhe i kishte mundësitë ekonomike për të mbajtur një administratë me 40 e 50 veta për më shumë se një muaj. Por krahas Riza Lushës u bashkuan dhe mjaft të tjerë fshatarë fisnik që mbështetën fuqishëm këtë Qeveri të sapo formuar dhe e ndihmuan me aq sa mundën. Më poshtë Ferra e Pashës. Një toponim i çuditshëm por ja që na vjen si nëpërmjet legjendës nga largësia e viteve. Mustafai këtë toponim na e lidh me betejën e madhe të Torviollit ku ushtria turke la shumë viktima këtu e pashai turk nga kjo ferrë i strukur u largua me turp. Këtu mblidheshin malet e Dibrës për probleme madhore të vendit:

"Do mblidhemi trima
tek Ferrë e pashës"
"Mbi urë të Lushës
dalim he, burrë!"

Ja dhe Kodra e pareve, toponim ky që gojëdhënat e lidhin me thesarin e Skënderbeut, Guri i hajatit që thonë se vetë Skënderbeu mbante kalin këtu, Gurët e kazaneve etj. Çdo toponim ka një legjendë, ka një gojëdhënë por që çidhnakët shumicën e lidhin me heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ja dhe Kulla e Lushës që sot e kemi kthyer në muze e cila do tju flas gjithmonë brezave për ato ditë të zjarrta ku pushka kërciste brigjeve të Drinit e serbit i dridhej toka nën këmbë. Pikërisht nga kjo kullë krisi dhe pushka e parë nga Riza Lusha atë mëngjes gushti të vitit 1920. Çidhna vërtet ka histori, këtu çdo pëllëmbë tokë është larë me gjak, çdo pëllëmbë tokë ka një ka një ngjarje, çdo toponim ka një histori. Mjafton të kujtojmë masakrën e përgjakshme të Çidhnës në vitin 1466 ku turku masakroi mbi tetë mijë çidhnak. E megjithatë çidhnakët kurrë nuk e ulën kokën karshi të huajt që guxoi të shkelë këto troje.

(Vijon në faqen 13)

Rruga e Arbërit nr. 75

kujtesë

71 vjet më parë: Revolta kundër çarmatosjes së burrave të Reçit

Nderim të historisë atdhetare të Reçit e Dardhës



Nga: **XHELAL MARKU**

Ishte një ditë e freskët pranvere e mesmajit ajo, kur ne, një grup shokësh nga Tirana, ish banorë të zonave të Reçit e të Dardhës, nisëm udhëtimin tonë drejt Kodrës së Kacës të Dibrës, ku 71 vjet më parë, 700 burra të krahinës, shkruan historinë e tyre të qëndresës atdhetare përballë pushtuesit dhe shërbëtorëve të tij, që kërkonin çarmatosjen e popullsisë, për të sunduar lehtësisht zonën. Ishte një ngjarje, që duhej respektuar për vlerat e saj në krahinë, ndaj udhëtimi ynë kësaj here kishte motiv atdhetar. Duhet thënë, se shkak për këtë udhëtim tonin, u bë biri i Kullës së Canit në Dardhë, Mal Cani, kryetar i Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar "Nënë Tereza", i cili në bashkëpunim dhe me familjet pjesëmarrëse në ngjarjen historike të Kodrës së Kacës, organizuan për herë të parë festimin dhe përkujtimin e kësaj dite të shënuar në historinë e qëndresës atdhetare të kësaj zone.. Në anë të rrugës në Kolesjan, ngrihet lapidari në përkujtim të qëndresës heroike të krahinave të Reçit, të Dardhës e të Lumës, në vitin 1912, të cilat u bashkuan dhe i thanë hasmit serb: "... Ndal! Ka zot ky vend. Këtej, nuk kalon dot, pa shkelur mbi trupat tanë...". Një histori kjo, e larë me gjakun e 12 mijë serbëve, që mbetën istikameve përgjat luginës së Drinit të Zi. Ndaj, përulemi me respekt pranë lapidarit, që përjetëson këtë ngjarje të madhe historike të Krahinës e të mbarë Kombit tonë. Rreth e qark përgjat gjithë luginës, syri të rrok një peisazh të pasosur gjelbërimi, mes për mes të cilit kalon me qëtësinë e tij Drini i Zi. Ndërsa më tej, malet e të dy shpatave, ngjajnë sikur janë ulur këmbëkryq përballë njëri-tjetrit, dhe po "shikohen" sy më sy. Ato ngjajnë sikur kuvendojnë dhe sikur ja kanë shtruar një muhabeti vençe, ashtu si dikur burrat në odat e miqëve, apo në Kuvendet e Krahinës.

Tashmë, është mbrëmje dhe qendra e komunës, Zalldardha ka rënë në qetësinë e saj të zakonshme. Aty po na pret me bujarinë e tij, një përfaqësues i familjes Kaca, Hakiku, një mesoburrë, i respektuar dhe shumë mikpritës. Ne, sonte do të jemi mysafirët e tij, ndaj sipas traditës, ai ka dalë për të na pritur qysh në Zalldardhë, katër-pesë kilometra larg shtëpisë së tij

TE KODRA E KACËS

Me gjithëse kanë kaluar 71 vjet, nga dita kur këtu në Kodër të Kacës, 700 burra të Reçit, Dardhës e të Çidhnës, u mblodhën për t`i thënë Jo çarmatimit, ende në kujtesën e brezave ruhen të freskëta ato momente, kur nga një thirrje, mori kushtrim turma dhe pushtuesi u përzu me turp nga ky vend. Kujtojmë se nuk ishte e lehtë ta bëje një veprim të tillë, kur përballë turmës ishin rrjeshtuar mbi 300 zaptie dhe 8 mitraloza me në krye bashkëpunëtorin e egër të pushtuesit, Xhafer Bali. Apeli i thërriste një nga një pjesëmarrësit, i torturonte dhe më pas u kërkonte dorëzimin e armëve. Por, të dorëzoje armët pushtuesit, ishte një ngjarje tepër tronditëse për malësorët, të cilët ndër shekuj nuk e hoqën armën nga supi, sepse kështu i kishte mësuar historia, që vetëm nëpërmjet saj, ta shikonin sigurinë e Trojeve, të lirisë, të gjuhës, të kulturës e të traditave të tyre. Tradita e lidhjes së malësorëve me armën, si një mjet i rëndësishëm për të mbrojtur vatanin, lirinë dhe të drejtat e tyre, është aq e lashtë, sa dhe vetë historia që ata kanë, sepse tek arma kanë parë gjithnjë të ardhmen e Kombit e të shqiptarisë. Por, po kaq i lashtë, është edhe Bashkimi i shqiptarëve pa dallim feje, krahine e ideje, për t`u dalë zot trojeve shqiptare. Historikisht filozofia e tyre ka qënë e orientuar drejt, sipas parimit: "Të bashkuar në diversitet", që është mjaft aktuale e demokratike edhe për ditët e sotme. Sinteza e kësaj filozofie, shprehet qartë edhe në vargjet e këngës kushtuar ngjarjes historike të Kodrës së Kacës, të vitit 1941.

Janë këto arsye, që lajmi për çarmatimin, ngjalli një zemërim të madh tek të gjithë banorët e zonës. Ai, ra si një bombë tek malsorët e Reçit e të Dardhës, që i thirrën shtëpi për shtëpi. Rrallë herë kishte ndodhur, që të grumbulloheshin kaq shumë burra në një vend. Revolta ziente nga brenda shpirtit tek secili. Ishte një heshtje e trazuar, e cila priste momentin për të shpërthyer ndaj pushtuesit. Dhe sakaq, ndëgjohet thirrja e turmës:

Ishte një thirrje jehonë, që ngriti peshë zemrat e kuvendit të burrave, për të mos iu nënshtruar armikut, që kërkonte çarmatimin për të sunduar. Por jo! Jo – i thanë të gjithë në një zë dhe burrat u çuan në këmbë. Dhe në këtë betejë, ku armiku u përzu me turp, spikatën me trimërinë dhe atdhetarinë e tyre, Mahmut Laçi e Rrahman Rasha, Mehdi Kaca e Selman Marku, Ramadan Cani e Selman Ahmeti, Muharrem Hoxha e Bajram Cani, Selim Lila, dhe shumë emra të tjerë, që dhanë kushtrimin në këtë ngjarje historike të revoltës kundër çarmatimit. Vepra e tyre është dhe do të mbetet një burim i madh frymëzimi atdhetar për të gjithë brezat, për sot dhe për të ardhmen e krahinës së Reçit e të Dardhës, që tashmë përjetësohen edhe me një lapidar të ri e bashkëkohor, këtu në vendin historik të Kodrës së Kacës të Dibrës.

CEREMONIA E PËRKUJTIMIT

Për të përkujtuar ngjarjen historike të qëndresës atdhetare të Reçit, Dardhës e Çidhnës të vitit 1941, kundër çarmatosjes së popullsisë nga pushtuesi, në Kodër të Kacës kishin ardhur veç banorëve të këtyre krahinave edhe të ftuar nga Tirana e Durrësi, nga zona e Kalisit të Kukësit e Sllova e Dibrës, që ndodhen përballë, matanë Drinit, përfaqësues të shoqatave joqeveritare, etj. Tek po afronte ora 10 e paradites, pjesëmarrësit të organizuar në grupe vinin dhe grumbulloheshin në oborrin e shtëpisë së Ahmet Kacës, vend ku 71 vjet më parë u mblodhën 700 burra të këtyre anëve, për t`i thënë Jo çarmatimit të popullsisë së zonës. Ata vinë rradhë - rradhë dhe ulen në këtë mjedis historik, ku revolta e tyre shënoi një nga ngjarjet më të rëndësishme për historinë atdhetare të këtij vendi. Takohen e pyeten me njeri – tjetrin dhe kujtojnë ato kohë të ndritura të historisë së tyre. Ahmet Kaca, trashëgimtari i Mehdi Kacës, ish pjesëmarrës në atë revoltë të madhe, pret e përcjell si në dasëm. Është një festë e bukur, që përkujtohet për herë të parë në këtë vend. Lapidari i ri i sapopërfunduar shkëlqen me bardhësinë e tij në hyrje të lagjes, duke i dhënë një tjetër ngjyrim, prezencë e vlerësim kësaj ngjarje të njohur në historinë e krahinës. Pasi pihet një kafe në bahçen e Ahmetit, pjesëmarrësit i drejtohen vendit, ku ngrihet lapidari. Ndërkohë të tjerë njerëz vazhdojnë të vinë. Pranë lapidarit është instaluar edhe një foni e sjellë nga Tirana, e cila me programin e saj e ka rritur atmosferën festive të kësaj veprimtarie. Hysen Mziu me një grup njerëzish nga Kraj-Reçi, sapo ka mbërritur në Kodër të Kacës. Ndërkaq, një grup të rinjsh, pranë lapidarit ja kanë marrë edhe një valleje me shumë ritëm. Kurrë ndonjherë ky vend, nuk ka pasur kaq gjallëri sa sot. Dhe ja tek vjen momenti i çeljes së mitingut kushtuar ngjarjes historike të Kodrës së Kacës. I pari e merr fjalën i zoti i shtëpisë, Ahmet Kaca. "Mirëse keni ardhur, thotë ai. Është kënaqësi për mua që të hap këtë cermoni, që zhvillohet sot, në nderim të ngjarjes historike të Kodrës së Kacës. Ajo ditë dhe ata 700 burra trima, i dhanë një emër të madh kësaj kodre të vogël, që tashmë ka hyrë në historinë e këtij vendi me tradita të lashta atdhetare. Respekt dhe mirënjohje të thellë për ta dhe për veprën e tyre"! Më pas e kanë marrë fjalën për të përshëndetur në këtë ceremoni edhe kryetari i Shoqatës Kombëtare të Pensionistëve të Shqipërisë, Osman Terziu, si dhe kryetari i Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar "Nënë Tereza", zoti Mal Cani. Kanë përshëndetur gjithashtu edhe veterani Shaqir Nimani, Hysen Mziu nga Reçi, Hamit Cani e Mexhit Kaca nga Dardha, etj. Më pas, këngëtarët: Zef Doçi e Ruzhdi Dervishi, kanë përshëndetur këtë tubim me këngët kushtuar ngjarjes së Kodrës së Kacës, si dhe me këngën kushtuar burrit trim e bujar të kullës së Canit, Ramadan Cani .Largohemi nga Kodra e Kacës, të mbushur me plot emocione e mbresa nga festa. Kjo kodër e vogël në dukje, ka shkruar një histori të madhe e të rëndësishme atdhetare për krahinën e Reçit, Dardhës e të Çidhnës, ka shkruar një ngjarje që do t`ju flas në shekuj brezave, duke përcjellë mesazhin e madh të besës e të bashkimit për çeshtjen kombëtare dhe fatet e vendit.



Me gjithëse kanë kaluar 71 vjet, nga dita kur këtu në Kodër të Kacës, 700 burra të Reçit, Dardhës e të Çidhnës, u mblodhën për t`i thënë Jo çarmatimit, ende në kujtesën e brezave ruhen të freskëta ato momente, kur nga një thirrje, mori kushtrim turma dhe pushtuesi u përzu me turp nga ky vend. Kujtojmë se nuk ishte e lehtë ta bëje një veprim të tillë, kur përballë turmës ishin rrjeshtuar mbi 300 zaptie dhe 8 mitraloza me në krye bashkëpunëtorin e egër të pushtuesit, Xhafer Bali.

portret

Dom Nikoll Kaçorri, arkitekti dhe shenjtori i pavarësisë

Nga: **NIKOLL KOLA**, Avokat

Vepra e Dom Nikoll Kaçorrit është e pavdekshme dhe do të rrezatojë përherë e më shumë si një "yll" i pashuar ku do të frymëzojë breznitë e tanishme dhe të ardhme për ruajtjen e lirisë dhe pavarësisë së Atdheut tonë të dashur të cilat Dom Nikoll Kaçorri i deshi aq shumë derisa u kushtoi edhe jetën

Autori i librit zoti Nikollë Loka më kërkoi që edhe unë të kontribuoj diçka për figurën e Dom Nikoll Kaçorrit dhe të pemës gjenealogjike për ndonjë nga degët që nuk shënohet në skemën përkatëse. Këtë në kuadrin e 100-vjetorit të Pavarësisë të 1912-ës dhe të formimit të shtetit të parë shqiptar, që me sigurimin dhe sakrificat supreme dhe të shumanshme të pavarësisë së Shqipërisë pas Ismail Qemalit, ishte Dom Nikoll Kaçorri, i pari flamurmbajtës që këtë flamur e siguroi në gjoks dhe po nga ky gjoks prej burrit të shtetit në tribunën e pavarësisë në Vlorë pas fjalës së Ismail Qemalit e nxorri flamurin dhe ia valëviti në dorë Ismail Qemalit duke i bërë edhe thirrjen këtij të fundit "në qoftë me dek më mirë sot se sa nesër". Ismail Qemali iu përgjigj "sot, sot" dhe menjëherë ngritën flamurin e pavarësisë.

Dom Nikoll Kaçorri luftoi me veledonin e tij, me penën e artë dhe me pushkë në dorë për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Për një kontribut të madh historik që i bëri shpalljes së pavarësisë dhe formimit të shtetit të parë shqiptar Dom Nikoll Kaçorri u zgjodh me vota unanime të të gjithë delegatëve, nënkryetar i parë i qeverisë së Vlorës dhe kryetar i katolicizmit shqiptar.

Duke përkujtuar veprën e pavdekshme të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë të vitit 1912 "kujtojmë Pukëvilin, Hahnin, Mis Durhamin, Bajronin, Nopçën, Baldacin, Zef Valentinin e sa të tjerë austriakë, gjermanë, francezë, italianë, anglezë etj, arkeologë, gjuhëtarë, historianë, diplomatë, etnografë, paleografë, gjeologë, shkrimtarë e piktorë. Të gjithë pa përjashtim kanë arritë në përfundimin që shqiptarët i përkasin asaj race të konsideruar e humbur, racës së pellazgëve, të motit, siç thotë Fishta me të cilët i lidh gjuha, monumenti i gjallë i identitetit të shqiptarëve si popull më i vjetër në viset ku jetojnë akoma në shumicën e viseve të tjera evropiane qysh nga zanafilla e qytetërimit njerëzor në këtë kontinent".

Për sa më sipër, pra shqiptarët kurrë nuk u asimiluan, nuk e humbën gjuhën, nuk pushuan për të fituar dije, shkencë, kulturë, identitet, liri e pavarësi. Të gjitha këto i konsolidoj vepra e pavarësisë së Shqipërisë e vitit 1912 që u realizua dhe u kompozua nga burrat e shtetit Ismail Qemali dhe Nikoll Kaçorri.

GOJËDHËNA DHE REFERENCA

Të dyja këto faktorë studiues janë në unitet si dhe në lidhje dialektike me njeratjetrën, ndihmojnë dhe nuk përjashtojnë kurrë njeri-tjetrin në qoftë se ato janë objektive dhe kompozojnë të vërtetën.

Sipas gojëdhënave të cilat transmetohen nga brezi në brez dhe po të kalojnë të paktën mbi tre breza ato marrin karakterin e referencës, për faktin se ato kompozohen nga autorë të ndryshëm në libra, gazeta, revista e të tjera.

Bazuar sa më sipër fisi Kaçorri i Lurës e ka origjinën e hershme nga rrethinat e Ohrit, atje kanë jetuar para viteve 1700.

SI LINDI OSE U IDENTIFIKUA KAÇORRI?

Thuhet se në një betejë kundër pushtuesve të kohës një nga pinjollët e kësaj familjeje me emër Kaçerri luftoi si vigan, u shqua në betejë por fatkeqësisht ai humbi njërin sy. Pas këtij momenti dhe pas mjekimit përsëri ai mbeti qorr me një sy. Në këto rrethana pyetja e banorëve dhe e bashkëfshatarëve rreth e qark ishte ka është qorri? (Kaçerri - qorri) . Duke u bërë bashkimi i këtyre dy fjalëve u bë një mbiemër i përbërë Ka.....qorri. Përfundimisht në këto rrethana u formësua mbiemri Kaçorri), mbiemër të cilin e kanë trashëguar brez pas brezi fisi Kaçorri.

KUR ERDHËN FISI I KAÇORRËVE NË LURË?

Rezulton se fisi Kaçorri migroi nga Ohri, erdhën prej andej dhe u vendosën në Lurë të Vjetër, në trojet që ata i blenë e që i ka administruar një pinjoll i këtij fisi, të parët dhe Ahmet Kaçorri. Sot këtë vatan e trashëgojnë djemtë e Ahmet Kaçorrit, Bardhyl e Naim Kaçorri.

Në këto troje Kaçorri si familje e madhe e përbërë nga katolikë dhe myslimanë së bashku jetuan për më shumë se gjysmë shekulli së bashku në harmoni të plotë ndërmjet tyre.

Në këto kushte Kaçorrët u shtuan shumë dhe lindi nevoja e lëvizjes për të kërkuar zgjerim dhe troje të tjera për të përballuar jetën dhe për ta zhvilluar atë.

Rreth vitit 1800 trungu familjar i Kaçorrëve u nda në shumë familje. Në trojet e vjetra në Lurë të vjetër mbeti dega e trungut familjar të Ahmet Kaçorrit. Kurse pjesa tjetër, një familje katolike dhe një myslimane erdhën në Krej – Lurë (blenë troje të reja në një pllajë të madhe që quhet Fangu i Kaçorrit ku pjesërisht edhe sot banojnë disa familje). Në këto troje ka lindur edhe Dom Nikoll Kaçorri.

Sipas akteve të gjendjes civile të kohës rezulton se Nikoll kaçorri ka patur për baba Vokërr Kaçorrin dhe për nënë Hana Vladi (Kaçorri). Njëkohësisht ka patur edhe një vëlla Ndrec Vokërr Kaçorrin. Ky i fundit ka patur një djalë Gjokën dhe dy vajza: Prena Ndrec Kaçorri e datëlindjes 1897 e martuar në Kumbull të Selitës (Mirditë) tek familja Përkeçi, e cila ka vdekur në 1932. Ka lënë një djalë Preng Ndue Përkeçin.

Vajza tjetër Margjela Ndrec Kaçorri (Kola) e datëlindjes 06.06.1900 e martuar me Gjok Ndue Kolën në Lajthizë e cila ka lënë dy djem dhe një vajzë. Zef Gjok Kola (Gjergj Gjok Kola, ky ka vdekur) dhe Marie Gjok Kola që jeton. Margjela ka vdekur në vitin 1967. Për Gjokën e parë nuk ka të dhëna si për datëlindjen ashtu edhe për vdekjen.

KUSH KA QENË BABAI I VOKËRR KAÇORRIT?

Sipas gojëdhënës së gruas së xhaxhait tim, Margjela Ndrec Kaçorri (Kola) që sipërcitova në kohën kur lindi djali i djalit (Kol Zef Kola) më 02.04.1953, Margjela iu tha të gjithë familjes: Mos më zini emër në gojë për djalin, se me emër do ta pagëzoj vetë, për faktin se gjyshin tim e kanë quajtur Kol" (pra Ndrec Vokërr Kola – Kaçorri) që është gjyshi i Margjelës. Këtë fakt ajo e provoi me gojën e saj se emrin Kol e ka pasur gjyshi i saj. Edhe Dom Nikoll Kaçorri e ka pasur emrin e vërtetë Kol, por kur e kanë çuar në shkollë për prift e kanë pagëzuar me emrin Nikoll. Edhe një tjetër Kol është (Kol Gjin Kaçorri) mësues, babai i Tom Kaçorrit. Me emrin Kol është pagëzuar edhe djali i Gjok Kaçorrit të Ri që Margjela e ka pasur kushëri të parë. Pra, vetëm në trungun familjar Kaçorri është trashëguar katër herë emri Kolë.

Për rrjedhim Margjela provon faktin se babai i Vokrrit e ka pasur emrin Kolë dhe po me këtë emër ajo pagëzoi djalin e djalit Kol Zef Kola, emër i cili u trashëgua për herë të pestë.

Për sa më sipër provohet botërisht se babai i Vokërr Kaçorrit ka qenë Kolë Kaçorri.

VENDLINDJA E DOM NIKOLL KAÇORRIT

Ai u lind në fshatin Krej të Lurës më 1865 dhe u shkollua nga françeskanët. Dom Nikoll Kaçorri arrin të ketë një karrierë të pasur në historinë e kishës e pasi mbaroi studimet për teologji dhe shërben në disa famulli emërohet ipeshkv në Durrës dhe merr dy medalje nga Papa. Në vitin 1909 është ndër arkitektët kryesorë të rilindjes për pavarësinë e vendit. Mori pjesë në kryengritjet kundër turqve në veri dhe në jug të vendit. Anëtar i Kongresit të Manastirit, firmëtar i dytë i pavarësisë dhe zëvendëskryeministër i qeverisë së shtetit të parë shqiptar.

Dom Nikoll Kaçorri është një prej burrave më të shquar të rilindjes së kombit shqiptar.

Kryeministri Sali Berisha në fjalën e tij me rastin e ceremonisë së rivarrimit të eshtrave të Dom Nikoll Kaçorrit në Katedralen Shën Luçia në Durrës, ndërmjet të tjerave theksoi:

"Dom Nikoll Kaçorri është dhe do të mbetet shenjëtori i pavarësisë së kombit shqiptar...".

Ndërsa Kryetarja e Parlamentit Shqiptar znj. Jozefina Topalli në këtë ceremoni theksoi se:

"Dom Nikoll kaçorri ka qenë një ndër arkitektët më të mëdhenj të çështjes sonë kombëtare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë. Ai ka qenë dhe mbetet një nga baballarët e kombit".

Vendlindja e Dom Nikoll Kaçorrit Krej-Lurë (Fangu i Kaçorrit) i cili qëndron si "kala" 70 - 80 m lartësi, mbi këtë fshat, me bukuri të rralla të qëndisura nga natyra. Banesa e kulla të reja janë ndërtuar nga trashëgimtarët e tij. Në këto banesa lindën dhe u rritën, u burrëruan edhe pasardhësit e Nikoll Kaçorrit të cilët ruajtën traditat e patriotizmit, trimërisë, bujarisë, besën e miqësinë u bënë njerëz me shkollë e kulturë, të mençur e largpamës për të ruajtur traditën e këtij oxhaku të nderuar e bekuar ku lindi dhe u rrit Nikoll Kaçorri. Në këto kulla u shtruan gjithnjë sofra bujare për të varfërit e të pasurit, për burrat e dheut, për burrat e mençur, për kuvende e pleqësi të ndryshme. Kudo që thirrje e trokiste në çdo derë të Kaçorrëve dëgjohej përgjigja "hajde bujrum", "mirë se u pru Zoti". Janë njohur si burra më në zë, në këtë trung familjar Gjin Llesh Kaçorri, Dod Llesh Kaçorri, Nikoll Ded Kaçorri, Gjok Kaçorri, Preng Kaçorri, Dem Kaçorri, Hasan Kaçorri e të tjerë.



Fasksimile e dekorimit të Dom Nikollë Kaçorrit (Pas vdekjes)

Për sa parashkrova më sipër për origjinën dhe oxhakun e Kaçorrit kam edhe detyrim njerëzor, miqësor dhe moral, për faktin se familja ime ka lidhje miqësore dhe të gjithanshme me Familjen Kaçorri. Kështu gruaja e xhaxhait tim Margjela, është vajza e Ndrec Kaçorrit, pra mbesa e Dom Nikoll Kaçorrit. Motra ime, Bardhe Kaçorri (Kola) është martuar me Zef Kaçorrin, kushëri i Nikoll Kaçorrit. Bardhja këtë vit ndërroi jetë por ka lënë trashëgimtarët e saj, djemtë, Franin, Mëhillin dhe vajzën Liza dhe nipa e mbesa të tjera si dhe djalin e Franit, Edmond Kaçorrin që banon në Kanada dhe bëri sakrifica njerëzore, morale e financiare duke bërë të mundur që më 2011, eshtrat e Dom Nikoll Kaçorrit të riatdhesohen nga Vjena e Austrisë dhe u rivarrosën me ceremoni më 13.02.2011 në Katedralen e Shën Luçia-s në Durrës, ku ai shërbeu për 23 vjet si ipeshkëv dhe kryetar i katolicizmit shqiptar. Ai punoi dhe luftoi, përgatiti platformën dhe rrethanat politike, përgatiti flamurin për pavarësinë e Shqipërisë, priti Ismail Qemalin që erdhi nga deti si dhe të gjithë delegatët që do të merrnin pjesë në mbledhjen e pavarësisë. Të gjitha këto veprime u financuan nga Dom Nikoll Kaçorri. Ai i kurorëzoi këto me sukses në Vlorën heroike më 28 nëntor 1912 me Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të parë shqiptar. Veç sa më sipër, vajza e hallës sime, Diluka, (Martja, nëna e Gjonit e të tjerë) është e martuar me Ded Kaçorrin, nga kjo derë ku lindi Nikoll Kaçorri.

Në këto rrethana vërtetohet se Dom Nikoll Kaçorri ka lënë trashëgimtarë të cilët kanë ruajtur e ruajnë me nder e lavdi emrin e personalitetin e tij si burrë shteti. Në këtë kontekst ato ruajnë dhe nderin e lavdinë e shtetit shqiptar.

Vepra e Dom Nikoll Kaçorrit është e pavdekshme dhe do të rrezatojë përherë e më shumë si një "yll" i pashuar ku do të frymëzojë breznitë e tanishme dhe të ardhme për ruajtjen e lirisë dhe pavarësisë së Atdheut tonë të dashur të cilat Dom Nikoll Kaçorri i deshi aq shumë derisa u kushtoi edhe jetën.

Dibranët kanë ruajtur ritet dhe zakonet e tyre në kuptimin e plot saj - atë tradicional të krahinës së Dibrës.

Dasma e dibranëve në Amerikë



Nga: **BEQIR SINA**

Dibranët në Shtetet e Bashkuara që mendohet se janë më shumë se 15 mijë vetë, dhe në New York - ishullin e "dibranëve" si u pëlqen t'a thërrasin gazetarët, ishullin Staten Island, ky komunitet jeton si në "një qytet i vogël" shqiptarë, si në Dibër. Dibranët, këtu që janë edhe të organizuar në Shoqatën Atdhetare Dibra, kan ruajtur ritet dhe zakonet e tyre, me nje histori të gjatë në Amerikë, në kuptimin e plot saj - atë tradicional të krahinës së Dibrës.

Kjo, sidomos, kur bëhet fjalë për gazmendet të tilla familjare, si ato që mbahen edhe sot në Dibër : si synetit, fejesat, martesat, diplomimet, dhe evenimente të tjera familjare. Të gjithë këto në Amerikë, tek dibranët janë si me qenë në Dibër. Ashtu si më parë dasmat në Dibër që bëheshin në shtëpi dhe zgjatnin shtatë ditë, tani është e pa mundur për t'i bërë si më parë. Edhe në kurbet është më e vështirë të bëshë dasmë të tillë, një javë. Kështu që Dibranët bëjnë një darkë të madhe gati si dasmë, me këngë e valle, bëjnë tre ditë para ceremonisë së dasmës, një darkë që quhet "hajrli", e cila zakonisht mbahet vetëm me njerëzit më të afërt familjes, të cilët shkojnë të urojnë pra t'a bëjnë "për hajër".

Kështu ishte edhe Dasma e Ylber Pilkut , e cila "çuditi" lagjen të ejten, nga "zhurma" e madhe e muzikës shqiptare, daullja(lodrat) por nuk mungojë edhe flamuri kuq e zi - duke u valvitur nga gëzimi i madh i dasmorëve, që u demostrua edhe në rrugë, ditën e shtunë, kur krushqit dolën nga shtëpia të marrin nusen.

Nisi, pra sipas traditës dibrane një dasmë madhështore, e dibranëve në Amerikë, ajo e martesës së Valon Pilkut, djalit të biznesmenit dhe veprimtarit të njohur Ylber Pilku (pronari i kompanisë All State Scaffolding, Inc), me vajzën një familje patriote nga Kukësi, të bijën e Asllan Muja. Gjatë dasmës së Valonit me Ziza më 30 qershor në lokalin luksoz Orion Palace në Brooklyn , i zoti dasmës Ylber Pilku me bashkëshorten Vjollcën, djalin Atdhe dhe vajzen Blerona dhe vëllezërit e tij(Fatmiri, Besniku, Xhaferri , Asllani, Fitimi dhe dy motrat Vjollca dhe Lulzimja) të ardhur edhe nga Dibra e Madhe me 21 mysafirë të tjerë - pritën më shumë se 550 vetë, në lokalin Orion Palace .

Dasma, e bërë ditën e shtunë më 30 qershor në mbrëmje, në lokalin luksoz në Brooklyn - New York, ku edhe jetojnë dy familjet qe me të vërtet madhështore, ashtu si i bëjnë të gjithë dibranët dasmat këtu në Amerikë. Dasma kishte një dekor të bukur të dukshëm dhe shumë tërheqës. Kishte ushqim të bollshëm dhe pije të ndryshme. Orkestra e njohur në komunitet e drejtuar prej mjeshtrit të muzikës Raif Hysenit dhe bilibilit të këngës popullore, Merita Halili dhe kengetari Petrit Beqiri e "ndezën" dasmën . Dasmorët, pa pushim vallëzuan dhe kënduan gjithë kohën deri pas mesnate me këngë e valle nga të gjitha viset shqiptare.

Në dasmën e Ylber Pilkut, nga Dibra e Madhe, dasmën dibrane në New York, u mbush me haren një dasme e madhe, ku çdo dasmorë , si ata që ishin nga Shqipëria,Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Çamëria, Lugina e Preshevës e diaspora, mbeten shumë të kënaqur. Dasma u mbyll sipas traditës me "Vallen e Burrave të Dibrës" një valle e rëndë dhe me lëvizje dinamike, e cila kërcehet vetëm nga burrat dhe në çdo dasmë dibrane, ai që i bie "lodrës" hynë vetë në mes të burrave duke i rënë daulles sipas ritmit.

Pra kjo ishte dasma e madhe dibrane, në New York, ku u martuan me njëri-tjetrin Valon Pilku me Ziza Muja. Që të dy jetojnë në Brooklyn - New York, dhe madje janë të lindur, rritur dhe edukuar këtu, por që flasin mjaft mirë shqip. Valoni është djali 21 vjeçar, i diplomuar për biznes dhe që punon si manaxher i kompanisë All State Scaffolding, pronë e babait të tij . Valoni është profesionist shumë i mirë, i diplomuar në Universitetin e Baruch në New York, të cilin babai i tij - veprimtari i njohur Ylber Pilku nga Dibra e Madhe e ka edukuar ashtu si fëmijët e tjerë me patriotizëmin shqiptarë.



NJOFTIM

Në muajin shtator të këtij viti do të botohet libri "**HISTORIA E DIBRËS",** i historianit **Kristo Frashëri.**

Qytetarët apo biznesmenët që dëshirojnë të japin kontributin e tyre në botimin e këtij libri historik për Dibrën, mund të kontaktojnë në këtë numër telefoni: **+355 69 20 68 603** ose mund të na shkruajnë email **<mbbotime@gmail.com>**

Stafi i M&B

MANI STYLE
-hair diffusion

"Mani Style – hair diffusion" është një sallon parukerie, i cili është hapur në Tiranë më 28 korrik 2011.

Drejtuesi i saj është diplomuar në Akademinë "U.N.A.SM-U.N.F.A.SM", me qendër në Modena të Italisë, e cila ka një shtrirje në gjithë Europën Perëndimore. Ai ka një eksperience pune dhe mësimdhënie prej 11 vitesh në Itali, 6 prej të cilave pranë stilistit më të njohur italian, "CarloBay" në Firenze.

Vjen në Tiranë për të sjellë eksperiencën dhe teknikat e fundit të parukerisë italiane.

Ka marrë pjesë për 11 vite rresht në Panairin Botëror të Bolonjës, ku marrin pjesë parukierë nga 40 shtete të botës me markat më të fundit të bojërave dhe stilimit. Gjithashtu ka marrë pjesë edhe në panaire të fushës së parukerisë në Çeki, Spanjë, Slloveni, etj.

"Mani Style" rikthehet në Tiranë me një sallon dhe akademi të avancuar 9-mujore, me program mësimor të akademisë italiane. Secili nxënës me mbarimin e këtij kursi ka mundësi të hapë sallone e të jetë i suksesshëm në këtë fushë. "Mani Style" është në kontakt të vazhdueshëm me homologët e tij në Itali dhe sjell në kohë reale modelet e fundit të fushës së parukerisë.

"Mani Style" është certifikuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale si dhe është certifikuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit më 12.10.2011, me NUIS L11927011H.

"Mani Style" ndjek punën e studentëve të saj edhe pas mbarimit të kursit, si dhe do të hapë kurse specializimi periodike për axhornimet e modës së fundit Pranverë/Verë – Vjeshtë / Dimër.

Pas kurseve 9-mujore për parukeri, "Mani Style" ofron edhe kurse të specializuara, seminare, sfilata brenda dhe jashtë vendit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni
Tel. **(04) 22 444 87.**
Cel. **067 23 38 068**
e-mail: <**h.mani@libero.it**>
fb. **MANI STYLE Hair Diffusion / www.manistyle.com**

cyan magenta yellow black

veprimtari

Përkujtohet 92 vjetori i Qeverisë së Arrasit



(Vijon nga faqja 9)

QEVERIA E ARRASIT APO QEVERIA E LUFTËS

Rrezet e nxehta të diellit nuk i pengonin njerëzit të rrinin e të prisnin këtë aktivitet historik që mbahej në kuadër dhe të 100 vjetorit të pavarësisë. Pas himnit kombëtar, Prefekti i Qarkut Dibër zoti Genc Sharku zbulon pllakën përkujtimore, e cila ishte vendosur në murin e shtëpisë së Riza Lushës, i cili, duke përshëndetur të pranishmit ndër të tjera tha: "Të jemi krenarë ne brezat e sotëm për veprën e të parëve tanë. Të përulemi me respekt për këto figura të mëdha patriotike dibrane që bënë të mundur gjithmonë me të gjithë pushtuesit e huaj sidomos ato serb , dibranët të jenë fitimtarë.

Në përshëndetjen e tij për të pranishmit, kryetari i komunës zoti Sali Tërshalla tha: " Kjo nuk është një datë historike vetëm për ne, vetëm për Arrasin por për të gjithë Dibrën dhe më gjerë. Jemi mbledhur ta përkujtojmë këtë datë pikërisht këtu ku u mblodh ajo qeveri që udhëhoqi luftën e popullit dibranë kundër serbit. Ne sot sapo kemi nisur një punë të mirë duke e kthyer këtë shtëpi në një muze. Nesër do ta plotësojmë e jo vetëm dibranët por dhe shqiptarët kudo që janë, dhe turistët e huaj të vijnë e ta vizitojnë këtë muze pak metra sipër Drinit të Zi, tek Kulla e Lushës, tek ajo kullë që mblodhi qeverinë e luftës dhe gjëmoi pushka për herë të parë. Kumtesën me temë "Qeveria e Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme kundër serbe, gusht 1920" e mbajti kryetari i shoqatës së historianëve dibranë zoti Moisi Murra, i cili ndër të tjera evidentoi dhe njëherë ato figura historike: "Në katin e parë të kullës së Lushës zunë vend Ramiz Bej Dibra, Dine Bej Maqellara, Izet Bej Maqellara, Ramiz Daci, Jashar Erebara, Dulejman Çela nga Patini i Matit, Ismail Strazimiri, Dine Hoxha, Selman Alia, Selë Bajraktari, Selim Noka, Haxhi Noka, Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Selim Kaloshi (Sinjë), Met Skepi, Dan Cami, Selman e Hakik Mena, Llan Destani, Kurt e Dik Spata, Ali Tahiri, Destan Puca, Osman Lita e shumë burra të tjerë nga gjithë Dibra. Kuvendi i mbledhur nxorri dhe komitetin e luftës me antar Ramiz Dibrën, Ramiz Dacin, Elez isufin, Dulejman Çelën, Isuf Xhelilin, Jashar Erebarën, Ismail Strazimirin, Destan Pucën, Dine Hoxhën, Riza Lushën, Osman Litën, Shaqir Demën, Dasn Camin. Komandant i përgjithshëm edhe pse ato ditë ndodhej në Lashkizë u zgjodh Elez Isufi. Vërtet treva dibrane u pushtua dhe popullata po masakrohej egërsisht, vazhdoi më poshtë Moisi Murra, por shpirti kryengritës i dibranëve nuk u mposht kurrë. Dibranët pas një viti do të hidheshin përsëri në kryengritje që në histori njihet me emrin "Lufta e Lanë-Lurës". E parë në tërësi, veprimtaria e Prefekturës së Drinit apo "Qeverisë së Luftës", ruan vlera që njësohen me vendet dhe parlamentet më të njohura të Europës së sotme moderne". Por kjo luftë e përgjakshme e dibranëve trima domosdo nuk kaloi dhe pa viktimat e saj, pa heronjtë e Dibrës.

Dhe njëri ndër to është çidhnaku Osman Paci, i cili u hodh me gjoks mbi mitralierin serb e ra bashkë me të të në greminën e Kodrës së Shkekës. Rapsodi mes telave të çiftelisë këndoi:

"Osman Paci, Osman Çidhna,
bie ti por ngrihet Dibra…".

Populli i këndoi heroit të vet dhe e kujton e do ta kujtojë gjithmonë se fali jetën e tij të re që këmba e pushtuesit serb të mos shkelte trojet e të parëve tanë. Këshilli i komunës Arras për të lartësuar më shumë kontributin dhe veprën e këtyre patriotëve dhe atdhetarëve të flaktë nderoi me titullin e lartë "Qytetar Nderi i Komunës" pas vdekjes: Ramiz Bej Dibra, Elez Isufi, Ramiz Daci, Dulejman Çela, Riza Lusha, Sheh Zumani i Teqes së Vleshës. Vonë kur dielli humbi tej në horizont u larguam nga Arrasi, por atmosferën e festës e lamë aty. Sigurisht që do vazhdojë gjatë. Fundja muzeu historik pikërisht për këtë datë të shënuar sapo u hap në Arras, tek ajo kullë që 92 vjet ma parë mblodhi krerët e Qeverisë që bënë luftën e vitit 1920. Do të vijnë vizitorë të shumtë e do të njihen më mirë me historinë e Dibrës, me atë histori ku serbit iu dridh toka nën këmbë e Dibra mbrojti me gjak kufijtë e saj.

Shënim: Ilustrimet me vargje janë marrë nga libri "Legjenda e një fisi" me autor Ilir Spata



Rruga e Arbërit nr. 75

edukim

Me padrejtësi Dibrën e ndanë në dy pjesë, por ata kurrë nu arritën të copëtojnë shpirtin kombëtar të dibranit. Dibranët nuk mundi t'i ndajë vija e kufirit. Dibrat e dy anëve i dhanë njëra-tjetrës dije, dashuri, bashkim, guxim, trimëri e besë.

Roli i dijetarëve islamë për mësimin shqip dhe pavarësimin e Shqipërisë



Nga:
AHMET ÇAUSHI
Myfti, Dibër

Pavarësia e vendit tonë nuk qe dhuratë individësh apo shtetesh. Ajo ishte frut i ndërgjegjes kombëtare e shoqëruar me përpjekje, djersë e gjak prej bijve që lindi e rriti ky truall.

Jemi në vitin e njëqint, që kur populli ynë fitoi të drejtën për të jetuar i lirë e i pavarur në vendin e tij. Në këtë jubile kujtojmë me nderim medresistët e hoxhallarët, që me përkushtim, përgjegjësi kombëtare e fetare Islame dhe sakrifica dhanë kontributin maksimal për ta bërë Shqipërinë të lirë, të pavarur dhe popullin shqiptar të bashkuar. Deri në arritjen e kësaj dite, populli ynë provoi pushtues të shumtë e të egër. Vendi ynë u pushtua e u mbajt nën sundim nga romakët e krishterë për rreth 1000 vjet, është pushtuar (e akoma ka toka të pushtuara) nga grekërit, bullgarët e serbët, është pushtuar e sakatuar nga italianët, gjermanët, austriakët e francezët, që të gjithë të besimit të krishterë. Gjithashtu, rreth 500 vjet u pushtua nga turqit e besimit musliman. Që të gjithë pushtuesit e lanë popullintonë në varfëri e padije e, që të dyja janë ortake të pushtuesve, për të zgjatur deri në përjetësi sundimin e tyre. Nuk qenë të mjaftueshme as rreth 2000 vjetët për t'ia mohuar popullit tonë të drejtën për të qenë shqiptar, sepse Zoti e kishte krijuar shqiptar në Shqipëri, për të jetuar i lirë. Shqiptarët mbijetuan. Në ballë të luftës qenë edhe dibranët.

Feja Islame është universale. Ajo, në shpirtin e besimtarëve, u jep jetë e gjallëri kombësive, mbi bazën e respektimit të barazisë midis tyre. Ajeti 13, sure Huxhurat (Kurani shqip, faqe 595) thekson dhe urdhëron: "O ju njerëz! (është thirrje dhe urdhër për tërë njerëzimin) Vërtet Zoti ju krijoi juve nga një mashkull e një femër (jeni vëllezër e jetoni si të barabartë). Ju bëri popuj e fise që të njiheni midis jush e, pa asnjë dyshim, tek Allahu, më i nderuari prej jush, është më i ruajturi (nga padrejtësitë)." Fakt tjetër kuranor për këtë problem shkruhet në sure Rum, ajeti 22 (Kurani shqip, faqe 464):

"Nga argumentet e Krijuesit është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Vërtetë, në këto ka argumente për njerëzit e ditur."

Që kur lind njeriu, lind për të jetuar i lirë. Ai nxirret nga errësira e bëhet i lirë e i aftë të zgjedhë vetë rrugën e jetës. Krijimi në kombësi të ndryshme e në gjuhë të ndryshme u jep të drejtën këtyre kombësive ta ndërrtojnë jetën e tyre në vendet e tyre, të lirë e të pavarur. Pra, askush, as i madh e as më i fuqishëm, nuk ka të drejtë t'u heqë kombësive të tjera të drejtën për të jetuar të lirë e të pavarur. Kjo është e drejta islame për popujt. Zoti i krijoi të jetojnë të lirë.

Së dyti, Zoti e bëri njeriun zëvendës të Tij në tokë, e krijoi këtë qenie të përsosur, të njohë e të shfrytëzojë botërat me të gjithë përbërësit e saj. Për këto duhej shkolla, duhej të mësuarit, kjo dhuratë e Zotit e posaçme për njeriun. Edhe vetë Libri i Zotit fillon zbritjen me urdhërin e Krijuesit: "Mëso!"

e që pasohet me urdhëra e vlerësime për dijen e dijetarët:

"Mësoje diturinë nga djepi deri në varr!" – urdhëron profeti Muhammed (a.s.)

"Vdekja e dijetarëve është sa vdekja e botërave."

Populli ynë në shekuj i provoi luftërat, por ato të veçuara nga dija nuk siguruan fitoren që donte, prandaj patriotët e mësuar vendosën ta nisin edhe një herë këtë luftë, duke ndriçuar mendjet e njerëzve me dije, shkollim në gjuhën shqipe. Një ndër shkaqet kryesore të pranimit të fesë Islame ishte gjetja tek feja Islame mësime e mbështetje për liri, pavarësi e shkollim.

Skënderbeu i bashkoi shqiptarët në luftë kundër pushtuesve turq dhe, për rreth 23 vjet, mundi t'i zmbrapsë rrëmbyesit e lirisë. Ai, me të njëjtën forcë, luftoi kundër turqve muslimanë dhe venedikasve të krishterë.

Populli i Dibrës i ruajti në kujtesën e tij luftërat e Skënderbeut. Odat dibrane qenë transmetueset e kuptimeve për këto luftëra nga brezi në brez. Tregimet për këto luftëra nuk lanë të harrohen e as të dobësohen ndjenjat kombëtare. Dashuria për atdhe, përkushtimi e detyrimi për të jetuar të lirë e të pavarur, për bashkim e bashkëjetesë në të gjitha fushat e jetës, u forcuan me pranimin e fesë Islame. Sa më shumë njihej feja Islame, po aq më tepër ndizeshin ndjenjat kombëtare e besimtarët bëheshin më të guximshëm dhe kurrë nuk pushuan aksionet për të mos njohur pushtues. Hafiz Ali Korça, lidhjen "fe – atdhe", e shpreh kështu: "Nuk e di me ç'mendje thonë:

"Kush s'ka fe e do atdhenë?!"
Duhet të mendohen pakë,
Fe, Atdhe, janë binjakë."

Në shekullin XIX nisi rënia e Turqisë, filloi të rrudhej në kujtimet e saj. Traktati i Shën Stefanit u siguroi bullgarëve e Serbisë pavarësinë, ndërsa Greqia e kishte siguruar atë më parë. Pas shkëputjes nga Turqia, fqinjëve tanë (Greqisë, Bullgarisë e Serbisë) iu shtua oreksi për përvetësimin e tokave shqiptare drejt Kosovës, Shkupit, Tetovës, Dibrës e më tej. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ata e nisën punën e tyre me kishat. Në tokat shqiptare kishte kisha e, me shpejtësi, filluan të ndërtojnë të reja. Pranë kishave ngritën shkolla fetare kishtare dhe feja detyrohej për t'u mësuar në gjuhën greke, bullgare dhe serbe, me qëllimin për të justifikuar pushtimin e këtyre viseve se janë serbe, bullgare e greke. Për t'ia arritur këtij qëllimi, së pari duhej të harrohej gjuha shqipe, ky tregues bazë e kryesor i etnisë shqiptare. Krejt ndryshe këshillon e udhëzon feja Islame. Në Kuran (përkthimi shqip), faqe 459, ajeti 46 thuhet: "Me besimtarët e krishterë polemizoni si është më e mira, veç atyre që janë mizorë." Pasardhësi i profetit Muhammed (a.s.), Umeri, në pragun e vdekjes, mbështetur në Kuran, la këtë porosi: "Unë po vdes. Ju lutem të interesoheni për të krishterët, të cilët i keni amanet prej Zotit dhe pejgamberit. Hapni sytë e mos i cënoni, se nesër, para Zotit do të përgjigjeni."Mësuesi i parë i gjuhës shqipe në Dibër, Seid Najdeni – Hoxhë Voka, për këtë veprim të fqinjëve shovinistë shprehet "Me nj'anë, nëpër Shqipni bëjnë shkolla për me na i ndamë mëmëdhetarët e krishterë pi nesh, qi të na humbin emnin të vjetër e të dlirë tonë."

Dijetarë islamë e hoxhallarë, në kundërvënie të qëllimeve sllave e greke, pranë xhamive hapën shkolla fetare. Ndryshe nga ata kishtare, në to do të mësohej feja në gjuhën shqipe, por me alfabet arab, sepse gjuhës tonë i mungonte alfabeti. Dibra e Madhe atëherë kishte 9 xhami dhe pranë secilës prej tyre një mejtep. Mejtepet u pasuan me Idadije, Rushdije dhe Medrese. Në këto mejtepe e medrese mësuan e u edukuan Hoxhë Seid Najdeni, Vehbi Dibra, Hoxhë Hasan Moglica, Haki Sharofi, Sherif Langu, Hafiz Mahmuti e të tjerë, që të përkushtuar e shkrinë jetën e tyre për lirinë e pavarësinë e mëmëdheut. Nxënësit që morën mësimet e fesë Islame në këto medrese, ku jepeshin edhe histori e gjeografi, u gatuan për të qenë të aftë për të marrë përsipër përgjegjësinë e madhe për ta bërë popullin tonë të ditur, të lirë e të pavarur. Këtë rradhë do të fillohej më për mbarë, do të fillohej me të mësuarit e gjuhës shqipe dhe në të njëjtën kohë edhe nëfrontet tjera, që do të çonin të sigurtë në liri e pavarësi.

Feja Islame, në mënyrë të përsosur, thekson detyrimet që sjellin pavarësinë. Ajo bën detyrë të domosdoshme pavarësinë. Gjithashtu bën detyrë edhe njohjen, ruajtjen dhe zhvillimin e vendlindjes.

"Të duash atdheun është detyrë e besimit Islam." – thotë profeti (a.s.) Ai që i përkushtohet atdheut dhe popullit të tij, deri në sakrificën finale, merr dy shpërblime: në vlerësimin Islam rradhitet pas profetëve, "emërohet shehid" dhe është i shlyer nga tërë përgjegjësitë e tjera. Futet e përjetësohet në ndërgjegjen e popullit. Hoxhallarët medresistë si Haxhi Vehbi Dibra, Seid Najdeni, Sherif Langu, Hoxhë Moglica, Haki Sharofi e të tjerë, u dhanë këto mësime e vlerësime dibranëve dhe, dibranët i bënë pjesë të jetës së tyre. Dibranët shkonin me dëshirë në luftë për të mbrojtur truallin shqiptar dhe për të merituar titullin "shehid". Mjaftonte një krismë pushke e kuptueshme për mbrojtje nga dushmani e në grumbuj vraponin njerëzit për t'u dalë zot tokave të tyre. Dibranët e motivuar për liri e pavarësi i shohim duke luftuar në Prizren, Gjakovë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Janinë etj. Kudo ka gjak dëshmori dibran. Nëse një ditë do të ketë një përmendore luftëtarësh dibranë, kjo përmendore do të ishte aq e lartë sa të shihej në Mitrovicë, Prizren e Gjakovë, Shkup e Selanik. Podgoricë, Shkodër, Durrës, Vlorë e Janinë. Këta medresistë futën në të mësuarit e gjuhës shqipe urdhërin e fesë Islame për të mësuar dije edhe në gjuhën tonë dhe për bashkëjetesën. Feja Islame u dha forcë për t'iu kundërvënë pushtuesit dhe dredhive të fqinjëve shovinistë. Në liri e me dije jepej siguri për përparimin e kombit tonë. Seid Najdeni, tek libri i tij "Fe Rrëfenja" (botuar në vitin 1900), shkruan: "Feja pa mëmëdhenë nuk shtrëngohet. Kjo me diturinë merr fuqinë, me dashurinë në mest gjen shpëtimnë." Këta medresistë, me mençuri, ditën të lidhin ngushtë mësimet e fesë me historinë e popullit tonë, të popujve dhe të botërave. Të gjitha këto shërbyen për ta ushqyer e forcuar ndërgjegjen kombëtare. "Ma s'pari, t'i lamë vjedhsitë e vrasat ndërmjet, se me kto as Zoti na do dhe as profiti na qas (afron)." – thoshte Seid Najdeni në librin e tij. Më tej ai vazhdon: "Sikur me u bëmë barí, në vend të fyellit do të kërkoj librin, do të marr vesh fenë e besën. Njeriu si të merr vesh fenë e besën, pi dore të tij, vras, të vjedha e të tjera të liga, s'do të ketë."

Dhënia e mësimeve të fesë në sipërfaqe kishte krijuar në popull një shtresë e kuadro, të cilët e shihnin të mësuarit e gjuhës shqipe me sy jo të mirë, po ashtu edhe formën e zgjidhjes së çështjeve kombëtare. Kjo e detyron Hoxhë Seid Najdenin të shkruajë: "Nuk asht kjo dituni kundra fesë, si e xhexhim e si e shofim me sy të dhëmshëm pi disa njerëz të verbër. Kjo tufë njerëz quhen armik të mëmëdhesë e të fesë." Hoxha gjuan ashpër ata që krijonin vështirësi në të mësuarit e gjuhës shqipe dhe të luftës kundër pushtuesit e synimeve të fqinjëve shovinistë.

Dibra e Madhe, në fund të shekullit XIX, numëronte rreth 20000 banorë, aq sa kishin secili nga qytetet e mëdha të Shqipërisë. Dibranët e kishin bërë qytetin e tyre qendër të rëndësishme administrative, zejtarie dhe tregëtie. Aty përpunohej hekuri, kishte rrobaqepës (terzi), qeleshepunues, punime artistike, samarpunues, këpucar, armëpunues e zbukurues armësh. Tregtarët bënin tregti me Shkupin, Prizrenin, Shkodrën, Korçën, Vlorën, Bullgarinë, Stambollin etj. Nga të gjitha këto vise jepnin e merrnin, por edhe lidhnin shoqëri e miqësi. Në të njëjtën kohë bëhej edhe lidhje shqiptarësh për probleme kombëtare. Ajo u bë qendër ndër më të rëndësishmet e luftës për liri e pavarësi. Qyteti i Dibrës së bashku më të Nëntë Malet e krahinës shumë herë i patën futur dridhmën ushtrisë së organizuar turke.

Seid Najdeni lindi e u rrit në këtë qytet. Mësimet e para Seidi i mori në mejtepin pranëXhamisë së Re në Dibër të Madhe. Nëmoshën 18 vjeçare, i ati, Islami, e dërgoi në Edrene, në medrese. Pas dy vjetësh, me dëshirën e tij dhe me miratimin e të atit, shkoi në Stamboll për të vazhduar medresenë "Hajdar", që ndryshe e thirrnin "Klubi i shqiptarëve". Seid Najdeni, me të mbaruar këtë medrese, mbushi çantat me



Pllakë përkujtimore

abetare të gjuhës shqipe të hartuara në Stamboll dhe u nis për Dibër. Ishte viti 1888, pak pas hapjes së shkollës së parë shqipe në Korçë. Sa arriti në Dibër, hapi kurset e para për të mësuarit e gjuhës sonë me alfabet shqip. Këto kurse ishin ilegale dhe zhvilloheshin në bodrumin e dyqanit të Sherif Gorencës, tek Xhamia e Re dhe në një shtëpi afër varreve ortodokse. Në një kurs kishte 4 – 5 veta. Nxënësit e parë ishin shokët dhe të afërmit e Seidit, tani Hoxhë Voka, si dhe fëmijë patriotësh. Shumë shpejtë u rrit numri i atyre që mësonin, sepse secili nxënës mësonte në shtëpi vëllezër e motra. Këto kurse u mbyllën e u hapën disa herë. Kurse të tilla, me interesimin e Hoxhë Vokës, u hapën edhe nëpër fshatra si në Bllacë (Zerqan) nga Sheh Sula. Në fakt, thotë Fadil Shehu, në Zerqan ka patur mejtep shumë më herët. Të tjera kurse u hapën në Homesh nga Shaqir Daci, në Maqellarë, Dohoshisht, Brezhdan etj. Abetaret vinin nga Stambolli, Sofja e Bukureshti me kujdesjen e Seid Najdenit. Në vitin 1895 Seidi u nis për të shkuar në Stamboll, për të vënë në dijeni patriotët shqiptarë për gjendjen në Dibër. Në Edrene e arrestuan dhe e mbajtën në burg 15 muaj. Në burg qendisi vetë një flamur me shqiponjë. Kur u kthye në Dibër, ky flamur u përdor në dasma, mbulonin nusen me të, u përdor në ndërtimin e shtëpive të reja dhe në festa popullore. Aktiviteti i tij patriotik i kaloi kufijtë e Dibrës. Ai lëvizte në Dibër, Kosovë, Vlorë, Korçë etj. Ai kaloi edhe kufijtë e vendit tonë. Bëri një vizitë në kolonitë shqiptare të Sofies, Bukureshtit, Barit, Romës etj. Gjatë këtij udhëtimi iu keqësua shëndeti. Iu rëndua tuberkulozi. Edhe pse i sëmurë, ai botoi një abetare të bërë vetë për gjuhën shqipe dhe "Ferrëfenjësja e muslimanëve", ku pasqyron tërë ndienjat e tij për popullin e tij dhe mëmëdheun. Ai ishte plotësisht i bindur se populli do t'i gëzonte lirinë, pavarësinë dhe shkollën. Ja si shprehej: "Mos u bëni merak se shumë shpejtë do të vijë dita që bilbilat edhe këtu në Shqipni do të këndojnë lirisht gjuhën e vetë të ambël."

Viti 1903 e gjeti Seidin të dobësuar e të lodhur. Më 21 nëntor 1903 ai ndërroi jetë. Në prag të vdekjes kishte lënë porosinë: "Unë do të vdes. Po edhe në vdeksha, ju të mos ju vijë keq, sepse po vdes me dashurinë e atdheut në zemër. Qëllimit, për të cilin u mundova, nuk munda me ia mbërri e për këtë gja po vdes i dëshpëruem e s'ka me më kalb toka. Në varrin tem mos më veni gur, derisa të lirohet Shqipnia dhe kur të fitohet liria, më veni gur t'u m'i shkrue shqip. Në kët gur ngrini ene flamurin e kombit, të cilin unë për fat të keq s'un po e shof për së gjalli." Kështu e nisi dhe e sosi jetën Seid Najdeni.

Sipas fesë Islame, ai që sakrifikon edhe jetën për mbrojtjen dhe për interesat e atdheut, fiton gradën e shehidit (dëshmorit) dhe rradhitet pas profetëve. Për atë nuk ka gjykim. Fara që mbolli Hoxhë Seid Najdeni bëri frutat e saj. Me kujdesjen e tij, Hoxhë Hasan Moglica ngriti kurse për gjuhën shqipe në Gollobordë. Në vitin 1915 e vranë serbët. Ai ndërroi jetë duke thirrur "Rroftë kombi shqiptar!" Hoxha është dëshmor i atdheut. Ishte medresist.

Në këto mejtepe, medrese e shkolla fetare u arsimua Haxhi Vehbi Dibra. Aktiviteti i tij në shërbim të kombit e atdheut është i pakrahasuar. Mori pjesë në klube e grupe patriotike. Kryesoi Kongresin e Dibrës dhe qenë këta patriotë, të cilët ia ndërruan kahjen këtij kongresi. Qe delegat i Dibrës në shpalljen e Pavarësisë. U zgjodh kryetar i Senatit të parë shqiptar. Bekoi flamurin kombëtar, veprim ky i domosdoshëm atëhere. Ishte nënkryetar i Qeverisë së Vlorës dhe zëvendësonte Ismail Qemalin kur ishte

(Vijon në faqen 18)

portret

Hasan Ballanca lindi në qytetin e Dibres së Madhe në vitin 1880. Hasani, mohuesit e idealeve kombëtare dhe sherbetoret besnik, e të ulët të të huajvet , do ti demaskonte në shkrimet e tij.

Hasan Ballanca, atdhetari dhe publicisti

Zgjerimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fillim të shekullit XX, solli shtimin e radhëve të atdhetarëve dhe të intelektualeve që vunë mbi gjithçka interesat e atdheut dhe të kombit shqiptar. Midis tyre, shquhet edhe atdhetari dhe publicisti Hasan Ballanca. Hasan Ballanca rrjedh nga një familje atdhetare e njohur në Dibër. Ajo kishte miqësi me familjen e Iljaz Pashë Dibrës, i cili për një kohë ishte Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, familjen e Arif Xhuglinit, pjesëmarrëse në Kongresin e Manastirit, etj.

FAMILJA

Familja e Hasan Ballancës kishte përqafuar idetë e Rilindjes dhe që bërë përhapëse e zellshme e tyre në Dibër. Ballancat ishin kundërshtar të familjeve të parisë dhe të atyre që bashkëpunonin me pushtuesit osman. Xhaxhai i Hasan Ballancës, atdhetari Hysen Qani Ballanca, ose Ballëhanza, i njohur me emrin Hysen Qaniu (1868-1914) me banim në qytetin e Dibrës së Madhe, studioi në Stamboll. Ky ishte besimtar i sektit mysliman, bektashi, simpatizonte frashërllinjtë, kryesisht Naim Frashërin. Ai luftonte për të mësuar. E futur në të shkruar gjuhën e kulluar shqipe dhe për frymën e lartë patriotike. Hyseni këndonte: "Në mos sot nesër po / Vallen tonë do ta shtojmë".

Hysen Ballanca punoi në Elbasan e Korçë. U arrestua dhe u dënua nga gjykata ushtarake në Selanik. U internua në qytetin Mersin në Anadoll. Luftoi kundër serbëve. Hyseni vdiq në vitin 1914 në Stamboll ku pati shkuar për mjekim. (Haki Stërmilli , libri, "Dibra në prag të Historisë", dorëshkrim në Arkivën e Instituit të Historisë.) Hysen Ballanca, Hysen Qaniu ose Hysen Dibra, ndikoi në formimin atdhetar e patriotik të nipit të tij Hasan Ballancës.

Hasan Ballanca lindi në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1880. Familja e tij kishte pasur mos pajtim pikëpamjesh e deri edhe përleshje me arme më parësinë e turkomanët vendas. Kjo traditë familjare do të ndikonte fuqimisht në përgatitjen dhe formimin e tij politiko-shoqëror për të ardhmen. Hasani, mohuesit e idealeve kombëtare dhe shërbëtorët besnik e të ulët të të huajve, do t'i demaskonte në shkrimet e tij.

EDUKIMI, PUNA DHE EMIGRIMI

Mësimet e para Hasani i mori në qytetin e lindjes, pastaj ndoqi shkollën qytetare në qendër të vilajetit, në Manastir. Sipas të dhënave, ai vazhdoi studimet edhe në Stamboll, por largohet nga shkolla dhe kthehet, në qytetin e lindjes, në Dibër të Madhe. Hasani filloi punën, fillimisht telegrafist i thjeshtë në Dibër të Madhe dhe brenda një kohe të shkurtër u bë drejtues i zyrës postëtelegrafike. Ai postin e tij e përdori edhe për qëllime atdhetare. Këta veprime e bënë atë, të bjerë në sy të zyrtarëve anadollak e turko, anë të Sulltan Hamitit, të cilët e vunë në shënjestër. Hasani vazhdonte të propagandonte idetë e lirisë e të shpërndante libra në gjuhën shqipe. Veprimet e tij u bënë objekt pune për organet e policisë turke. Me i zellshëm në ndjekjen e tij u tregua njëri nga oficerët, komandanti turk, kapiten Ymer Efendiu, i cili u përpoq t'ia bënte gjendjen të padurueshme. Hasan Ballanca e vrau oficerin në mes të qytetit të Dibrës së Madhe, për të mbrojtur nderin e Atdheut dhe ndjenjat kombëtare, të cilat oficeri turk u përpoq t'ia fyente. Akti i Hasan Ballancës, siç e quanin shkurtimisht me mburrje të afërmit e bashkëqytetarët, u miratua dhe u përshëndet nga banorët e Dibrës. Ata e ruajtën,e fshehën, e përcollën Hasanin dhe i krijuan kushte që të arratisej nëpërmjet krahinës së Matit, jashtë Atdheut. Ai u end nëpër shumë shtete të Europës, ku ra në kontakt me disa atdhetarë shqiptarë si në Austri, Itali, Egjipt etj. Hasan Ballanca gjatë kohës që ishte në mërgim, u lidh ngushtë me atdhetar të shquar si Ismail Qemalin, Frashërllinjtë e të tjerë patriotë. Si pas Dervish Himës, nënkryetar i shoqërisë 'Vëllazëria Shqiptare" e themeluar në Kajro të Egjiptit, në mesin e muajit mars të vitit 1901, nga vetë Ismail Qemali u zgjodh një i qujtur Hasan Femi Dibrani. Ky nuk është tjetër veç se Hasan Ballanca. Këtë bindje e forcon fakti, se ai ruajti lidhjet e ngushta me plakun e Vlorës, Ismail Qemalin edhe me pas. (Letër e Dervish Himës dërguar Ibrahim Temos. Kajro 22 mars 1901. Monografia e Dervish Himës 1872-1928 Tiranë 1987 faqe 91-92 autor Kristo Prifti.)

Hasan Ballanca, me që nuk arriti të gjente punë në këto vende, në fillim te vitit 1900, ai pas shumë sorollatjesh shkoi në Tripoli (Gab-Tarabulus) në Afrikë ku asokohe vali ishte shqiptari Raxhep Pashë Mati, i cili i dha një nëpunësi. Ka mundësi që këtu të këtë qëndruar deri në shpalljen e kushtetutës së Perandorisë Osmane. Pas fitores së revolucionit xhonturk të korrikut 1908, Hasan Ballanca u kthye në Dibër.

*Letër nga Malësia e Dibrës ndër Horesh**

Me datën 25 vjeshtë e parë 1911. Artikullin e shkrua Hasan Ballanca.

Siç u shkrova edhe më parë, Malësorët e Dibrës për të fituar të drejtat e tyre fisnike të cilat nuk u janë dhënë prej qeverisë, po përpiqen të shtojnë dhe të forcojnë bashkimin e tyre. Kanë bërë shumë mbledhje dhe kanë lidhur besë në mes tyre të mos hiqen aspak nga kërkimi i këtyre të drejtave. Për të marrë vësh shkaqet e kësaj lëvizje u poqa shumë herë më shumë, më shumë me kryetarët e malësisë. Nga përpjekjet që bëra më këto zotërinj, mora vesht se lëvizja e vjetme ushtarake dhe qeverimi i lig, i ka dëshpruar fare malësorët. Malësorët duke se qeveritarët nuk vështrojnë me sy të mirë edhe njëjesije popullin, janë idhëruar fortë dhe kanë vënë këmbë duke marrë nder sy nevojat dhe vetijat e popullit, të vendosë nome prej qeverisë të cilat të jenë degë të vërteta të nomit themeltar të konstitucionit.

Kërkojmë të mos shtërngohen prej qeverisë qendrore me udhëzime të pa drejta dhe të këne nome të veçanta për qeverimin e këtyre viseve që kurrë s'kanë parë shkëndie qytetërimi deri me sot. Kudo që të pyesin nga malësorët, të përgjigjet derdhur lot si brëshër dhe të tregon grushtat që i janë dhënë kombësisë edhe të numëron të gjitha ata padrejtësi që u bënë edhe ndër çështje të Kosovës dhe të jep të kuptosh se mendja e përgjithshme e malësorvet tregon se i kanë kuptuar të gjitha nevojat kombëtare dhe prandaj i bëjnë këto mbledhje për të fituar këto të drejta. Të gjitha padrejtësitë që kanë parë i shtyjnë të varfërit malësor të mos i besojnë qeverisë për asgjë. Vjet mblodhën ushtarë prej malësisë dhe i dërguan në Ezrum, ndër Jemen, dhe ndër Diar-Beqir. Kjo i trembi shumë malësorët dhe thanë se, veç ndër kohë lufte, neve s'kemi djem për të mërguar. Djemtë tanë do të mbushin detyrën luftarake nëpër vendin tanë.

Kur u shpall lufta me Italinë erdhën urdhëra zyrtarësh për të mbledhur ushtarë. Malësorët e pandehën se kjo ishte një gënjeshtër e qeverisë për të mbledhur ushtarë prej malësisë. Por kur e kuptuan malësorët se vërtetë Mbretëria luftonte me italinë, bënë një mbledhje të madhe ndër të cilën vendosen ti lënë kërkimet e tyre gjersa të mbaronte lufta me italinë dhe të azërohen (Të behen gati) për të vajtur vetëdashës (vullnetar). Ata malësor që e kanë zyrtarisht për të vajtur ushtar dhe ata thonë, se gjër sa të mos merremi vesht me qeverinë për të drejtat tona dhe ne duhet te emërohemi vetëdashës. Sot vajce (ifq) ndër malësi edhe në Varret të Shupenzës erdhen ca njerëz prej qeverisë që të merren vesht me malësoret për këtë çështje. Atje qenë mbledhur malësorët e nëntë maleve dhe gjashtë njerëz prej qeverisë. Malësorët zgjodhën kryetar të përgjithshëm Mersim Demen dhe 400 pleq prej malësisë. Hajredin Pustina, që ishte një nga të dërguarit të qeverisë, u dëshprua që nuk u prit mirë nga malësorët, por megjithë këtë mori fjalën dhe u tha: "Qeveria po lufton me Italinë, madje e pergjithshme (opinion i përgjithshëm) i Evropës është kundër, shumë vise nga mëmëdheu gjenden në rrezik të madh, prandaj neve jemi dërguar prej qeverisë të merremi vesht me juve për këtë çështje." Mersim Dema iu përgjigj dhe tha: "Neve jemi kurdoherë të gatshëm të tregojmë dhimbjen tonë që kemi për atdheun, gjersa të njihen prej qeverisë të drejtat kombtare tërë malësorët ushtar qofshin ose jo, janë të gatshëm të vën vëtdashës dhe të luftojnë; prandaj i lutemi qeverisë gjer sa të merremi vesht me ata të nëmërojnë si vëtëdashes. Neve ndjenjat i kemi më të larta se juve për dashjen e memëdheut.

Pastaj Zenel Dote (Doda. Xh. R.), Ram Duka, Zejnel Hoxha, bënë një mbledhje të veçantë dhe pas një sahati, Zenel Hoxha vajti dhe i këshilloi dërgimtarët e qeverisë, se tërë malësorët e nëntë maleve janë të gatshëm të vënë vëtëdashës, por të mos ndahen ca prej ata e të quhen si ushtarë. Po beri qeveria kundër këtij vendimi, fajin nuk do ta këne malësorët, po do ta kenë ata vetë.

Gazeta "Drita" e Manastirit, 1911, 9 vjeshtë e dytë.

** Duhet të jëtë Homesh. Shënim. Xh. Roçi*

PËRKUSHTIMI NDAJ ÇËSHTJES KOMBËTARE

Hasan Ballanca, në mënyrë të veçantë u kujdesua për bashkimin e trevave fqinjë si Dibrën e Madhe, Matin, Mirditën e malësitë për rreth, në luftë për sigurimin e të drejtave kombëtare. Hasani u bë një ndër korrespodentët të parë, në mos më i pari i gazetës "Drita" të Manastirit. Ai shkroi në gazetë herë me emër, herë me iniciale, e sidomos me pseudonimin e tij "Mirosh Dibra" apo me inicialet e pseudonimiot "MD". Ndërkohë, siç i shkruanin shtypit të kohës nga Prishtina, me 18 prill 1912, "S'prani tuj shetitur gati krejt qytetet e Shqipërisë, duke bërë propagandë për çështjen kombëtare. Veprimtaria e dendur atdhetare e Hasan Ballancës tërhoqi vëmendjen e autoriteteve Xhon Turke, të cilët vëzhgonin çdo lëvizje të tij. Në shënjestër të terrorit famëkeq të Shefqet Durgut Pashës në Dibër në vitin 1910, jo rastësisht u vu Hasan Ballanca, të cilin e konsideronin revolucionar të tmerrshëm. Gjenerali i ushtrisë osmane e arrestoi dhe e torturoi atë publikisht në mes të qytetit para xhamisë së Teqes Bektashiane të Shaban Dedës në Dibër të Madhe, deri sa e la pa ndjenja. Ndjekjet nga ana e Xhon Turqeve ndaj këtij atdhetari vazhduan edhe me pas. Në vërë të vitit 1911, duke shkuar nga qyteti i Dibrës së Madhe në Stip e prej andej në Strumnicë, Hasan Ballancën e arrestojnë. Nga Strumnica e dërgojnë në Selanik përmes Dorjanit dhe prej andej në Manastir. Këto mendonin ta çojnë në Dibër për ta gjykuar me që ishte "një nga më të dëgjuarit shqiptar të flakët". Por nën presionin e opinionit publik dhe të qëndrimit të tij të pa përkulur bënë që qeveria osmane, u detyrua ta lirojë duke e dëbuar nga territori i perandorisë. Hasani pasi qëndroi për disa kohë në Dibër ilegalisht, ai kaloi në Kosovë. Ndjekjet e persekutimet që i bëheshin nga autoritetet turke nuk ia arritën ta largojnë nga veprimtaria atdhetare, përkundrazi ai punonte me vullnet e guxim për kombin shqiptar, për bashkimin e trojeve shqiptare. Edhe në burg, por edhe si doli nga burgu ai punonte me shume për të realizuar qëllimin e idealin e tij.

ÇËSHTJA KOMBËTARE DHE PUBLICISTIKA

Në shkrimet që formulonte e i dërgonte shtypit, Hasan Ballanca, në radhë të parë i bënte jehonë qendrës së masave popullore, ndaj politikës shkombëtarizuese, ndaj dhunës dhe shfrytëzimit, të ushtruar nga qeveritarët e rinj xhonturq të Perandorisë osmane, përmes taksave, detyrimeve, shërbimit ushtarak, e sidomos me anën e mohimit të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Këto shkrime qenë fryt i kontakteve të drejtpërdrejta të autorit me popullsinë e revoltuar të krahinave. Letrat e tij vinin nga Gryka e Madhe, nga Prizreni i Kosovës etj. Pa kaluar shume kohë ata do të vinin edhe nga malet, nga çetat kryengritëse. Edhe kur largohej nga Dibra, Hasani, ndiqte me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve në Dibër. (Rruzhdi Mata: "Hasan Ballanca luftëtar e gazetar, militant për çështjen kombëtare" shkruar në gazetën "Ushtima e Maleve" Peshkopi, datë 18.11.1987). Në Prizren, në muajin mars të vitit 1912, Hasani mori lajmin e gëzuar për futjen e gjuhës shqipe me shkronja amtare në shkollën normale të qytetit të tij. Ky akt shinonte një fitore të rëndësishme të elementeve patriot mbi parinë reaksionare të Dibrës e cila përkrahte alfabetin arab. Për këtë fitore Hasan Ballanca bëri një artikull me titull "Çdrejtësia nuk ka qëndrim dhe jetë të gjatë" dhe e nënshkroi me pseudonimin Mirosh Dibra. Ai në këtë artikull shpjegonte se shqiptari nuk lejohet të luaj më të drejtat e tij. (Gazeta" Drita" nr. 59 datë 15.03. 1912 në Manastir).

Duke marrë shkas nga fitorja e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në luftë me reaksionin turkoman, autori demaskon qëndrimin antikombëtar të parisë reaksionare, e cila siç shkruan ai, "Nuk mund të përfaqësojë dëshirën e llauzit te qytetit".

Qëndrimi i saj antikombëtar ka, si pas tij, rrënjë të thella. Këto njerëz si Shaqir Beg Jegeni, Salih Beg Leka, e të tjerë në Dibër të Madhe. të cilët tani ngriheshin kundër alfabetit kombëtar, tridhjetë e tre vjet më parë qenë ngritur kundër Lëvizjes Shqiptare të Prizrenit. Ago Jegeni vëllai Shaqir Jegenit, kishte qëlluar për të vrarë Abdyl Beg Frashërin, shkruan ndër të tjera Hasan Ballanca, në artikullin "Shpëtimtari i Shqipërisë."

Këto element reaksionarë e antikombëtar vazhdojnë të ecin me pikëpamjet e Luigjit XIV në Francë, që kënaqeshin nga metodat inkuizicionale të përdorura nga ekspeditat xhonturke në Shqipëri. Shihet qartë, se gazetari "Mirosh Dibra" me demaskimin që i bëri qëndrimit antikombëtar të reaksionit feudal i përkiste krahut revolucionar e demokrat të Rilindjes në fillim të këtij shekulli. Pavarësisht nga konfuzimet, të përligjura nga kushtet në të cilat zhvillohej Lëvizja jonë Kombëtare, këto pikëpamje karakterizoheshin nga optimizmi. Hasan Ballanca shikonte gjithnjë përpara. Ai që i bindur se veprimtaria e reaksionit nuk ishte në gjendje të bënte ballë hovit revolucionar që kishte shpërthyer. Në fund të muajit shtator dhe në fillim të muajit tetor të vitit 1911, Hasan Ballanca mori pjesë aktivisht në mbledhjen që çoi në besëlidhjen e nëntë maleve të Dibrës, të Matit, të Martaneshit, të Çermenikës, të Selitës, të Mirditës dhe Lurës. Në mbështetje të kërkesave kombëtare të malësoret të Mbishkodrës të parashtruara në Memorandiumin e Grëçës që në qershor të atij viti. Kjo mbledhje si dhe mjaft mbledhje te tjera si kjo, që u mbajtën aso kohe anë e kënd vendit, iu kundër vuan me forcë përpjekjeve të qeverisë xhonturke për t'a trajtuar kryengritjen e Hotit e të Grudës dhe të Kelmendit si një çështje thjeshtë lokale, malësore, në një kohë kur kryengritësit malësorë kishin dalë me kërkesa kombëtare në emër të mbarë shqiptarëve. Edhe përfaqësuesit e këtyre krahinave të mbledhura në kuvendin e tyre, siç komentonte pjesëmarrësi e njëkohësisht kronikasi i ngjarjes Hasan Ballanca, kërkonin që edhe atyre tu njiheshin po ato të drejta që u ishin njohur edhe malësorëve të veriut. Konkretisht ata kërkonin ".. me pushkë n'dorë duke u mbajtur në një nyje të Momerandiumi të Shkodrës që bënte fjalë se shërbimi ushtarak i djemve të Shqipërisë do të kryhej në vend. Brenda kufijve të Shqipërisë"' (Gazeta "Drita" e Manastirit nr. 38 datë 9.10. 1912.)

Hasan Ballanca në shkrimet e tij theksin e ve në karakterin kombëtar mbarë Shqiptarë dhe të kërkesa të veçanta. Gjithë kjo nuk ishte e rastit. Kjo rridhte nga vetë karakteri i luftës së popullit tonë, nga qëllimet e synimet e kësaj lufte të kristalizuara që prej më se tridhjetë vjetësh, që nga koha e lidhjes së Prizrenit.

Zëdhënësi i kësaj lufte parimore e të synimeve të saj bëheshin, çka është e kuptueshme, elementët më të ndërgjegjshëm, më revolucionarë të kohës, siç që dhe Hasan Ballanca, të cilët u lidhën ngushtë me masat popullore shqiptare të ngritura në revolt. Por koha e bënte edhe më të ngutshme nevojën e theksimit të karakterit kombëtar të luftës së mbarë popullit tonë. Re të zeza po dukeshin në horizontin shqiptar, ndërkohë kishte filluar lufta italo-turke. Shqiptarët nuk mund të ishin indiferent ndaj saj, sa do që ajo zhvillohej shumë larg trojeve shqiptare.

Pas sulmit të Italisë në Tripoli, 1500 përfaqësues të Malësisë së Dibrës, bënë një mbledhje në Fushë të Gjoricës, ku siç shkruan vetë Hasan Ballanca, ata u betuan dhe lidhën besën se do të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut edhe për shpëtimin e një guri të atdheut. Përfaqësuesit e dibranëve Osman Karaj, Allaman Elezi, Selman Kurti dhe Jakup Cani Sofraçani, i njoftuan mytesarifit, (Prefektit) të Dibrës vendimin e mbledhjes. Malësorët ishin gati të luftonin si "vetëdashës" vullnetar dhe si ushtar të rregullt në qoftë se siguroheshin të drejtat kombëtare. Nuk mund të vishen ushtar, deklaronin ata, njer (deri) sa t'u përgjigjet qeveria kërkesave që ka malësia.

Lidhja që bëhej midis gadishmërisë se tyre për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Perandorisë Osmane, kryesisht të trojeve shqiptare me plotësimin e kërkesave kombëtare nuk qe diçka e rastit. Prandaj përfaqësuesit e dibraneve po aty theksonin se ishin të gatshëm "t'i shërbenin atdheut si më besnikët e Perandorisë Osmane, duke u gezumun me të drejtat e tyre", - shkruante Hasan Ballanca. (Hasan Ballanca Çështjet malësore, në gazetën "Drita" Manastir nr.38. data 9.10. 1911).

Përgatiti: Xhelal ROÇI

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 75

histori

Vitit 1911 qe një këmbanë e fuqishme që sinjalizonte perendimin e Perandorisë osmane nga Shqipëria.

(Vijon nga numri i kaluar)

Kryengritja kundërosmane e vitit 1912

Nga: **MOISI MURRA**

"Lëvizjet kryengritëse në Dibër kishin hyrë në një fazë që ishte vështirë të frenoheshin, veçanrisht me forcën e armëve. Duke e konsideruar lëvizjen e krahinës së Dibrës të vitit 1912 nga më seriozet, që nga shpallja e kushtetutës së turqve të rinj, autoritetet osmane të vilajetit të Manastirit propozuan masa të reja për të qetësuar gjendjen. Ministri i Punevë të Brendshme të Turqisë, Haxhi Adil beu kishte arritur në përfundimin se Dibra "gati tërësisht u kishte dalë dore autoriteve qeveritare." Prandaj dhe mori masa për të vënë nën kontroll duke bër një riorganizim të ri të administra. Sipas këtij organizimi, Dibra ndahej tri kaza dhe 16 nahij.

Kazaja e Dibrës së Epërme përfshinte: Nahijene Grykës së Vogël (Kucuk Bogaz, me qendër në Homesh, Nahijen e Grykës së Madhe (Buyuk Bogaz), me qendër në Valikardhë, Nahija e Ostrenit të madh (Ostren Kebir), me qendër në Ostren, Nahija e Sebishtit, me qendër në Sebisht, Nahija e Trebishtit, me qendër në Trebisht, Nahija e Koxhaxhikut, me qendër në Koxhaxhik, Qafë Murra kalonte me Matin.

Kazaja e Dibrës së Poshtme përfshinte: Nahijen e Çidhnës me qendër ne Arras, Nahijen Reç, Dardhë, Lurë me qendër në Dardhë, Nahija Luznisë, me qendër në Luzni

Kazaja e Rekës, përfshinte:

Nahijen e Krakornicës, me qendër në Karkonicë, Nahija e Nistroves me qendër në Nistrovë, Nahijen e Zharnanicës, me qendër në Zharnicë

Mytesarif në Dibër u emërua oficeri madhor i shtabit të përgjithshëm të vilajetit të Manastirit, major Servet beu. Sipas diplomatit austriak në Manastir, "Administrata e Dibrës gjendej pjesërisht në duart e ushtrisë". Nga ana tjetër, autoritetet qeveritare te vilajetit të Manastirit, mendonin se lëvizjet shqiptare në Dibër e kishin nxitur ajgentët italianë. Avni Munir beu, vali i Manastirit, pohonte publikisht se "në rrethinat e Dibrës vërehen njerëz që janë anëtar të një komiteti të fshehtë shqiptar, i cili ekziston në Cetinë". Në të vertetë, ditët e para të qershorit 1912, kishin ardhur në Dibër tre persona, por këta nuk ishin agjent italianë. Këta ishin misionar të lirisë, Sali Hoxha (Hidi) sekretari i Ismail Qemalit, Themistokli Pollo dhe Gore Dindi, që kishte dërguar në Dibër atdhetari elbasanas Aqif Pasha, për të ndihmuar në propogandimin e kryengritjes së përgjithshme kundër turke. Aqif Pasha i kishte porositur misionarët që atdhetarët e Dibrës të tërhiqnin sa më shumë fshatarë nga Çermenika në luftë, me që lëvizja atje ishte e dobët. Turqit ngrinin versione për të goditur e shuar lëvizjen shqiptare në Dibër, duke përdorur llojë llojë alibie. Konsulli serb në Manastir duke i gjykuar zhvillimet e atyre ditëve me objektivitet e kokëftohtësi kishte arritur në përfundim që turqit Osman duhej të vlerësonin kërkesat e dibranëve në mënyrë që lëvizjet e tyre të mos zgjeroheshin. "Lëvizja shqiptare në Dibër, - vlerësonte konsulli serb në Manastir, - vetëm mund të zgjerohet,



Haxhi Vehbi Agolli(Dibra)

në qoftëse autoritet qeveritare nuk iu bëjnë shqiptarëve të gjitha konçesionet, të cilat do t'i kërkojnë ata. " Gjendjen më alarmante e bënte peshkopi serb Varnava, nga Manastiri, i cili sipas informaave që kishte mbledhur në Dibra, ku të gjithë meshkujt kishin dalun maleve, kurse në shtëpi kishin mbetur vetëm gratë dhe fëmijët, informonte se: "Shqipëria do të bëhet varri i Turqisë evropiane". Porta e Lartë provoi t'iu plotësonte dibranëve disa nga kërkesat e paraqitura më parë. Kështu në dhjetëditëshin e fundit të muajt maj 1912 arriti një telegram nga Stambolli, në Dibër me anë të cilit njoftoheshin viset kryengritëse se ishin të liruar nga tatimi dhe shërbimi ushtarak për tre vite, si dhe iu lejohej mbajtja e lirë e armëve. Po hynte qershori i vitit 1912. Malësorët të inkuadruar në çeta kryengritëse vazhdonin të qëndronin në male. Ditët e para të qershorit nën udhëheqjen e Ismail Strazimirit u ngritën fshatarët e Çidhnës, të Arrasit e të Muhurit. Malësorët e Nëntë Maleve të Dibrës së Epërme dhe të Poshtme thirrën "Kuvendin e Dheut", te vendi i quajtur Gropa e Ujkut, ku u kërkua largimi i forcave ushtarake dhe i postave të xhandarmërisë, hapja e shkollave shqipe, anulimi i detyrimeve të vergjisë dhe kryerja e shërbimit ushtarak në vend. Ndërkohë, rreth 300 ushtarë osmanë, që ndërmorën një sulm kundër kryengritësve në zonën e Gjurasit, të Homeshit, të Dardhës e të Reçit, u thyen nga fshatarët e këtyre anëve dhe të shpartalluar u detyruan të kthesheshin në Dibër prej nga nuk guxuan të dilnin më. Në këtë kohë një punë të madhe bëri Klubi "Bashkimi i Dibrës" i kryesuar nga atdhetarët dibranë Sadulla Strazimiri, Eqerem Cami, Ismail Strazimiri, Shyqyri Qoku, Sherif Langu etj. Ditët e para ta qershorit 1912, përfaqësues të maleve të Dibrës dhe paria e qytetit të Dibrës u dërzuan autoriteteve osmane në Dibër një memorandum me anën e të cilit bënë të qartë qëndrimin e tyrte dhe të tërë popullatës së krahinës. Në momerandum theksohej: Shqiptarët nuk do të pranonin të kryenin shëbim jashtë Shqipërisë, nuk do të paguanin kurrëfar tatimeshtë reja, nuk do të lejoni që në fshatrat e tyre të vepronin ligjet shtetrore osmane, nuk do të lejohej të ngriheshin karakollet e projektuara. Merrej vesh, bisedimet me turqit e ri kishin marrë fund. Dibranët tani nuk flisnin vetëm në emërin e tyre, por dhe më gjërë. Ata bënin presion të prerë se "do të rroknin përsëri amët dhe do të dilnin në male në qoftë se nuk do t'iu plotësoheshin kërkesat" e paraqitura në momerandum. Dorëzimi i momerandumit autoriteteve turke përkoi me urdhërin që u lëshoi Komiteti i Stambollit komiteteve dhe klubeve, për kryengritjet të përgjithshme në gjithë Shqipërinë. Komiteti i fshehtë i klubit të Dibrës, sipas udhëzimeve që pati marrë nga Klubi qendror i Manastirit, vendosi të hidhej në kryengritje, jo vetëm "për me kërkue lirinë e mësimit të gjuhës sonë, por, - siç shprehej Ismail Haki Peqini që ishte atje me shërbim, - për me ngritë flamurin kuq e zi". Në Dibër urdhërin e kryengritjes e solli Eqerem Cami. Anëtarët e Klubit"Bashkimi" bënë një mbledhje, ku në shenjë respekti e ndigjuan urdhnin në këmbë. Mbasi u betuan, vendosën se kush do të dilte në mal e kush do të qëndronte në qytet për me u dhënë shokëve ndihmë morale e material. Më 14 qershor ikën nga qyteti i Dibrës Rifat Millo Hanxhiu, i cili i kishte marrë oficerit turk që banonte në shtëpinë e tij tri pushkë automike. Më 17 qershor ikën dhe Nuri Çaushi me 25 ushtarëdhe shkojnë në malësi pranë Mersim Demës. Më 21 qershor të vitit 1912 një grup oficerësh e ushtarësh (8 oficerë dhe 140 ushtarë) të batalionit të parë të regjimentit të 49-të të këmbësorisë, të udhëhequr nga oficeri shqiptar Tajar Tetova, i njohur për ndihmesën e madhe që kishte dhënë në fitoren e Revolucionit xhonturk (1908), lanë kampin pranë Manastirit dhe dolën në mal. Dalja në mal e Tajar Tetovës dhe e ushtarakëve të tjerë të bashkuar me të, ndikoi në zgjerimin e lëvizjes kryengritëse në zonën e Dibrës. Po në këtë kohë, në Dibër rreth 500 ushtar, shumica shqiptarë, të udhëhequr nga oficerët shqiptarë të garnizonit të Dibrës, si kapiten Ismil Haki Libohova, toger Ismail Haki Peqini dhe toger Ibrahim Gjakova dolën gjoja për stërvitje në Fushën e Mireshit, pranë urës së Spiles dhe aty u bashkuan me rreth 50 veta nga qyteti e rrethinat, që ishin vënë nën komandën e Dan Camit. Tek Ura e Spiles kishin dalë për tu bashkuar me këtë kontigjent oficerësh e ushtarësh dhe Ismail Strazimiri, Hafiz Sherif Langu, Izet bej Maqëllara, Sadulla Strazimiri, Sheh Latifi i Teqes së Shaban Dedes, Shyqyri Ilias Pashë Qoku, Qamil Daci, Ali Zeqo, Shahin Cami, Nurçe Xhuglini, Rifat Mizoja e të tjerë. Nga krahina e Fushë Dibrës u bashkuan me kryengritësit Dine bej Maqëllara, Nazif Grazhdani, Abdulla bej Allajbegia, Dalip Pajku, Sefedin Ilnica e të tjerë. Në Dibër të Poshtme lëvizja filloi nën kryesinë e Elez Isufit e të Selman Alisë, të Hysen Ndreut nga Dardha e të Zenel trocit nga Reçi. Kryengritësit e Grykës së Vogël u ndanë: një pjesë nën kryesinë e Jashar Zenelit prej Bllace shkuan dhe u bashkuan në "Vorre të Vrame" me çetat e Ymer Pervizit, Tush Shehut, Sheh Mustafa Krajkës, Sheun e Teqes së Madhe të Bulqizës dhe me ushtarët shqiptarë që kishin derzertuar nga ushtra turke e ishin vënë nën komandën e oficerëve kapiten Ismil Haki Libohova, toger Ismail Haki Peqini dhe toger Ibrahim Gjakova. Ndërsa një pjesë tjetër e kryengritësvetë nën kryesinë e Mersim Dmës qendruan në Grykën e Vogël me idenë e shtrirjes së veprimeve luftarake në front të gjërë nga "Vorret e Vrame''mbi Zerqan, Shupenzë, Topojan, Luzni, Çidhën, Dardhë e Reç. Por mjerisht kryengritësit ishin të pa armatosur. Për këtë qëllim Mersim Dema dërgoi me ngut tek Aqif pashë Elbasani Ibrahim Kolecin prej Gjorice dhe Rrahman Lekën pre Kovashice që të siguronte armë për kryengriësit dibranë. Dhe atdhetari i madh elbasanas Aqif Pasha shiti misër nga hambarët e tij, bleu 200 armë dhe ia dërgoi Mersim Demës në Homesh. Atdhetarët dibranë bënë përpjekje që këto lëvizje t`i koordinonin në plan ndërkrahinor si me Matin, Elbasanin, Mirditën dhe Kosovën. Prej çetave të Elbasanit erdhi me disa shokë në "Vorre të Vrame" Irfan bej Ohri (Qoku), për Mirditë e Kosovë u nis Ibrahim Gjakova dhe Ismail Haki Devën. Ndërkohë kryengritësit kosovarë të udhëhequr nga Bajram Curri, Riza Kryeziu dhe Mahmud Zajmi hynë në Gjakovë. Më 17 korrik 1912, rreth orës 12. 00 kryengritësit iu afruan Prishtinës. Po këtë ditë u njoftua se kabineti i turqëve të ri u detyra të jap dorëheqje. Më 21 korrik kryengritësit kosovar të udhëhequr nga Bajram Curri e Hasan Prishtina çliruan Prishtinën. Rradhët e kryengriësve shtoheshin nga ora në orë. Kryengritësit kosovarë pas çlirimit të Prishtinës ishin tërhequr në Ferizaj dhe prej aty i bënin presion qeverisë turke që të pranonte kërkesat e shqiptarëve. Porta e Lartë pranoi të hynte në bisedime dhe nisi një komisioni qeveritar të përbër nga Sulejman Pasha, Danish Efendiu dhe Avni bej Gjilani, të cilët mbërritën në Shkup më 27 korrik. Nga ana e tyre edhe krerët e viseve jugore të Shqipërisë mandatuan Hasan Prishinën që t'i kërkonte komisionit të pranonte autonominë e Shqipërisë. Po më 27 korrik u mblodhën në Prishtinë udhëheqësit e kryengritjes kosovare të cilët kërkuan shpërndarjen e parlamentit. Komisioni nuk e pranoi këtë kërkesë, duke e quajtur antikushtetuese. Si rrjedhim, bisedimet u ndërprenë. Më 29 korrik udhëheqësit e kryengritjes i dërguan Stambollit nga Prishtina një ultimatum, ku thuhej: "Në qoftë se shpërndarja e parlamentit nuk bëhet brenda dyzet e tetë orëve, do të vazhdojmë marshimin". I tronditur nga ky paralajmërim, Veziri i Madh njoftoi krerët shqiptarë që të prisnin për t'i vijuar bashkëfjalimet me Ibrahim Pashën, i cili ishte vënë në krye të delegacionit. Më 5 gusht qeveria e shpërndau parlamentin. Qeveria e Ahmet Miftar Pashës ra. U krijua qeveria e re e drejtuar nga Qamil Pasha. Hasan Prishtina, duke shfrytëzuar destabilitetin qeveritar turk i modifikoi 14 kerkesat e paraqitura në kuvendin e Junikut dhe më 9 gusht ia dorëzoi komisionit qeveritar në Prishtinë. Pavarësisht se në 14 kërkesat e Hasan Prishtinës pati një zbutje në krahasim me kërkesat e kuvendit të Junikut, qeveria tyrke e vonoi përgjigjen. Kjo bëri që kryengritësit kosovarë pas çlirimit të kosovës të marshonin drejt Shkupi. Më 11 gusht kryengritësit të udhëhequr nga Zefi i Vogël dhe Bajram Daklani hynë në Shkup. Bajram Daklani, sipas gazetës "Shkupi", shpalosi në qytet flamurin kombëtar shqiptar. Më 13 gusht hyri dhe grupi tjetër i prirë nga Isa Boletini. Më 15 gusht rreth 6000 kryengritës të udhëhequr nga Bajram Curri hynë në Shkupin e çliruar. Lajmi se kryengritësit shqiptarë hynë në Shkupi i entusiazmoi kryengritësit dibranë, të cilët me një herë u hodhën në veprime luftarake në tërë Dibrën. Kryengritësit prenë linjat telefonike, shkatërruan stacionin e xhandarmërisë, çarmatosën patrullat dhe më 12 gusht 1912 çliruan Peshkopinë. Kryengritësit nga të gjitha anër po marshonin në drejtim të qytetit të Dibrës së Madhe. Prefekti i Dibrës së Madhe major Servet beu, duke gjykuar se qyteti në pak orë mund të binte në duartë e kryengritësve kërkoi dhe hyri në bisedime me krerët kryengritës. Bisedimet u zhvilluan tek Pjepi i Egër në Maqëllarë, ku morën pjesë pa përjashtim të gjithë krerët e Dibrës, myftiu Vehbi Agolli dhe Fuat bej Toptani. Pjesëmarrësit në kuvend u njoftuan se kabineti turk kishte rënë dhe se kërkesat e shqiptarëve ishin pranuar.

Për tu siguruar nëse lajmi ishte i vertetë, u dërguan në qytetin e Dibrës së Madhe Jakup Cani prej Sofraçani e Selman Kurti prej Boçeve. Ata biseduan në telefon me krerët e kryengritjes kosovare në Shkup. Udhëheqësit kosovar iu kumtuan dibranëve se "Të gjitha kërkesat tona u pranuan. Qetsohuni nëpër shtëpiat tuaja". Luftrat shqiptaro-turke kishin përfunduar. Por tytat e armëve të dibranëve nuk arritën të ftohën. Ata u kthyen kundër një pushtuesi shumë herë më barbarë se ai turk, kundër sllavëve të jugut. Dhe përsëri dibranët do të luftonin me vetmohim e heroizëm kundër hegjemonizmit e ekspansionizmit serbomadh, duke dalë dhe jashtë trojeve të Dibrës, në mbrojtje të viseve shqiptare, në Manastir e Follorinë kundër serbëve, grekëve dhe në Shkodër kundër malazesve.

Referenca:

- Historia e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1965.
- Thoma Murzak, Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë luftës së Parë Ballkanike 1912-1913.
- G. Senkieviç, Osvoboditelnoje dvizhenje albanskoga narod v1905-1912 god. Akademija nauk SSSR, Moskva, 1959
- Niko Koleci, Kryengritja e përgjithshme shqiptare, Mbi lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Tiranë. 1962;
- Shukri Rrahimi, Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1909-1912, Kosova I, Prishtinë 1972, cituar sipas Masar Rizvanollit në Dibra dhe etnokulturae saj, vëll. I, Dibër 1995, f
- IHRSh, F. A. V, raport i konsullit austohungarez Halla dërguar Ministrit të Jashtë Erental nga Manastiri, më 5 shkurt 1912.
- Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë, kujtime historike, Tiranë, 2010.
- Selman Jella, Mbledhja e Dheut, Lufta për çlirim kombëtar në vitet 1878-1912, kujtime veteranësh, përgatitur nga Petraq Pepo, Tiranë, 1962
- H. Stërmilli në "Dibra në prag të pavarësisë", Tiranë 1940.
- Sterjo Spase, Kryengritësit, Tiranë, 1983,
- Fadil Shehu, Gafur Zoto, Zëri i brezave, Tiranë 2001

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të territorit të huaj. Përkundrazi serbët janë ata që kanë okupuar më shumë troje shqiptare. Këto janë të vërtetat për tua mbyllur gojën Serbisë, Rusisë e kujtdo tjetër dhe për tua hapur sytë atyre shteteve që u besojnë atyre

Argumentet shqiptare kundër ultranacionalizmit serb

Nga **Rexhep TORTE**

Sa herë që Serbia të ngrejë pretendimet e saj të pabaza ndaj shtetit të Kosovës, ne shqiptarët kemi të drejtë dhe obligim moral e kombëtar t'i tregojmë Serbisë se ka qenë e vogël sa një gogël kur ka ardhur në shekullin e gjashtë nga karpatet dhe se është zmadhuar duke përgjakur, vrarë e djegur popuj e troje të huaja e më shumë ato shqiptare.

Betimi i xhandërmarisë serbe më 28 qershor të këtij viti në shënimin e 130 vjetorit të themelimit të saj, në ditën e Vidovdanit, fjalët e tij kërënuese ndaj Kosovës, përshkuar nga një frymë luftënxitëse e romantike i tregoi mbarë botës se Serbia me lazdrimet që po i bëhen nuk mbushet mend dhe nuk ka ndërmend të ndryshojë nga rruga e saj gjakatare e vrasëse.

Me shprehjet e betimit të xhandarmërisë serbe se, "Pa Kosovën nuk ekziston as populli im serb. Pa Kosovën nuk ekziston Serbia ime. Pa Kosovën nuk ekzistoj as unë.

Popull serb, vëllezër e motra

Betohem para Zotit. Do të fitoj me nder apo do të vdes. Për nderin tim. Për origjinën time. Për familjen time.

Për Serbinë time…", Serbia dhe serbët dëshmuan edhe njëherë ultranacionalizmin e tyre në dëm të shqiptarëve autoktonë të Kosovës.

Deklarata e Vuk Drashkoviq, ministër i jashtëm i Serbisë dhe njëherësh kryesues aktual njëvjeçar i Asamblesë së OKB- së dhënë për opinion më 13 korrik të këtij viti se, "Kosova mund të pranohet në OKB vetëm mbi trupin tim të vdekur", është dëshmi tjetër e primitivizmit serb edhe në rafshin e kulturës të diplomacisë serbe që e njollos edhe atë ndërkombëtare.

Tomisllav Nikoliq, presidenti i sapozgjedhur i Serbisë, më 19 korrik nuk nguroi të deklarojë se, " nuk do të lejojmë që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së".

Por Tomisllav Nikoliq nuk mbaroi me kaq. Ai të nesërmen, përkatësisht më 20 korrik para mediave serbe nuk nguroi të deklarojë se, " po qe se Prishtina sulmon dhunshëm veriun e Kosovës, duhet ta ketë parasysh se edhe Serbia mund ta ndjek të njejtën rrugë për ta kthyer Kosovën". Këto deklarata të tij shprehin padyshim agresivitetin, mediokritetin dhe ultranacionalizmin serb karshi shtetit të ri të Kosovës. Aqë më tepër ku sipas Pakos së Ahtisarit serbëve edhe pse nuk janë as dhjetë përqind në Kosovë, u garantohen të drejtat maksimale që nuk i ka asnjë pakicë në botë. Aqë më tepër kur dihet se në veri të Kosovës janë të pranishme kontrabanda, kriminaliteti dhe forcat ilegale të sigurimit serb të mbështetura nga Beogradi, të cilat në vazhdimësi po e destalilizojnë situatën, e që nuk do t'i lejonte asnjë shtet tjetër sovran.

Kanë kaluar më shumë se dhjetë vite që kur u çlirua Kosova nga Serbia dhe tashmë është shpallur Shteti i Kosovës të cilin gjer tani e kanë njohur 91 shtete të botës. E vërteta është gjithsesi në anën e shqiptarëve, Megjithatë Kosova dhe blloku shqiptar duhet të jenë më energjik në pasqyrimin sistematik të çështjes së Kosovës, sepse bota nuk i ka përjetuar në lëkurën e saj mizoritë serbe dhe mbamendja e saj edhe mund të zbehet shpejt. Të pavërtetat e turpshme sistematike të Serbisë dhe Rusisë ndaj Kosovës, tregojnë qartë sa duhet punuar ndërkombëtarisht për të treguar se si Serbia e vogël është futur në Kosovën e madhe.

Të shumta janë argumentet e Kosovës për të zezat, masakrat dhe tmerret gjenocidale që serbët i kanë bërë ndaj popullit shqiptar. Dëshmitë e pamohueshme historike flasin për gjenocidet e viteve 1878, 1912, 1944 dhe 1999.

Të dhënat historike të pakontestueshme flasin qartë se Serbia ka qenë shtet në miniaturë si sanxhak i Beogradit, dhe se zgjërimi i saj është bërë gjithnjë nëpërmjet okupimeve të trojeve të huaja me vrasje e djegie, e më së shumti të trojeve shqiptare. Këto të dhëna historike i dëshmon edhe Faksimili i hartës së Enciklopedisë Ruse të vitit 1817, ku shihen qartë kufijtë realë të Serbisë në periudhën e viteve 1804, 1810, 1812, 1815, 1820, 1867 që janë shënuar në brendinë e kësaj harte. Kufijtë e sotëm të Serbisë ku përfshihet edhe Kosova, janë arritur vetëm nëpërmjet ekspeditave të përgjakshme serbe ndaj shqiptarëve.

Në fshatin S… të Kosovës jeton një nënë shqiptare, si edhe mijëra nëna tjera shqiptare zemërplagosura, shpirti i të cilës do të mbetet gjithnjë i trishtuar. Jo pse në luftën e padrejtë që imponuan serbët në Kosovë, ia vranë burrin, djalin, ia përdhunuan para syve vajzën e re, por i bënë edhe gjëmën më të madhe që s'do ta kishte bë as soji i bishave më të tërbuara. I nxorrën me hanxhar syçkat e djaloshit tre vjeçar dhe ashtu të përgjakura e të ngrohta e detyruan me forcë që t'i gëlltisë. Këtë ia bënë serbët nënës së urtë e të ndershme shqiptare, si edhe mijëra nënave tjera, të cilat gjithnjë patën në zemër nderin, bujarinë e fisnikërinë, e të cilat asnjëherë nuk dijtën as të fyejnë e as të ngucin kend. Hordhitë ushtarake, policore dhe paramilitare, dogjën e vranë, prenë koka fëmijësh dhe përdhunuan mijëra gra e vajza shqiptare dhe detyruan të shpërngulen më shumë se një milion e gjysëm shqiptarë nga Kosova.

Kemi apeluar disa herë, te Shqipëria, Kosova,Liga Shqiptaro - Amerikane, Lidhja Shqiptare në Botë, apo te biznesmenët shqiptarë, që ta financojnë përkthimin në gjuhë të huaja, botimin dhe shpërndarjen sa më parë nëpër botë të librave rrenqethës dhe tepër argumentues të autoreve kosovare që dhunën serbe ndaj femrave shqiptare e kanë përshkruar në libra.

Apeli ynë mbetet që Libri "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" i autores Luljeta Selimi dhe dy librat e tjerë të botuara rishtas po nga autoret kosovare, të përkthyera tu dërgohen sa më parë Ban Ki Munit- kryetarit të OKB-së diplomatëve në OKB dhe tërë lidershipit botëror. Secili që do t'i lexonte këto libra, do të rrënqethej kur do të kuptonte se çfarë krimesh kanë bërë serbët edhe ndaj femrave shqiptare në Kosovë. Kjo me siguri do të ndihmonte shumë që të kuptonin dhe ta forconin bindjen e tyre për të qenë në anën e shtetit të ri të Kosovës, në anën e të vërtetës, në anën e shqiptarëve.

Ja disa shembuj nga libri i Luljeta Selimit, " Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare". Një nga mjeket deklaron



Faksimile e hartës së Enciklopedisë Ruse që tregon kufijtë realë të Serbisë në vitin 1817

se,"Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishn futur rërë, këmbët i kishte të gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb". Ose rrëfimet e tjera," Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij"," Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë", "Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan", "Më dhunuan para syve të nënës", "Më dhunuan e ma prenë gjirin", "Cigaren e ndezur e fiki në gjinjtë e mi", "Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, "Më detyronin t'i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë", "Pasi më dhunuan, m'i hoqën thonjtë me dana", "Motrën e mbytën me kundak të pushkës", "14 vjeçarja u dhunua në borë", "Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus", "Më çnderuan para syve të babait dhe nënës", "Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur", " Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb", "Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale"….

Këto janë disa sekuenca të mizorive serbe gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, duke mos harruar mijëra e mijëra të vrarët, djegiet, varrezat masive dhe afër dy mijë të zhdukurit, për të kuptuar më mirë se çfarë mizorishë kanë kryer ata edhe në gjenocidet më të hershme ndaj shqiptarëve. Kështu është zgjeruar Serbia në dëm të territoreve shqiptare.

Ministrat e diplomatët shqiptarë le t'i vazhdojnë takimet dhe lobimet për Kosovën, por gjithsesi gjatë takimeve nëpër botë është më se e domosdoshme që bashkëbiseduesve të tyre tu lënë edhe nga një libër të përkthyer të autoreve kosovare për dhunimet serbe në Kosovë. Kjo me siguri do të shërbente si argument i fuqishëm që të huajt t'i kuptojnë më së mëri barbaritë e ushtrisë dhe policisë serbe ndaj popullatës së pafajshme shqiptare në Kosovë.

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të tërritorit të huaj. Përkundrazi serbët janë ata që kanë okupuar shumë troje shqiptare. Këto janë të vërtetat për tua mbyllur gojën Serbisë, Rusisë e kujtdo tjetër dhe për tua hapur sytë atyre shteteve që u besojnë atyre.

Serbia i ngjan një gjarpëri helmues, të cilit po nuk ia shtype mirë kokën, ai sërish ngjallet për të kafshuar.

Doni te informoni komunitetin
rreth jush per dicka
qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Rruga e Arbërit nr. 75

portret

Roli i dijetarëve islamë për mësimin shqip dhe pavarësimin e Shqipërisë

(Vijon nga faqja 14)

jashtë atdheut. Bëri shkëputjen përfundimtare nga komuniteti musliman turk. Qe kryetari i parë i Komunitetit Musliman Shqiptar. Urdhëroi që feja të mësohej në gjuhën shqipe dhe bisedat të bëheshin në gjuhën tonë. Ishte medresist.

Në këto mejtepe e medrese u arsimua edhe Sherif Langu. Punoi pa u lodhur për përhapjen e shkollave shqipe. Qe kryetar administrativ i klubit "Bashkimi". Ishte delegat i dibranëve në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë më 28 nëntor 1912. I ndjekur nga serbo-bullgarët erdhi në Tiranë. Nga viti 1940 deri më 1946 qe kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë. Në vitin 1946, megjithëse kishte qenë delegat në shpalljen e Pavarësisë, qeveria komuniste e dënoi me 10 vite burg. U lirua në vitin 1950 dhe ndërroi jetë më 9 mars 1956 në Tiranë. Ishte medresist. Të gjithë këta medresistë i burgosi rregjimi komunist dhe Hafiz Ali Korça i zemëruar shkruante: " P ë r Shqipëri u përpoqa

Rrezikova jetën time,
Nuk rrëfehet se sa hoqa,
Se shteti m'i njihte krime.
Zot, le të na rrojë Atdheu, kombësia,
Aqë sa të rrojë edhe Gjithësia."

Në vitin 1914 Haki Sharofi hapi të parën shkollë shqipe në qytetin e Peshkopisë. Ishte shkollë e rregullt dhe me leje të Qeverisë. Shkolla e parë shqipe e filloi jetën e saj në xhaminë e vjetër të Peshkopisë. Nuk ishte rastësi. Kudo nëpër xhami mësohej gjuha shqipe. Edhe Lidhja e Prizrenit, mbledhjen e kryesisë e bëri në medresenë e Prizrenit, kurse mbledhjen e përgjithshme e zhvilloi në xhami.

Për të kryer detyrimin fetar për të drejtën e popullit që të jetojë e të ndërtojë jetën i lirë, shumë medresistë ndoqën shembullin e këtyre dijetarëve e patriotëve. Hafiz Zabit Kodra, Femi Xhepa, Hivzi Shehu, Halim Shehu etj., të tërë mësues të nderuar, kanë dhënë kontributin e tyre për arsimin dibran.

Profeti Muhammed (a.s.) thotë se kur ka dhembje një besimtar, të tërë muslimanët kanë dhembje. Në vitin 1913, me padrejtësi Dibrën e ndanë në dy pjesë, por ata kurrë nu arritën të copëtojnë shpirtin kombëtar të dibranit. As pushtimi shekullor, as Traktati i Shën Stefanit, as Kongresi i Berlinit, as Konferenca e Ambasadorëve në Londër, as dy luftërat botërore dhe as rregjimi i egër komunist, nuk mundën ta mbysin e ta ndajnë deri në harresë shpirtin patriotik të dibranit. Dibranët nuk mundi t'i ndajë vija e kufirit. Dibrat e dy anëve i dhanë njëra-tjetrës dije, dashuri e bashkim, guxim, trimëri e besë.

Zoti na krijoi komb më vete, me gjuhë e veçori të tjera dalluese, pra na krijoi për të jetuar të lirë e të pavarur. Feja Islame u dha gjallëri e forcë ndjenjave të atdhedashurisë. Feja është e përhershme e edhe i përjetëson këto të drejta dhe në çdo kohëështë aktuale. Sot shqiptarët kanë ngritur xhami atje ku jetojnë: në Belgjikë, Gjermani, Amerikë etj. Së paku çdo ditë të xhuma, pas qindra kilometrave udhëtim, grumbullohen në këto xhami. Falen e luten, takohen e çmallen, bisedojnë për hallet e tyre e të Shqipërisë. Shumë prej tyre, tani, ditën e xhuma e thërrasin "dita e shqipes".

Angazhimi i medresistëve në arsimin dibran është që këto mësime e këto detyrime t'ua transmetojnë brezave: "Liri, pavarësi e të mësuarit pa kufi, bashkëjetesë kombëtare. Shqipëria siç e duan shqiptarët."

A.ÇAUSHI

** Kumtesa e mbajtur në takimin e organizuar në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë. Takimi u organizua nga Bashkia Peshkopi, Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Myftinia Dibër, më datë 18 prill 2012. Titulli është i redaksisë*

Këshilli i Komunës së Gjoricës, me vendim nr, 12, datë 12.04.2012, i dha titullin "Qytetar Nderi".

Sheh Latifi në luftën për liri dhe shkollën shqipe

Nga: **SHUKRI HAJDARI**

Sheh Latifi lindi më 1875 në një familje qytetare, patriote dhe atdhetare të Dibrës së Madhe.

Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes në një nga Rruzhdijet (kështu quheshin shkollat e ulëta fetare). Pas saj, ai studio në një nga Medresetë e njohura të Stambollit, për të vazhduar më vonë edhe në një shkollë Teologjie në Arabi. Ai mori një edukatë kulturore orientale nga më të dalluarat e kohës.

I rritur në një ambient patriotik shumë shpejtë do të binte në kontakt me Sait Najdenin, do të mësonte gjuhën shqipe me ato grupe të vogla ilegale, 3-4 vetë në bodrumet e dyqaneve dhe në skutat e Shtëpive të Dibrës së Madhe.

Dalëngadalë, Latif Shehu do të propagandonte e do të kthehej në një mësues të zjarrtë të gjuhës shqipe në teqenë e Shaban Dedesë, e njohur në rrethet patriotike të Dibrës së Madhe e më gjerë.

Familja e Latif Shehut, si të gjitha familjet shqiptare, ishte një familje patriotike. Aty fëmijët merrnin elementët e para të edukatës familjare të gërshetuara me zakonet, traditat dhe normat kanunore1.

Latif Shehu pas kulturës që mori në shkolla, u formua edhe si klerik dhe mori titulli "Sheh", dhënë nga Drita Hyjnore, institucioni më i lartë i Teqes në Shqipëri. Nën maskën e edukatës fetare në teqen ku ai shërbente mësonte edhe gjuhën shqipe.

Hysni Myziri, në studimin për shkollat e para kombëtare shqipe, jep shembuj se si mësuesit shqiptarë që shërbenin në Institucionet fetare dhe shkollat në gjuhë të huaj, u mësonin fshehurazi nxënësve të tyre edhe shkrimin shqip2.

Së bashku me Sait Najdenin, Aziz Mezelxhiun, Shaqir Dacin, etj, më 1900 nënshkruan kërkesat ndaj perandorisë Osmane për hapjen e shkollave shqipe3. Kjo ngjalli zemërim të madh në radhët e autoriteteve turke dhe filluan të ndalonin me forcë çdo tentativë për mësimin e gjuhës shqipe në Dibër e rrethinat e saj.

Për perandorinë Osmane, Sheh Latifi përbënte rrezikshmëri, prandaj ai u detyrua të largohej në malësi të Dibrës, në Mallakastër (tek familja Çela), duke lidhur një miqësi që do të konsolidohej e forcohej më shimë në kohën e pushtimit e invazionit serb të viteve 1913-1920.

Në vjeshtën e vitit 1908, për të përballuar reaksionin xhonturk, Sheh Latifin e gjejmë sëbashku me Shaban Pepën, Hajredin Varvaricën, Adraman dhe Nurçe Xhuglinin, Maliq Dacin, Jashar Zenelin erj., shokë të Sait Najdenit, hapën klubin "Bashkimi" që siç thotë Haki Stermilli: 'zhvilluan një veprimtari të shënueshme në fushën kombëtare si dhe propaganduan në qytet dhe në krahinat përreth tue ngjallë në popull dashurinë me mësue shqip 4".

Autoritetet dhe perandoria Osmane, përpjekjeve dhe luftës së patriotëve shqiptare për rritjen e vetëdijes, për hapjen e shkollave shqipe iu kundërvunë me vendimin për hapjen e shkollave turke dhe për rritjen e forcimin e tyre ekzistuese.

Këto masa hasën rezistencën e fortë të Sheh Latifit, Eqerem Camit, Hazis dhe Sherif Langut, Ismail Strazimirit dhe atdhetarëve të tjerë që këmbëngulën pranë guvernatorisë së Manastirit për të lëshuar urdhrin që në gjithë nazin turk të Dibrës, mësimi të bëhej shqip dhe të emërohej mësues Shefqet Daiu5. Kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912, e gjetën Sheh Latifin përkrah Mersim Demës e Dan Camit sëbashku me Sadulla Strazimirin, Shyqyri Iliaz Pashë Qokun, Qamil Dacin, etj, duke organizuar një propagandë të efektshme për dezertimin e shumë ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë që shërbenin pranë garnizoneve turke të dislokuara në Dibër të Madhe, Peshkopi, Rekë dhe Homesh. Kështu kishin filluar përgatitjet për kryengritjet dhe në bashkërendim me kryengritësit e Kosovës, u bë e mundur fitorja dhe shpallja e pavarësisë.



Sheh Latifi

Populli Dibran pak ditë do ta gëzonte fitoren e pavarësisë, detyra të reja u dilnin pas pushtimit serb të Dibrës.

Shumë patriot iu nënshtruan ndjekjeve, persekutimeve e pushkatimeve nga pushtuesit e rinj.

Të njëjtin fat e ndoqi edhe Sheh Latifin, i cili për të luftuar për mbrojtjen e pavarësisë u detyrua të largohej nga Dibra e Madhe.

Ai u strehua në familjen Çela në Mallakastër: Tash iu desh të luftojë përpjekjet për hapjen e shkollave serbe në Dibër të Madhe dhe fshatrat rreth saj, prandaj intensifikoi punën për mësimin e shqipes në situatat e reja, por akoma më të vështira. Me shumë dhimbje mundi të përballojë pushtimin me vrasjet e djegiet e Grykës së Vogël me 1913 duke qëndruar pranë njerëzve me një optimizëm që të ngjallte vetëm shpresa.

Sëbashku me Sheh Sulën e Zerqanit, Latif Shehun do ta gjejmë në fshatrat e Grykës së Madhe, Gjoricë, Bllacë, Homezh për organizimin e luftës dhe përpiqej të ndihmonte sado pak përballimin e vështirësive. Atë e gjejmë gjithnjë në lëvizje nga Tirana në Dibër për t'iu larguar vëmendjes nga ana e serbëve.

Edhe lufta e parë botërore, pushtimi i Dibrës nga Austro-Hungarezët nuk e thyen Sheh Latifin nga përpjekjet për mësimin e shkollën shqipe.

Më 1921-1924, do ta gjejmë anëtarë të degës së shoqërisë "Bashkimi" të nënprefekturës së Zerqanit përkrah Sheh Sulës, duke u rreshtuar në forcat demokratike përparimtare.

Më 2 shtator 1925 u kurorëzuan me sukses përpjekjet e Sheh Latifit dhe Haxhi Ademit

Sheh Latifi ishte një njeri me vizion të lartë, ai përkrahte të renë, një njeri përparimtar me kulturë të gjerë që dinte të respektonte shokët dhe miqtë.

për hapjen e shkollës shqipe në Gjoricë. Së bashku me kryepleqtë Ferit Kaja Gjoricë e Ali Miftari Cerenec u bë realitet ëndrra e shumë fshatarëve të Gjoricës. Sheh Latifi kishte një personalitet dhe autoritet që e fitoi në sajë të kulturës së gjerë, drejtësisë e zgjuarsisë që e tregonte në zgjidhjen e problemeve.

Ai dha një kontribut të pazëvendësueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis fshatarëve në fshatrat e Gjoricës. Eshtë meritë e tij realizimi i kanalit vaditës Lubalesh-Gjoricë, ku në sajë të punës së madhe me njerëzit i dha jetë Gjoricës së Epër. Kjo u bë e mundur më 1925.

Edhe fshatarët e deshën dhe e respektonin atë klerik me zemër të madhe dhe njeri shumë human.

Sheh Latifi nuk e harroi kurrë Dibrën e Madhe. Në 1928 themeloi partinë Demokratike (të majtë) në Dibër të Madhe me dëshirën për të marrë pjesë në zgjedhjet e para demokratike nën pushtimin serb.

"Aderuesit e kësaj partie ndiqeshin nga xhandarët e Kralit dhe të hegjemonizmit Sllav6.

Është i njohur kontributi i Sheh Latifit për luftën Nacionalçlirimtare në Gjoricë e më gjerë. Ai e përkrahu dhe propagandoi atë si një luftë të drejtë dhe ndihmoi në organizimin e Këshillave Nacionalçlirimtare.

Në qershor 1943 zgjidhet si kryetar i këshillit të zgjeruar Nacinalçlirimtare të Dibrës me sekretar Sul Baholli. Pas 4 muajsh, në tetor jep dorëheqjen për arsye shëndetësore dhe kryetar zgjidhet Haki Stermilli7.

Sheh Latifi nuk kishte ndonjë pasuri të madhe, por kishte shpirtin e një humanisti të madh, ndihmonte njerëzit pa përkrahje dhe në nevojë.

Njihen nga të gjithë kujdesi për motrat Sharku, Rrahman Kacnine dhe Haxhi Canin, pa përjashtuar ndihmën e pakursyer për gjithë njerëzit që paraqiteshin në shtëpinë apo teqenë e tij.

Nëpërmjet prindërve tanë, ashtu si edhe ata, i jemi mirënjohës dhe e respektojmë punën dhe veprën e këtyre patriotëve.

Sheh Latifi ishte një njeri me vizion të lartë, ai përkrahte të renë, një njeri përparimtar me kulturë të gjerë që dinte të respektonte shokët dhe miqtë.

Këshilli i Komunës së Gjoricës, me vendim nr, 12, datë 12.04.2012, i dha titullin "Qytetar Nderi".

Përulemi me krenari dhe do të kërkojmë që edhe brezi pas nesh të frymëzohen në jetën e tyre për përparimin e Atdheut dhe Kombit tonë.

Referencat

1 Sotir Temo – Monografia 'Said Najdeni', fq.14
2 Hysni Myziri – Shkollat e Para Shqiptare, Tiranë 1978, fq.133
3 Hysni Myziri – Shkollat e Para Kombëtare Tiranë 1798, fq. 180
4 Haki Stërmilli – Dibra në prag të Historisë, fq.44 – Botimi i vitit 1940
5 Dibra dhe Etnokultura Nr.2, fq.208
6 Sulejman Borova – Pishtarët e Diturisë – Monografi për arsimtarët, fq.42
7 Lufta Nacionalçlirimtare e popullit Dibran, fq. 316

kulturë

Intervistë me këngëtarin Shaban Mziu

Shaban Mziu, një koncert recital për 60-vjetorin

Në fillim të vitit 2013 festoj 60-vjetorin dhe, me këtë rast, po punoj për një koncert recital, ku do të ftoj shumë miq, këngëtarë e artistë, jo vetëm në Lezhë, por edhe në Dibër e Tiranë.



Këngëtari Shaban Mziu, lindi në Reç më 3 prill 1953, pas shkollës fillore në vendlindje vazhdoi shkollën e mesme në Zalldardhë, ku filloi dhe aktivitetin e tij artistik si këngëtar dhe instrumentist.

Në repertorin e tij ka këngën epike si kulmore, por dhe këngë lirike. Shumë këngë të tij ishin të përditshme si valët e radio Tirana e radio Kukësi si dhe në Televizionin Shqiptar.

Fillimet e para në interpretimin e këngës?

Që në fëmijëri kam kënduar dhe i kam rënë çiftelisë, por kënga e parë që kam kënduar në skenë ka qenë viti 1968 në një këngë për Ismet Sali Bruçaj.

Zalldardha të quan pjesëtar të ansamblit "Kuvendi" ndërsa ju jeni nga Reçi?

Edhe në Reç kanë kënduar, por duke qenë nxënës nga Zalldardha, dhe më vonë me punë në Zalldardhë, u aktivizova me grupin e Dardhës. Në Zalldardhë kishte më tepër aktivitete. Por edhe reçjanë të tjerë si këngëtari Arif Vladi, valltari Daut Sufa, shkrimtar dhe kritiku Mexhit Prençi, nga Reçi kanë spikatur me talentin e tyre në Dardhë. Në Zalldardhë gjeta njerëz të përkushtuar për artin, seriozitetin dhe ndihmën e artistëve Haziz Ndreu, Xhelal Çerpja dhe kolegët e mi si Lirie Rasha, Qamil Sula, Cajhe Poleshi etj.

Diçka për Haziz Ndreun sipas jush?

Haziz Ndreu ishte enciklopedist për kulturën. Ndihma dhe inkurajimi artistik ishte i padiskutueshëm, por edhe jashtë skenës, ai ishte njeri i madh dhe i mirë për ne të gjithë. Mund të them se për të mos bërë ndonjë gabim apo sjellje jo të mirë më tepër i ruhesha Haziz Ndreut së prindërve.

Aktiviteti juaj si këngëtar nëpër koncerte?

Me ansamblin e Dardhës dhe Reçit kemi dhënë koncerte në gjithë trevën e Dibrës disa herë në përbërje të ansamblit "Dibra" kemi dhënë koncerte në Tiranë e në disa rrethe të tjera të Shqipërisë. Me ansamblin "Dibra" kam marrë pjesë në tre festivale folklorike në Gjirokastër. Edhe në ansamblin "Çiftelia" të Lezhës kur ndërrova vendbanim jam aktivizuar dhe kam marrë pjesë në dy festivale folklorike në Gjirokastër.

Dhe vlerësimi?

I gëzoheshim duartrokitjeve tepër dashamirëse të spektatorëve, që vërtet na emocionin, por më i suksesshëm ka qenë festivali folklorik i Gjirokastrës i vitit 1978 ku mora dhe dekoratën Urdhri "Naim Frashëri" të klasit të parë.

Po në turne jashtë Shqipërisë?

Pas viteve '90 mu dha rasti të dal e të jap koncerte jashtë Shqipërisë, sidomos në Ansamblin "Shqiponja" në vitin 1993 në Belgjikë, Francë e deri në Australi por dhe në vitet 1994-1996 disa herë në Zvicër, Turqi e deri në Gjermani, ku jam pritur mjaft mirë sidomos me këngën patriotike.

Në repertorin tuaj keni shumë këngë patriotike, cilët do veçonit?

Këngët patriotike, të cilat edhe sot këndohen dhe më kërkojnë t'i këndoj. Kënga "Kodra e Kacës" është një himn për Reç e Dardhë, që në oda burrash, po edhe në dasma këndohet. "Besëlidhja e Prizrenit" edhe sot këndohet e transmetohet, janë këngë nga Gurra popullore, që në Reç e Dardhë është shumë e pasur.

Në shtëpinë e Kulturës në Zalldardhë shpesh vinin dhe të moshuar që këndonin këngë të vjetra, apo motive vërtet interesante si Riza Poleshi apo Xhevahire Gjoka (Cani) po kështu dhe Mehmet Xhaferi një dashamirës dhe njohës i folklorit nga ku ka mor këngën "Cuca vesh me fustan jeshile" një duet me Caje Poleshin, apo këngën "Hajde se jam vetëm" të cilët janë burimore nga folklori i zonës.

Në një drekë me miq këngëtarë të restorant "Brazili" keni thënë "dua të bëj një koncert", vetëm kaq. Vazhdon ta mbash akoma sekret?

E kam mbajtur sekret se ka pak kohë që po punoj për këtë ide, për një koncert recital, por po tregoj edhe këtë sekret. Në fillim të vitit 2013, festoj 60-vjetorin, e në këtë rast në një koncert recital që po punoj për të realizuar do ftoj shumë miq këngëtarë e artistë jo vetëm këtu në Lezhë por edhe në Dibër e Tiranë.

Intervistoi: Ilmi Dervishi

Rruga e Arbërit - gazeta juaj

SHKRUAJ:

rrugaearberit@gmail.com

Vepër me akribi shkencor

Dr. Mahmud Hysa, Polifonia e tekstit letrar, L. Shkollor, Prishtinë, 2012



Nga: **JORGO BULO**, Akademik

Ky takimi ynë i sotëm më çon në kohën e shkuar kur tridhjetë e ca vjet më parë, u takuam në Tiranë ku ju vinit për kërkime në arkiva e biblioteka për tezën tuaj të disertacionit për jetën dhe veprën e Çajupit. Atëhere ende i ri si moshë dhe i ri në fushë të kërkimit shkencor, por me vullnet dhe pasion për t'iu kushtuar kësaj pune, me një a dy libra të botuara, kurse sot me një bilanc prej 20 librash, vetëm të profilit studimor, dhe me më të fundit libër kushtuar veprës romanore të Ibrahim Kadriut. Një bilanc më të vërtetë për t'u pasur zili, fryt i një pune jete të një punëtori të palodhur të studimeve letrare.

Korpusi i veprave shkencore të prof. Mahmut Hysës përfshin studime që pushtojnë gjithë shekujt letrarë, autorë dhe probleme të ashtuquajtur "letërsia e vjetër shqipe", veçanërisht autorë dhe probleme të letërsisë së bejtexhinjve a të alamiadës shqipe, term që e solli ndër të parët në studimet tona prof. Hysa, autorë dhe probleme të letërsisë dhe të kulturës së Rilindjes Kombëtare, midis tyre monografia për jetën dhe veprën e Çajupit, gati shteruese, më e plota monografi për këtë autor të shquar që qëndron në kapërcyell të dy epokave letrare; autorë dhe probleme të letërsisë midis dy luftërave, të letërsisë bashkëkohore, duke ardhur te libri që promovojmë sot për Ibrahim Kadriun si romancier.

Nga libri i parë botuar më 1972, te libri që kemi në dorë sot, në këtë rrugëtim 40 vjeçar, Mahmud Hysa i ka mbetur besnik profilit të tij si pedagog dhe historian i letërsisë, ashtu si i ka mbetur besnik metodës së tij të kërkimit, si hulumtues që i ngre tezat dhe hipotezat e tij mbi faktet e qëmtuara me akribinë e shkencëtarit, mbi argumente dhe interpretime që marrin parasysh tekstin por dhe kontekstin historiko-kulturor dhe social, që nuk rend mbas modave interpretative, por që nuk neglizhon as arritjet dhe prirjet e shkollave bashkëkohore. Me studimet e tij prof. Mahmud Hysa ka kontribuar të rishikohen në dritë të re disa teza e vlerësime të historiografisë sonë letrare, të rivlerësohen disa autorë dhe rryma të procesit letrar, si vepra e Bogdanit përmes monografisë "Bogdani si nuk e njohim", ose letërsia e bejtexhinjve, vepra e Çajupit e të tjera.

Vepra që kemi sot në dorë, e pesta në serinë "Studime", paraqet jo thjesht një përmbledhje studimesh për veprën romanore dhe diskursive të Ibrahim Kadriut, për një përpjekje a një monografi "sue generis" për profilin krijues të njërit prej prozatorëve më prodhimtarë në letrat e sotme shqipe. Zgjedhja e këtij autori, me sa duket nuk është e rastit prej studiuesit; ai sheh në veprën e Ibrahim Kadriut të përthyen disa nga prirjet e zhvillimit të romanit shqip në Kosovë në këtë çerek shekullin e fundit. Ibrahim Kadriu, shkrimtari që ka lëvruar romanin, tregimin dhe novelën, poezinë, prozën për fëmijë, esenë historike ose prozën diskursive, ka sjellë në veprën e tij përmes gjuhës së artit, jetën e njeriut të këtyre trevave, jetën historike dhe bashkëkohore, krajatat dhe kalvarin e shqiptarëve në të kaluarën e largët dhe të afërt. Krijimtarinë e gjerë të këtij shkrimtari, siç vëren prof. Hysa, e karakterizojnë dy tipare thelbësore: prirja për të përvijuar estetikisht realitetin bashkëkohor në rrjedhë të zhvillimeve historiko-shoqërore dhe synimi për ta rrokur atë realitet në kompleksitet, në gjithë arealin kombëtar, si një areal ku rreh pulsi i kombit, shkruhen dramat, humbjet dhe fitoret e tij. Ibrahim Kadriu është një shkrimtar që ka sjellë një larmi të madhe tematike në krijimtarinë e tij, që e pasuruar prozën shqipe me subjekte nga e kaluara historike dhe nga jeta e sotme, që ka pasqyruar dramat e kombit dhe dramat e individit, që ka trajtuar kolizione të mprehta sociale e psikologjike. Kjo pasuri tematike, vëren Mahmud Hysa, ka sjellë një galeri personazhesh, një mozaik tipash e karakteresh shoqërore, të projektuara si tërësi a produkt i rrethanave, por dhe të individualizuara përmes detajesh e imtësish të gjetura me intuitë e fantazi artistike prej shkrimtarit. Si në një afresk të gjerë në krijimtarinë e Ibrahim Kadriut do të gjesh të portretizuar personazhe nga mosha e adoleshentit, te plaku, heronj dhe tradhtarë, figura tipike dhe atipike, tipa flegmatikë dhe sanguinë, të nënshtruar dhe rebelë, përfaqësues të shtresave të ndryshme shoqërore dhe të epokave të ndryshme, bartës të veçorive epokale dhe individuale. Kjo pasuri tipash dhe karakteresh shoqërore, sipas prof. Hysës, i jep një vend të veçantë prozës së Ibrahim Kadriut në prozën shqipe të pasluftës, është një dëshmi e thellimit në të të realizmit dhe të një qëndrimi aktiv të krijuesit ndaj fateve të vendit dhe popullit të tij. Pa iu shmangur funksionit edukativ të artit, sidomos në prozën për fëmijë, Ibrahim Kadriu duke synuar të edukojë me kujtimin e burrave të mëdhenj, na ka dhënë në librin "Epoka në figura" portretet e disa ikonave të kombit si Skënderbeu, De Rada, Idriz Seferi etj. pa rënë, siç kontakton prof. Hysa, në një moralizim të thatë. Po ashtu me angazhimin e një krijuesi me vetëdije të thellë artistike dhe qytetare në romanin dyvëllimësh "Vajhall", që studiuesi Mahmud Hysa e vlerëson si një nga veprat më të arrira të autorit dhe si një tip të ri romani, shkrimtari ka synuar demistifikimin e idolatrisë dhe të ideologjisë komuniste.

Duke analizuar romanet e Ibrahim Kadriut në kontekstin e zhvillimeve të prozës bashkëkohore shqipe, studiuesi, krahas pasurisë tematike të tyre, ndalon në risinë dhe ndryshimet që ato sjellin në relievin tipologjik të romanit, në tipologjinë e subjekteve dhe të strukturave kompozicionale, në poetikën e zhanrit në përgjithësi. Romani me subjekt linear, romani me subjekt të tipit mozaikal, si "Qyteti buzë liqenit", romani i personazhit, si "Qerrja e dritës", romani shoqëror, ose romani historik si "Kalorësi i Karadakut" a romani psikologjik, e bëjnë relievin tipologjik të prozës bashkëkohore, mjaft të thyer, duke thyer pikërisht një farë monotonie në pamjen e tij të parë edhe përmes përzierjes së epizmit, lirizmit e psikologjizmit, si mjete të zbulimit artistik të anës sociale dhe botës shpirtërore të individit. Koherent brenda profilit të historianit të letërsisë, por dhe me dhuntinë kritike që e karakterizon, Mahmud Hysa në librin e tij "Polifonia e tekstit letrar" dëshmon se një gërshetim i analizës funksionale dhe formale të tekstit , të vështruar si polifoni, jep rezultate në studimet letrare, për të kapërcyer një farë eklektizmi dhe manierizmi që mund t'i çojë ato në rrugë pa krye.

Duke përfunduar dëshiroj t'i uroj prof. Hysës shëndet për të vazhduar punën e tij në studimet letrare, dhe shkrimtarit Ibrahim Kadriu krijimtari të frytshme.

Rruga e Arbërit nr. 75
krijimtari

Poezi nga Islam Çenga

SHKËPUTUR NGA LIBRI "PARFUM URIMESH" NË PROCES BOTIMI

VONESE

- Me dashuri motrës Tashë-

Po kjo pse po vonohet
Duhet të vinte më herët se të tjerët
E me takën e gishtit t`i binte e shkujdesur derës
Siç ka bërë gjithmonë e vogla ime motër.
Me shtëpinë bosh dal në dritare
Tres vështrimin ngërç gjer në mbyllje të rrugës
S`ka fustan blu, s`duken gjëkundi as flokët e verdhë
As shalli bojë mjalti hedhur në një anë
Nuk farfurijnë si shelgje as sytë e saj gështenjë
Dhe bliri në rrugë gjethet po shkund
Megjithëse nuk fryn erë
Megjithëse nuk është vjeshtë...

Kushedi. Ndoshta ka palosur rrobat e dimrit
E nga raftet si gishta ka shpalosur të lehtat e verës
Apo ka lënë çezmën hapur siç i ndodh zakonisht
Kur ngutesh të dalësh nga pragu i derës;
Ndoshta në urban ka nisur shamata me zhbiriluesin e xhepave
Sharrje. Bllokim trafiku...Policë me dyzynë. Nëmë plakash
Ah, po vonohet buzëqeshja që mbush poret e stresit
Shakatë që luajnë syrin me ojna mëllagash...

Kur vonohesh ti muret vishen në gri
Dhe bie tik-taku orës, komshinjtë diç thonë ndër dhëmbë
Ustai përballë godet me çekan llamarinën më fort
Udhët ngushtohen si në një dimër të rreptë
Larg, shumë larg ulen dallëndyshet
Pranë shumë pranë ndërtojnë foletë...

Paketat Slims kinse për mua po digjen në çantë
Bëhet shuk byreku mbledhur në letrën varak
Të thëna e të pathëna zvarriten në të pjerrët
Pikë- pikë durimi shterret...
Por azgjë e tillë nuk është e rëndësishme
Se prania jote më herët se të tjerët...

Më në fund u hap dera
U mbyllën tylet e dritares siç ndodh zakonisht nga malli
U çelën sytë e mi të mpira nga morthi i pritjes
E si zogj të brishtë
Fluturuan dhe po miklohen në qepalla qielli.

Motër t`a kam thënë?
Si grua, si nënë je e përsosur
Si motër je e mirë, sa nuk gjej fjalë
Hallet e jetës nuk paskan të sosur
Si s`kanë dashuritë as fund, as anë...

NJE GUR I ÇARË I ALI PODRIMJES

Macja e zezë po më ndjek si nata
Si xhindi po më vidhet ky Ali Podrimja
Mos i dashur me mungjira shkinjash
Fushës së Kosovës nëpër brinja.

Me njërin sy të natës marr një sy gjumë
Me tjetrin sy të ditës të ndjek nëpër gjurmë
Në njërin sy të natës më del në ëndërr
Në tjetrin sy të ditës je në zhgjëndër.

O Ali Podrimja godit dhe me grusht
Veç mackën e zezë m`a tërhiq zvarrë
Fushës së Kosovës nëpër gusht
Maleve të Sharrit në janar!

O Ali Podrimja në je burrë!

SHOKEVE TE FEMIJERISE

Si uji në pagure na kanë mbetur motet
Me shkopinj thane vjeshta po shkund gjethet
Iku në atë botë miku im i shtrenjtë
Ajo botë si skile na pret ne të tjerëve..

Tani, miqtë e mi, shkopi i moshës bën domino
Në divan, në lulishtë, dopio gjashtë si miop
Ngrihet tensioni sonnabul në damarë
Dhe zemra çukit si grifshë në të rrallë.

T`a gdhijmë si dikur?
Plakat s`na lejnë gjallë
Na duan më pranë
Si varri me varr...

T'A FAL TY ...

Brenda meje tirret e ç`tirret një lëmsh
Lëmshi i ditenetëve të mbetura kukuth
Në vetminë time afër moshës së tretë
Në briskun Shënandreut ku nata ngroh kurrizin.

Kur mendoj për ty
Brenda meje struket si mëllenjë një e fshehtë
Dhe çukit me sqepin e njomë në ashtin e zemrës.

Nuk dua të të them se të dua si dikur
Dua të të them se të kam të shtrenjtë.

VARGJE TE FSHIIRA NGA SHIU

Kockat më dhëmbin nga mosha
Por zemra më reh si fëmijë...

E nëse xixëllonjat si ndjek në gardhin e mbrëmjes
Në shpirt xixëllonjat bëjnë dritë fosforishente
(Varg i prishur nga shiu.) Në vend të vargut të prishur nga shiu:
Të dhurova xixëllonja e të mora një puthje fëminore
Dhe gjumi nuk më zuri gjer në të gdhirë
(Varg me rimë e prishur nga shiu...)

E nëse në zemër nuk kam vend për trille
Kam hapësirë të pamatë për ty
Një puthje xixëllonjash na e njomi shiu
Dhe gërshetat (fjalë të fshira nga shiu) ...veriu... mimoza...
(varg i fshirë nga shiu, sigurisht me rimë...)

Kockat më dhëmbin nga mosha
Por zemra më reh si fëmijë

Shumë vargje në vazhdim m`i ka fshirë skleroza...

ÇUDI ME GRUAN KETE FUND MARSI

Më zgjoi nga gjumi hap e mbyll kanatat
Hyp e zbrit nga karrikja e vjetër prej kompesate
Shpalos rrobat e verës gruaja në kanape
Palos lëkurën e dimrit në dollape...

Rit i vjetër, zakon dallëndyshesh
Kur kthehen nga mërgimi i vjetër, i largët
Nxjerrin barin e tharë nga foleja
Shtrojnë tërfilin e njomë si mutafe.

Kështu në ndrime stinësh ndrohen rrobat
Këpucët dalin dhe futen në garazh
Me zakone e instikte dallëndyshesh
Me rite të çuditshme grash...

5 KOSTARE DHE BABAI 6

5 kostarë dhe babai 6, kositnin parcelën e jonxhës
Dhe nëna gatuante drekën në mutfakun si fole turtulli
Kostarët fqinj merrnin me vete fëmijën më të vogël
Babai merrte time motër;

Secili në korsinë e tij si në garat me kuaj
Palosnin jonxhën rradhë-rradhë në anë
Dhe ishte qetësi
Vetëm gjingallat dhe tehu i kosës
Dhe matanë një vijë uji si fishkëllimë bariu
Mbushnin kolovajsen e fshatit që pa gdhirë.

Do t`a thaj dielli në gjeth e lëkurë, më thoshte babai
Do t`a ngrejmë mullar, thoshte babai
Dhe në dimër do t`ja japim lopës
Dhe lopa do t`a bëjë qumësht
Qumështi do të bëhet kos
E kosi dhallë e shëllirë
Deri sa të piqen manat.

Do të piqen dhe kulumbritë e luleshtrydhat
E do të heqim trikon e leshtë nga mishi
Kur jonxha do të dalë nga brinjët e dheut.

Dhe 5 kostarë e babai 6 do të kositin plakjen
Ne do jemi rritur një pash më tepër...

Adivie Hoxha dhe poezia e saj

Pas botimit të librit të parë unë poezi "Parajsë pa engjëj", poetja nga Burreli Adivie Hoxha, del para lexuesve dhe në dy libra të tjerë "Kam mallë" dhe "Psherëtima jote jam".

Poetja Adivie Hoxha vjen me një poezi befasuese, herë e ndrojtur e herë shpërthyese duke "thyer" tabu romantike e melankolike, por herë herë dhe me ato pesimiste.



"... Kam dashur që shpirti të mos zotërohet brenda trupit, të paktën, ai ta shijojë lirinë e dëshiruar...".

Poezia e saj është e ndjerë, e shkruar me frymëzim dhe me një tematikë sa intime aq dhe përgjithësuese, ngacmimin e saj artistik e ngre në art duke e bërë pjesë e lexuesit.

Poetja nga libri i parë te i treti, ka një rritje cilësore dhe një pjekuri artistike.

"Nuk jam kjo që jam, / Dua të jem ajo që dua të jem", - shkruan në poezinë e saj, me një meditim apo komunikim filozofik me lexuesin e saj. Poezia e Adivie Hoxhës, është poezi që shqetësimet, ndjenjat dhe e unin e saj poetik e shpreh me një metaforë dhe figura artistike me një mesazh të qartë për jetën. Jeta sido që të vijë duhet jetuar, është e bukur. / ***Ilmi Dervishi***

POEZI NGA ADIVIE HOXHA

Jeta

Eh, ç'është kjo jota!
S'dihet se ç'të sjell
Me tekat e veta,
Të dhuron e të vjedh...

E ëmbël, e egër
Lakmuese dhe dhelpër,
Të shtyn, të tërheq,
Të fundos, të ngre...

Gjethja

Bie gjethja nga lisi
dhe dëshiron të kalbet
aty,
poshtë degëve...

Shan e mallkon erën
që e largon
dhe e merr me vete...

Meditim

Një letër zhubravitet nëpër xhep
dhe një laps majëthyer djersitet në dorë,
por, mendimet kanë marrë arratinë,
ndoshta, kërkojnë një metaforë...

një plak tymos llullën i menduar,
nga plaka gërmuqe kafenë pret...
Rinia, si një ëndërr e perënduar,
si fëmijë pa emër, kërkon nënë e vet...

Bukuroshja yjet numëron çdo natë,
nën jorgan struket duke mërdhirë,
"princi i kaltër", që pret orë e çast,
me tjetrën shëtit në errësirë...

dhe bredhin e bredhin mendimet e mia
nëpër mjegull humbur pa adresë,
i gjori njeri, s'i sheh hallet e tija
e tjetrit, ngushëllim mundohet t'i qesë...

botime

Burrë i ndritur dhe me gjykim atdhetar

Nga: **Prof. as. Dr. BERNARD ZOTAJ**

Faleminderit shumë që më dhatë kënaqësinë por edhe besimin të lexoj para botimit librin historik "Hoxhë Hasan Moglica, klerik dhe luftëtar i shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe".

Teksa lexoja një shkrim original, bindesha edhe më tej për faktin se krahinës së Moglicës dhe më gjerë e Dibrës, nuk i kanë munguar burrat e shquar kur Atdheu ka pasur nevojën, burra që mbi Atdhe e Flamur nuk vinin asgjë, as familje, as pasuri e as jetën e tyre.

Një ndër këta burra të ndritur, në gjykimin por edhe në radhët e kësaj monografie historike, ka qenë e mbetet edhe Hoxhë Hasan Moglica. Këtë gjykim e vlerësim për të, ma kristalizoi, konkretizoi dhe përforcoi më tej monografia e përgatitur për botim nga studiuesja e pasionuar Dr. Valbona Ramçi.

Botim i kësa monografie në kuadrin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar, në tërësi përbën një material original, me vlera arkivore, me ngjarje, data, protagonistë në kulmin e ndodhive të mëdha për Dibrën e Shqipërinë. Nëpërmjet "grimcave" të panumurta të ecurisë së tij, si pjesëmarrës në çeta, lidhje, kuvende, kongrese, debate, qendrime, pajtime, mospajtime, prishjeve, rregullime deri në arritjen e pikës kulmore, vjen figura tepër njerëzore dhe gati hyjnore e Hasan Moglicës.

Në këtë monografi gjen përshkrimin e karaktere të mjaft njerëzve të shquar, por ajo më kryesorja është drita e tyre e natyrshme në rrugën e gjatë atdhetare e patriotike në shërbim të kombit. Këto e të tjera detaje, të paktën në vështrimin tim, ja shtojnë vlerën botimit të kësaj monografie për klerikun, gjuhëtarin dhe atdhetarin Hasan Moglica.

Nëpërmjet këtij përshkrimi të autores del dhe përfundimi kryesor që, për vet përmasat e figurës së tij madhore dhe të tjerëve si ai, nuk janë ata që kanë nevojë për ne, por jemi ne që kemi nevojë për ta, për mëndjen e veprën e tyre, për mesazhet që kanë përcjellë e përcjellin për sot e për nesër.

Referimi në figura të tilla i studiueses Valbona Ramçi na pajis me mesazhe të domosdoshme për ditët tona për t'i qëndruar sa më pranë njeri tjetrit në të mira e në fatkeqsi, për të ruajtur të pastër vëllazërinë dhe shoqërinë sa më larg veseve, zënkave, hasmërive, thashethemeve dhe mbi çdo gjë të vëmë Atdheun e Flamurin.

Historiografisë së atdhedashurisë në këtë 100 vjetor të shtetit shqiptar po i shtohet edhe një botim i ri me vlera dokumentare, për një nga protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të besimit fetar, deri në formimin e shtetit shqiptar në vitin, 1912 në qytetin e Vlorës.

Botimi ka karakter biografik por të gërshetuar edhe me veprimtarinë e protagonistëve të tjerë të Lidhjes apo të ngjarjeve të tjera të kohës, ku Hasan Moglica ka marrë pjesë e qenë pjesëmarrës duke u shquar si klerik, atdhetar, dijetar, gjuhëtar dhe organizator e drejtues i aftë. Në mes burrash dhe prijsash e duke mësuar jetën e luftëtarit nga e para, faqe mbas faqe të librit, rritet e ripërmasohet figura e tij, sikurse dhe e bashkëluftëtarë të tjerë, me të cilët pati kontakte të vazhdueshme.

Bashkëpunimi me patriotët Abdyl Frashëri, Iljas Pashë Dibra, Vehbi Dibra, Hoxhë Hazis Lila, Medin Kormaku, Hajredin Shehu, Hoxhë Vokrri (Said Najdeni), Aqif Pashë Elbasani, Dan Cami, Feta Cami etj., ishte baza e veprimtarisë patriotike dhe e përhapjes së arsimit shqip të Hoxhë Hasan Moglicës.

Në mbyllje dëshiroj të falënderoj përzëmërsisht studiuesen e palodhur, Dr. Valbona Ramçi, për gjithë këtë punë monografike të lavdërueshme që ka bërë për të evidentuar këtë bir e burrë të shquar të Moglicës heroike dhe Shqipërisë që me lutje, fjalime, kushtrime dhe së fundi me gjakun e tij, qëndroi si mal i dhjetë në nëntë malet e Dibrës.



Një njeri me zemër të madhe

Nga **DHIMITËR SHTËMBARI**

Në gusht të vitit 1993, kur shkova së pari gazetar në "Kushtrim brezash" - organ shtypi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar, në dhomën ngjitur me zyrën e redaksisë dëgjoja një zhurmë të pandërprerë makine daktilografike. Kështu paradite, kështu deri në mbrëmje. Kështu një ditë e po kështu tërë javën. Madje edhe të shtunave.

I shtyrë nga kureshtja se kush ishte ky njëri që daktilografonte pa pushim, një ditë u futa në atë zyrë.

– Urdhëroni, urdhëroni! – dëgjova të më fliste dikush që qëndronte në kënd të zyrës.

I shkova pranë, ndërsa ai më zgjati dorën dhe, gjithë dashamirësi, nisi të më urojë:

- Me këmbë të mbarë në gazetë! Qofsh ashtu siç të duam; besnik i veteranëve të Luftës dhe t'u bëftë pena top!

U ula dhe nisëm të njiheshim. Aty ia mësova emrin: Selim Pira. E kisha dëgjuar si emër, por nuk kisha pasur rast të bisedoja nga afër me këtë ish partizan.

– Më falni, po çfarë jeni duke bërë? – e pyes.

– Vazhdoj të daktilografoj biografitë e Dëshmorëve të Atdheut. I kanë sjellë nga rrethet me shkrim dore, por na duhet t'i kemi të daktilografuara ...

– Kështu do të veproni për të gjithë të rënët?! – i drejtohem me një farë habie.

Miku im vuri buzën në gaz dhe, ashtu, thjesht, ma ktheu:

- Dëshira na e do që t'i daktilografojmë të gjitha, por ... si i thonë, me të parë e me të bërë.

Mbas një bisede shumë të ngrohtë, u ndamë.

Edhe ditën tjetër i shkova në zyrë. Edhe të pasnesërmen. Edhe në ditët e tjera. Dhe Selimin do ta gjeja gjithmonë me tavllën plot me hi duhani. Me aq shumë bishta cigaresh, sa nuk do ta kishe vështirë të mendoje se duhej të kishte punuar me orar të zgjatur.

Ja, ky ishte çasti i njohjes sonë të parë.

Por me Selimin njohja do të vazhdonte të thellohej nga java në javë e nga muaj në muaj.

Në një ditë vjeshte me shi të vitit 1993 e gjej Selimin te vendi nga niseshin autobuzat për në Peshkopi. Diku aty para hyrjes së godinës së Akademisë së Shkencave.

– Çfarë po bën këtu, shoku Selim? – i drejtohem.



Selimi hoqi cigaren nga goja, më tregoi një tufë gazetash që mbante në sqetull, dhe m'u kthye:

- Po nis gazetat "Kushtrim brezash" për në Peshkopi. Do t'ia jap këtij shoferit të autobuzit.

Dhe fët u shkëput për një çast prej meje dhe nxitoi drejt e te një shofer, i dorëzoi gazetat, duke i dhënë edhe ca lekë.

– I dhashë edhe një farë shpërblimi, - më tregoi kur u kthye, - sepse m'i dorëzon gazetat në duar të sigurta...

U ndava nga Selimi dhe, pse të mos e pranoj; u ndjeva si të isha fajtor: ky pensionist me aq shumë halle, si tërë moshatarët e vet, sakrifikonte nga buxheti mjeran familjar. Dhe për çfarë? Për të dërguar shtypin e veteranëve të Luftës në vendlindjen e tij.

Selim Pira ishte nga të rrallët veteranë të LANÇ që lodhej deri në sakrificë. Që kishte shumë veteranë që lodheshin, kjo nuk kishte pikë dyshimi, por që të sakrifikonin si Selimi, këta nuk ishin të shumtë.

– S'ju kemi parë këto ditë! – i drejtohem një herë Selimit.

Miku im vuri buzën në gaz, thithi fort cigaren, lëshoi tymin fjoll dhe ma ktheu:

- Isha në Dibër ... Muajin tjetër kemi festën e Batalionit Partizan të Sllovës ... Shkova dhe u mundova të marrë disa masa. Bisedova edhe me shokët e pushtetit lokal. U mora vesh mirë me ta. Sepse nuk është në nderin tonë si ish partizanë që të mos ketë shumë njerëz në atë ditë feste...

– Shkove me porosi dhe me shërbim nga Kryesia e Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar?

Si dhe herë të tjera, vuri buzën në gaz dhe, duke më vështruar drejt e në sy, ma ktheu:

- Si dhe të tjerë, unë nuk pres që të më ngarkojnë me detyrë të tjerët. Unë e kuptoj vet se cila është detyra ime. Pastaj, cili është ai njëri që pret të shkojë me shërbim me shpenzimet e Kryesisë së Komitetit Kombëtar?!

Dhe, sa bashku me disa të tjerë, ishte bërë nismëtar i vendosjes së lapidarit përkujtimor në fshatin Sllovë të rrethit të Dibrës.

Sa më shumë që kalonin kohët, aq më i plotë më bëhej portreti i këtij burri shtatvogël, por me zemër të madhe. Sa herë që më dilte përpara, ma kishte ënda të ndalesha e të bisedoja me këtë njëri të pasionuar mbas punës shoqërore.

E kujtoj shpeshherë një çast, kur shoku Selim shkëmbeu mendime me Kryeministrin e vitit 1999, Fatos Nano. Ishin mbledhur shumë veteranë të LANÇ në hollin e poshtëm të Pallatit të Kongreseve. Foli zoti Nano. Në fund të fjalës së tij, shtoi: Për këtë Vit të Ri Qeveria ka vendosur t'ju dhurojë juve, veteranëve të nderuar të Luftës, nga pesëdhjetë mijë lekë të vjetra.

Dhe hodhi vështrimin drejt atyre me të cilët bisedonte, si për të mësuar reagimin e tyre.

Në çast, pash Selimin Pirën që t'i drejtohej:

- Zoti Kryeministër; në qoftë se këtë pesëdhjetëmijë lekësh që premtoni, jua dhuroni edhe tërë pensionistëve të Shqipërisë, kjo do të ishte vërtetë një dhuratë. Në qoftë se do të na e jepni vetëm neve, veteranëve të Luftës ... kjo do të tingëllonte si lëmoshë.

Qendroi një hop dhe shtoi:

- Ne, ish partizanët, nuk mund të pranojmë lëmoshë...

Veteranët e LANÇ kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë të ndjeshëm ndaj çdo mendimi dhe veprimi që bie ndesh me lavdinë e epopesë së ndritur të Çlirimit. Por, pse të mos jemi plotësisht të vërtetë? Jo të gjithë kanë pas marrë hapa konkrete për t'iu kundërvënë atyre mendimeve dhe veprimeve. Se, që të jemi realistë, i druheshin ndonjë reflektimi pushtetar që do të mund t'u kushtonte largimin e fëmijëve nga puna etj.

Me Selimin ka ndodhur ndryshe. Krejt ndryshe. Kur në mes të qytetit të Peshkopisë u vendos busti i një mercenari të njohur, jo nga të gjithë veteranët u reagua shpejt. Madje pati syresh që nguroi ta vendoste emrin posht ndonjë shkrimi që bënte fjalë kundër vendosjes së atij busti. Ishte Selimi, personalisht ky Selimi që po bëjmë fjalë, që mori nisiativën vetjake për të botuar një shkrim me mendimet e tij të qarta e të guximshme.

Libri "Besnik ndaj betimit ushtarak", ku përfshihen disa intervista interesante të botuara në shtypin e përditshëm pluralist, është një dëshmi më shumë që verifikon karakterin e pastër të këtij dibrani atdhetar. Ai që e njeh nga afër Selim Pirën, intervistat do t'i dukeshin jo vetëm të vërteta e mbresëlënëse, por edhe me shumë interes për historinë.

Se ç'përmban ky libër dhe se cilat janë vlerat historiko – politike të tij, nuk e shohim të arsyeshme të qendrojmë, se lexuesi do ta ketë në duar.

Mbështetur në cilësitë si njëri dhe në aftësitë si kuadër, Selim Pirën jo më kot e kanë pas caktuar në detyra të rëndësishme: komisar i batalionit të Tankeve, komisar i Nëndetëses së parë Shqiptare, Inspektor i Kuadrit në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore.

Në mbyllje të këtyre shënimeve do të thoshnim vetëm kaq: Dihet se njëriu tërë jetën kalon mbi "dërrasa". Zotësia është të mos shkelësh mbi "dërrasën" e kalbur. Se po shkele mbi të, atëhere do të thyesh kokën.

Kolonel Selim Pira nuk shkeli kurrë mbi dërrasa të kalbura. Nuk shkeli, sepse i bënte sytë katër. Sepse i kuptonte cilat ishin ato. Madje luftoi që mbi ato dërrasa të kalbura të mos shkelnin as kolegët, vartësit apo miqtë e tij.

Edhe fëmijët, nipat e mbesat Selim Pira i ka mësuar dhe vazhdon t'i mësojë që të mos shkelin asnjëherë mbi dërrasa të kalbura.

Rruga e Arbërit nr. 75

homazh



Nga mitingu i poezisë në Gjakovë më 1068, nga e majta Rexhep Torte, Ali Podrimja, Din Mehmeti, Rahman Dedaj e tjerë

In memoriam për poetin Ali Podrimja

Dibra ishte Kosovë e vogël dhe Kosova plagë e saj

Si mbarë opinioni shqiptar edhe dibranët ndjehen të pikëlluar nga vdekja e papritur e Ali Podrimjes, poeti të madh shqiptar e botëror, sepse i ndjeri i respektonte Dibrën dhe dibranët.

Poetin Ali Podrimja për herë të parë e njoftova në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar kur isha nxënës i Gjimnazit në Dibër.

Ali Podrimja sëbashku me Azem Shkrelin, Rrustem Berishën, Rexhai Surroin e të tjerë, kishin ardhur nga Prishtina për të mbajtur një orë letrare në shkollën tonë. Leximi i punimeve të tyre letrare nga vetë goja e tyre zgjoi interesim të jashtëzakonshëm në mesin e nxënësve dhe arsimtarëve tanë duke lënë mbresa të pashlyera.

Kontaktet e mia me këtë poet të shquar vazhduan edhe gjatë studimeve të mia të letërsisë në Beograd. Aso kohe isha zgjedhur kryetar i Shoqatës letrare - muzikore "Përpjekja", shoqatë e studenteve shqiptarë nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia që studionin në Universitetin e Beogradit.

Kjo shoqate e jona në Beograd studentore organizonte shpesh mbrëmje letrare me poetë nga Kosova, ku merrnin pjesë një numër jashtëzakonisht i madh i studentëve. Në këto mbrëmje letrare merrte pjesë edhe Ali Podrimja.

Me poetin takoheshim sërish në Beograd edhe viteve të mëvonshme në restorantin e Hotelit "Moska" në qendër të Beogradit. Ali Podrimja me këtë rast qëndroi një kohë të gjatë në Beograd duke u kujdesur për Lumin, djalin e tij të sëmurë nga një sëmundje e rëndë. Aliu çdo ditë në orët e pasditës e nxirrte Lumin e vocër nga spitali për ta shëtitur , duke u interesuar dhe kujdesur dhe përpjekur që sado pak ta largojë nga traumat që i shkaktonin bluzat e bardha dhe atmosfera spitalore, dhe për ta bindur se çdo gjë do të përfundojë si më mirë.

Siç më tregonte poeti, për vatjen e djalit të tij Lumi për tu mjekuar në Francë kishte intervenuar edhe Fadil Hoixha, ataherë funksionar i lartë nga Kosova. Më vonë u preka pa masë kur mora vesh se shërimi i djalit të tij në Francë nuk pati sukses, sepse Lumin pata rastin ta takoj drejtpërdrejt, i cili të tërhiqte me urtësinë dhe butësinë e tij fëmijërore.

Në vitet 1968 dhe 1971 me Ali Podrimjën u takuam në mitingun tradicional të poezisë që mbahej më 9 maj në Gajkovë, ku merrja pjesë edhe unë me poezitë e mia.

> Sa e deshti Ali Podrimja Dibrën, dëshmon edhe Pllaka Përkujtimore që u vendos në Dibër në emër të 6500 kosovarët të dëbuar nga agresioni serb në luftën e fundit, të cilët u strehuan në Dibër, si shenjë falënderimi për mikpritjen vëllazërore, të ngrohtë e bujare që treguan dibranët në ato ditë të vështira.
> Në këtë Pllakë Përkujtimore që ndodhet në sheshin e qytetit janë gdhendur vargjet e Ali Podrimjes "Dibra ishte Kosovë vogël, e Kosova plagë e saj".

U takuam edhe kur fillova punën si gazetar i të përditshmes "Rilindja" nga Prishtina.

Ky poet i madh i letrave shqipe erdhi sërish në Dibër para disa vitesh me një grup poetësh nga Mitingu i Poezisë në Strugë, sipas programit të këtij manifestimi ku poetët pjesëmarrës vizituan disa qytete.

Në kujtesën time Ali Podrimja mbetet njeri i urtë, fisnik, intelektual i guximshëm dhe i fuqishëm, gjë që u pasqyrua në tërë jetën dhe krijimtarinë e tij.

Koinçidenca e vdekjes së tij në Francë ku më parë ndërroi jetë edhe Lumi i tij i vocër, mund të ndodhë vetëm njëherë dhe mund tu ndodhë njerëzve të mëdhenj dhe me shpirt të flaktë siç ishte Ali Podrimja.

Sa e deshti Ali Podrimja Dibrën, dëshmon edhe Pllaka Përkujtimore që u vendos në Dibër në emër të 6500 kosovarët të dëbuar nga agresioni serb në luftën e fundit, të cilët u strehuan në Dibër, si shenjë falënderimi për mikpritjen vëllazërore, të ngrohtë e bujare që treguan dibranët në ato ditë të vështira.

Në këtë Pllakë Përkujtimore që ndodhet në sheshin e qytetit janë gdhendur vargjet e Ali Podrimjes "Dibra ishte Kosovë vogël, e Kosova plagë e saj".

Rexhep TORTE

U shua një nga personalitetet më të shquara të shkollës shqipe

Pas një sëmundjeje relativisht të gjatë, ndërroi jetë profesor doktor Shefik Osmani.

Ishte dhe mbetet një nga personalitetet më të shquara të arsimit shqiptar. Veprimtaria pasionante, me kulturë dhe kompetencë shkencore dhe pedagogjike në kuptimin më të ngushtë u përqendrua kryesisht në këto drejtime:

Si drejtues i disa shkollave pedagogjike, vatrave të përgatitjes së mësuesve të rinj për arsimin masiv fillor në atë periudhë të një urie shumë të madhe për arsim, shkolla dhe aq më shumë për mësues që kërkoheshin në të katër anët e vendit. Drejtoi shkollën pedagogjike në Peshkopi, një pjesë e nxënësve, nga më të mirët vazhduan edhe shkollat e larta në vend dhe jashtë shtetit. Drejtoi Shkollën Pedagogjike me bazë fillore "Ndrec Ndue Gjoka" në Tiranë, tek e cila u përgatitën djem e vajza nga zonat rurale për të përballuar nevojat urgjente në zona të thella rurale, drejtoi shkollën pedagogjike 2-vjeçare dhe më pas edhe shkollën pedagogjike "Shejnaze Juka" në Shkodër, ku u shqua për një punë cilësore në një qendër me pretendime të larta cilësore, dhe me një trupë pedagogjike të konsoliduar, një pjesë e konsiderueshme e nxënësve të këtyre vatrave, si nxënës , por edhe si mësues vazhduan studimet e larta universitare dhe pasuniversitare, duke u bërë pjesë e stafeve të profesoratit të disa universiteteve dhe akademive. Kjo periudhë e lidhi fort me shkollën, fillimisht me arsimin fillor për të cilin përgatiti kontingjente të gjera mësuesish, duke u marrë më pas si specialist i arsimit fillor, derisa në opinionin shoqëror e profesional, u quajt "Babai i arsimit fillor".

Së dyti, si punonjës shkencor, kudo që ishte, veçanërisht si punonjës shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike, në të cilin ndiqte arsimin fillor, por edhe probleme të traditës së shkollës e të mendimit pedagogjik shqiptar, ishte punonjësi më i vjetër i atij institucioni, por me mendësi gjithmonë të reja, model i një studiuesi bashkëkohor. Ky institucion sot ka emërtimin "Instituti i Zhvillimit të Arsimit", me një vizion edhe më të gjerë se në të kaluarën. Atje , duke qenë edhe anëtar i Këshillit Shkencor, ishte njëkohësisht edhe sekretar shkencor i atij këshilli. U shqua për punë të hollë profesionale, për ndjekje të suksesshme të eksperimenteve dhe për forcë përgjithësuese në drejtim të metodave të mësimdhënies në ciklin e fillores. Ka drejtuar me sukses probleme të akselerimit të fëmijëve, mbi bazën e të cilit u ligjërua tërheqja e fëmijëve nga 7 vjeç në 6 vjeç, për klasën e parë fillore. Ndoqi seminare, referoi, drejtoi konsulta të shumta, ekipe mësimore-studimi etj. Fjala e profesor Shefikut, në të gjitha etapat e zhvillimit historik të shkollës sonë, kishte peshën e vet, me argumentet dhe logjikën shkencore që përdorte.



Së treti, dha një ndihmesë të çmuar në fushën e tekstografisë shkollore. Përgatiti tekste për mësimin në fusha të veçanta për mësuesit, si për "Dituri Natyre" etj. Dhe së bashku me mësuesen e merituar, Engjëllushe Abazi përgatitën disa tekste të gjuhës e leximit për klasat e fillores, duke përballuar me shumë sukses kërkesat e larta të programeve dhe të tjerat që vinin si rrjedhojë e kohës, e modernizimit shkencor pedagogjik të procesit mësimor.

Profesor Shefiku dhe një nga përfaqësuesit e atëhershëm të zyrës diplomatike të Kosovës në Tiranë, Meriman Braha, botuan shumë libra për shkollën shqipe me mësim plotësues, që po rritet e konsolidohet çdo ditë e më shumë. Ka botuar gjithashtu tekste të tjera dhe libra leximi enkas për fëmijët e shkollave shqipe me mësim plotësues, të cilat janë pritur dhe kanë ngritur lart personalitetin e profesor Shefikut përpara opinionit të mësuesve në mbarë shkollat shqipe me mësim plotësues. Këtu, sigurisht mes tjerash edhe me ndihmësen e çmuar të Zonjës së Profesorit, Mësueses së Popullit, Urti Osmani, e cila gjithnjë, si shoqe jete, me një kujdes të shkallës më të lartë, në të gjitha drejtimet, deri edhe si kolege, si redaktore dhe "kritike" e shkrimeve të tija, e cila nuk njihte tolerancë ndaj çdo gabimi. Mua, si mik i vjetër i tij, ndonjëherë, Shefiku më thoshte, si me shaka". E çova shkrimin pa ia dhënë Urtisë, sepse tash po bën ndonjë vërejtje e nuk dua ta vonoj".

Së katërti, si punonjës shkencor në nivelet më të larta për problemet pedagogjike, didaktike, për trashëgiminë social-pedagogjike etj. Vepra madhore "Fjalor i Pedagogjisë", e cila u nderua me Çmimin e Republikës, ishte në të vërtetë një enciklopedi pedagogjike me vlera për shumë kohë, vëllimet etnopedagogjike, nr. 1 dhe nr. 2, vepra e përbashkët mbi "Reformatori i Madh i Arsimit", e të tjera, spikasin për rigorozitetin e madh shkencor të profesor Shefikut, për kërkesat e studimit dhe të botimeve, deri edhe në aspekte të veçanta të estetikës, që përkon edhe me pikën e mësipërme, te tekstografia, por që ishte një kërkesë e shfaqur jo vetëm në botime, por edhe në mjedise shkollore, edhe në veshje të nxënësve, mësuesve, të etikës profesionale në këtë fushë etj.

> Profesor doktor Shefik Osmani drejtoi shkollën pedagogjike në Peshkopi, një pjesë e nxënësve, nga më të mirët vazhduan edhe shkollat e larta në vend dhe jashtë shtetit.

Së pesti, profesor Shefiku ishte edhe një veprimtar shoqëror efektiv, i cili u dallua në shumë fusha, sidomos edhe në Institutin e Kulturës Islame, duke dhënë një ndihmesë të rëndësishme në rritjen e nivelit të institucionit, në modernizimin e tij, përkrah doktor Ramiz Zekës, i cili e vlerësoi dhe e vlerëson ndihmesën e çmuar, bashkë me punonjës të tjerë. Ka nxitur e inkurajuar në këtë institucion talentet e reja në disa fusha krijimtarie, fillimisht për të gjitha moshat, pastaj edhe në veçanti, në krijime letrare, në atë figurative, për moshat e reja, pa dallime feje. Në këtë kuadër ka ndihmuar në projektimin dhe zhvillimin e mëtejshëm, të suksesshëm të organit studimor-kulturor "Universi", si anëtar shumë efektiv në drejtim të edukimit të masave, dhe në mënyrë të veçantë duke vlerësuar shumë seriozisht edhe harmoninë fetare e ndërfetare. Profesor Shefiku e kishte të kthjellët se çdo fe dhe institucion fetar, është pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare.

Akademia e Shkencave të Edukimit, që ka në radhët e saj 92 anëtarë, prej të cilëve 34 profesorë doktorë, 5 rektorë e zv.rektorë universitetesh nga mbarë hapësira shqiptare, e kishte një ndër më të parët iniciatorë të grupit themelues, bashkë me akademikun Jashar Rexhepagiqin dhe profesor doktor Nexhat Abazin, të cilët ndërruan jetë dhe kujtohen me nderim të veçantë nga opinioni shoqëror dhe shkencor.

Së fundi, profesor Shefiku e justifikoi dhe e ngriti më lart emrin e nderuar të familjes "Osmani", si familje arsimore, bir i Mësuesit të Popullit, Ethem Osmani, bashkëshort i Mësueses së Popullit, Urti Osmani(e cila gjithashtu rrjedh nga një familje dinjitoze, nga një baba personalitet i arsimit), nga vëllai më i vogël profesor doktor Tomor Osmani, Mjeshtër i Madh, nga e motra mësuese e shquar, Nezihaja, model i një tradite arsimore e më gjerë traditë qytetare e atdhedashëse, kulturdashëse, ku edhe profesor Shefiku ka rolin e vet të veçantë në këtë vatër të rëndësishme arsimore. Ai ishte i dashur me të gjithë, jo vetëm me të vetët, por edhe me kolegët, komshitë, një qytetar i madh i Tiranës dhe i Shkodrës e më gjerë.

Nderim Profesor Shefik Osmanit!

Prof. dr. Musa Kraja

kujtesë

Irfan Jashari, kirurgu i parë dibran

Nga **Dr. HASAN LLESHI**

Në përvjetorin e 25 të ndarjes nga jeta të kolegut e mikut tonë Irfan Jashari, menduan ta kujtonim sot atë jo vetëm si kirurg i parë i Dibrës por dhe për kontributin e madh që ka dhënë në fushën e kirurgjisë dibrane, ta kujtojmë për vlerat e tij morale, profesionale e njerëzore, që e bën atë një nga mjekët që do të mbahet mend gjatë në kujtesën njerëzore. Vdekja e tij e para kohshme, në moshën 47 vjeçare, i ndërpreu në mes ëndrrat e ambiciet profesionale që mendonte të realizonte. Kontakti im i parë me dr . Irfan Jasharin shënon janarin e vitit 1973. Dr. Irfani kishte rreth 2-3 vjet që kish mbaruar specializimin për kirurgji. Në këtë kohë me largimin nga Dibra të kirurgut të mirënjohur dhe të nderuar Mark Mirashi nga Shkodra, ai sapo ishte emëruar shef i shërbimit të kirurgjisë e tani e gjithë pesha e këtij shërbimi sa të vështirë e delikat, sidomos për kushtet e rrethit Dibër, binin mbi dr. Irfanin. Në fakt Dr. Irfan Jashari para se të vinte në spitalin e Peshkopisë e fill pas përfundimit të fakultetit si mjek i përgjithshëm ishte emëruar në Sllovë ku nisi nga e para për të ngritur spitalin e kësaj zone. Ende e kujtojnë me respekt banorët e Sllovës, Sllatinës, Vleshës, ZallKalisit, Lugja, Trojak, Venisht e Palaman ku ai edhe në kohë të mirë, edhe në kohë të keqe, nëpër terrin e natës me një fener në dorë vraponte nëpër shtëpi tek të sëmurët . Ai kudo që punoi mbi të gjitha mbeti njeri dhe mjek shembullor.

Dr. Irfan Jashari ishte njeri i lexueshëm në kuptimin e vërtetë të fjalës, brenda shpirtit të të cilit kurrë nuk mbahej ndonjë e fshehtë. Të gjitha çfarë kishte, pa asnjë ndrojtje, natyrshëm ti thoshte përpara syve ashtu siç e konceptonte vetë. Meritat e veçanta të këtij kolegu, si kirurg i parë i Dibrës, qëndrojnë në faktin se ai hodhi themelet e vërteta të shërbimit të kirurgjisë në këtë rreth, duke e ngritur atë në baza të larta shkencore për kohën. Ishte forca dhe këmbëngulja e tij, sidomos pas kalimit në spitalin e ri, në maj të vitit 1974, ku bëri të mundur jo vetëm rregullimin e sistemimin model të repartit të kirurgjisë, por edhe paisjen e sallave të operacionit me mjete e aparatura bashkëkohore, ngritjen dhe vënjen në baza pune të dhomës së reanimacionit pranë këtij shërbimi etj. Si njeri vizionar që njihej, ishte këmbëngulja dhe autoriteti i tij i padiskutueshëm, që zgjodhi element të rinj, mjek të sapo mbaruar shkëlqyeshëm fakultetin e mjekësisë, ku i ndihmoi dhe i dërgoj ato për tu specializuar në funksion të këtij shërbimi si p. sh: Dr. Mufit Gjunkshi, e Arif Hasani në kirurgji të përgjithshme e më pas Selim Oreshkën për reanimacion-anestezi, për të vazhduar kështu më vonë me të tjerë. Dr. Irfani ishte një kërkues ndaj vetes dhe shembull për brezat e rinj të mjekëve, duke qenë njëkohësisht dhe mësues i denjë për të gjithë ato mjek e kirurg të rinj që patën fatin të punojnë pranë tij. Ai do të mbetet në kujtesën tonë si njeriu që kishte të ndërthurur inteligjencën e tij natyrore me dëshirën dhe vullnetin për të studiuar. Ai dallohej për profesionalizëm e intuitën e tij natyrore, me dëshirën dhe vullnetin për të studiuar. Ai dallohej për profesionalizëm e intuitën e lartë klinike, devocion për profesionin, përkushtim e ndjenjë të lartë humane, model për moralin e tij të lartë. Ai gëzonte një komunikim të ngrohtë e të veçantë me të sëmurët, me personelin ku shërbente e veçanërisht me ne kolegët në përgjithësi.

Edhe në jetën shoqërore ai dallohej nga ne të tjerët. sa herë që në kohën e lirë organizonim ndonjë aktivitet shoqëror, në lokale, ambiente familjare apo në natyrë, prania e dr. Irfanit, krijonte një atmosferë shoqërore, të ëmbël e të sinqertë. Me humorin e tij të këndshëm na linte gjatë kohës me gojë hapur, duke qeshur por dhe këndonte mjaft bukur. Përveç këngëve popullore të trevës së Dibrës, veçanërisht pëlqente disa këngë të vjetra ruse si: "Kalinka", "Oçi çiorne" etj dhe i këndonte këto në gjuhën ruse. I pëlqente të kërcente valle dibrane, recitonte gjithashtu shumë bukur, sa që kur i kujtojmë sot këto pas kaq vitesh, ndjejmë me të vërtetë për të akoma dhimbje e emocione të jashtëzakonshme. Ishte njeri i shoqërisë, masovik e që rrezatonte kudo talent. Dinte të bënte muhabet me këdo; me të riun apo të vjetrin, me qytetar apo me fshatar, me të shkolluar apo analfabet. Secilin e dëgjonte, e vlerësonte dhe i kthente përgjigje sipas formimit që kishte bashkëbiseduesi. Na ndodhte jo rrallë që të shkonim për vizitë tek miq e shokë të ndryshëm, për të mirë apo për të keq. Ne në ndonjë rast na binte që të ndodheshim edhe në ndonjë odë të rëndësishme dibrane, ku aty gjenim pleq të zgjuar që e tjerrin hollë-hollë muhabetin. Dr. Irfani dinte të komunikonte shumë mirë edhe me filozofinë e tyre, ku kthente saktë përgjigjen dhe sado që përpiqeshin ato nuk e kapnin asnjëherë mat. Ne shokët e tij kur ishim me të nuk trembeshim asnjëherë nga "prita" të tilla sepse e dinim se kemi me vete "plakun" tonë për tu kthyer atyre përgjigjen e duhur. Irfan Jashari nuk ishte vetëm një profesionist model por tek shokët, kolegët, miqtë e çdo kush tjetër, ai njihej si një qytetar i denjë me kulturë të gjerë ku kishte njohje në letërsi, muzikë, sport e kudo. Ai kishte karakter të fortë burrëror, nuk njihte ironi e hile, sidomos me kolegët, respektonte së pari miqtë e shokët dhe shumë më pak i kushtonte vetes. Nuk u ankua asnjëherë në punën e lodhshme të kirurgut e në mënyrë të veçantë tek urgjencat kirurgjikale ku punoi me vite të tëra, kjo sepse ai dinte të menaxhonte shumë mirë emocionet e specialitetit të vështirë të kirurgut.



Irfan Jashari

Irfan Jashari ishte shef i shërbimit të kirurgjisë, nëndrejtor i spitalit, sekretar i organizatës bazë të partisë por që asnjëherë nuk e vuri veton mbi të tjerët. Ai gjithmonë ishte pranë njerëzve të thjeshtë, miqve e kolegëve të tij deri ditën që mbylli sytë.

Dr. Irfan Jashari ndërroi jetë në një spital austriak më 18 shtator 1987. Mbi 2000 banorë të Peshkopisë ishin në ceremoninë mortore të tij. Ne, miqtë e tij, patëm fare mundësi ti qëndronim pranë sa qe gjallë, për ti dhënë sado pak zemër, forcë e kurajo, për ti kthyer kështu borxhin shpirtëror që ne i kishim këtij njeriu të madh. Por, me cilësitë e vlerat e larta që e karakterizonin, e vendosën atë në panteonin më të lartë të shëndetësisë, metafora e të cilit tingëllon akoma e gjallë dhe e fuqishme edhe sot e kësaj dite.

Lamtumirë biri i Lurës, Fatos Çupi

Jeta është e shkurtër, e shtrenjtë dhe e dhimbshme. Kur mëson për dikë që ndahet nga jeta, njeriu ndjen lëndim në shpirt. Aq më e rëndë dhe e dhimbshme është për shokun me të cilin ke punuar, që i kujton momente të paharrueshme që ke kaluar bashkë me të. Fati im që njoha gati dy dhjetëvjeçarë mësuesin, shokun, veprimtarin dhe djaloshin e rrallë që mbartte tiparet e brezave të kullave të nacionalistëve të shquar Sali Çupi e Çup Alia të Arrmollës së Lurës, Fatos Çupin. Qysh në ditët e para ndjeva pranë një mësues të vlerave , një shok të urtë tek i cili ndonëse isha me moshë dhe vite më shumë, mësoja prej tij, por edhe ai vlerësonte e mësonte nga unë. Fatos Mehmet Çupi u lind në Arrmollë të Lurës në Dibër më 1 shtator 1972. U rrit dhe u edukua me kulturën e odave e të sofrës së bujarisë e të mençurisë që buronin nga gjyshi, atdhetari i flaktë, Sali Çupi. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i përfundoi në vendlindje, Arrmollë të Lurës me rezultate të shkëlqyera. Më pas vazhdon shkollën e gjuhëve të huaja, dega e italishtes në Tiranë. Më 1990 Fatos Çupi emërohet mësues në Draj-Reç ku dha lëndët e gjuhë –letërsisë. Në vitin 1991 familja Çupi vjen në Laknas të Tiranës. Fatosi vjen më 1993 dhe po këtë vit fillon punën mësues i gjuhës dhe leximit në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare Laknas. Kurdoherë i palodhur, i dashur e i respektuar me nxënësit dhe kolegët, i lidhur ngushtë me komunitetin. Vazhdimisht studionte, merrte pjese aktive në veprimtaritë kulturore-artistike e sportive, në veprimtaritë me librin e bibliotekën. Nga viti në vit, për



Fatos Çupi

22 vite punë që bëri, puna e tij erdhi në rritje. Në çdo veprimtari Fatos Çupin do ta gjeje gjithmonë përkrah shokëve. I thjeshtë, i kulturuar, i vendosur, i guximshëm, durues, i drejtë, por edhe i rreptë e i hapur aty ku e donte puna. I tillë ishte dhe mbeti derisa me 1 korrik 2012, ora 5 e 30 e mëngjesit në spitalin "Nënë Tereza" ndërroi jetë nga një atak në zemër. Zemra, shpirti, puna dhe gjurmët e mësuesit të Laknasit Fatos Mehmet Çupi do t'u flasin e rrezatojnë breznive.

Fatos Çupi la gjurmë diturie, kulture, fisnikërie e shembull të përkryer prej mësimdhënësi të përkushtuar. I respektuar e korrekt me nxënësit , metodist e veprimtar i nderuar. Nxënësit dhe prindërit e mbarë komuniteti të zonës së Laknasit, DA e Kamzës, drejtuesit e institucioneve, njerëz të thjeshtë nga Lura, Dibra, Mati, Tirana e treva të ndryshme të Shqipërisë me banim në Kamëz e jashtë saj e përcollën me nderim e pikëllim. Dhjetra e qindra nxënës, kolegë të shkollave Laknas, Kamëz, Kamëz e Re, e shkolla të tjera, dhjetëra e dhjetëra kurora lule u vendosën tek varri në Laknas më 2 korrik 2012, ora 12 në mjedisin e blertë ku do të prehet përgjithmonë. Fatos Çupi përfundoi me përkushtim edhe Universitetin "Aleksandër Xhuvani" dega gjuhë-letërsi. U zgjodh nga vetëbesimi popullor i zonës anëtar i këshillit bashkiak të Kamzës. Bir i familjes fisnike të Çupit, nipi i derës atdhetare të Lekës së Reçit, miku i nderuar i Canit të Dardhës, shok i rrallë dhe i respektuar, mësues moralist e veprimtarë komunikues, ndihmues e vlerësues për nxënësit e kolegët. I tillë ishte dhe mbeti Fatos Çupi. Ndarja nga jeta e Fatos Çupit, ndarja vetëm fizikisht, sepse ai ishte dhe mbetet mësues e njeri i vlerave, rrezatim i përkushtimit , pedagogjik e kulturor. "Ishte mësues, shok dhe njeri i shkëlqyer . Na iku shpejt- na thotë me lot në sy drejtori i shkollës Laknasit të Tiranës, Bashkim Dunga. Për Fatos Çupin derdhën lot kolegët, nxënësit, miqtë, lagjia "Lura" e Laknasit e të trevave shqiptare që e kanë njohur. Me siguri që një shkollë apo një rrugë do të ketë emrin e tij. Kjo është drita e njerëzve të thjeshtë, e intelektualëve virtuoz si Fatos Çupi. Ai ishte dhe mbeti mësues i vlerave, prind shembullor, veprimtar dhe intelektual i kohës.

MEVLUD BUCI

Rruga e Arbërit

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se **5 faqe të daktilografuara** (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në Word, me fontin **Times New Roman**, të **madhësisë 12pt dhe me hapësirë 1.5.** Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat "ë" dhe "ç".

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: **www.rrugaearberit.com.** Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: për gazetë dhe për internet.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com>

Redaksia.

BANJAT TERMOMINERALE

– Capa në Dibër të Madhe



BANJA E BANISHTIT DHE KOSOVRASTIT

Ju mirëpresin me kushte të shkëlqyera mjekësore dhe hotelierike

Ofrojnë shërim, rehabilitim dhe relaksim. Sipas një studimi të kryer nga AKAO (Organizatë botërore për ujërat termominerale), rezulton se ujërat e banjave të Dibrës së Madhe zënë vendin e parë në Evropë dhe të tretin në Botë për për përmbajtjen e ujit dhe efektet shëruese të tij, sidomos përmbajtja e squfurit që ndikon në shërimin e shumë sëmundjeve, si edhe përmbajtjen e ujit me kalcium, magnezium, hekur, kloride, nitrate, nitrite etj.Në këto banja ofrohet trajtimi edhe me fangoterapi, magnetoterapi, masazhe manuale, kineziterapi, fitnes, terapi me laser etj. Ka edhe aparate bashkëkohore si TENS, Ultratoni, Vakum, Rrymë inferente, Rreze infra të kuqe, Elektro stimulus etj.

Me sukses trajtohen dhe shërohen sëmundjet e aparatit lokomotor, të sistemit nervor, Gastri- intensinal, të sistemit respirator, uro - gjenital, sëmundjet endokrine, ortopedike, gjendjet post - traumatike, sëmundjet e lëkurës etj.

Cilësisë së ujit termomineral, personelit të kualifikuar mjekësor dhe hotelierik i bashkohet edhe natyra me bukuri magjepëse dhe ajri i pastër.

Numrat e telefonit për kontakt janë:

Hotel Banisht: **++389 46 831 092; ++389 46 832 680**
Hotel Kosovrast: **++389 46 842 095; ++389 46 842 222**
Drejtoria: **++389 46 831 401**
Kontabiliteti: **++389 46 835 424**
Nga Shqipëria mund të na kontaktoni edhe në numrin **068 468 27 11**
E-mail: **info@bdcapa.com**
website: **www.bdcapa.com**



cyan magenta yellow black